
Dhjetor 2018
Numri: 129
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Cilin Islam Cilin Mysliman


revistaetika progresibotime

PROGRESI
BOTIME

TË RINJ

Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.





SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 340 6182 | e-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 44 566 577
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

Titulli i shkrimit mund të duket i çuditshëm, ngaqë Islami dhe myslimani nuk mund të jenë disa llojesh. Por për fat të keq, në ditët e sotme, perceptimi i Islamit dhe myslimanit është shumë i ndryshëm nga e vërteta. Nga shpirti kryqtar i perëndimit është formësuar imazhi i një Islami që mbështet në frikë, urrejtje dhe armiqësi; dhe nga injoranca, imitimi dhe racizmi i myslimanëve, ka buruar imazhi i një Islami që perceptohet si tragjedi, dhe jo si mëshirë. Nga bashkimi i këtyre dy perceptimevë del në pah një tablo artificiale dhe tmerruese, që nuk ka aspak lidhje me Islamin e vërtetë. Islami që predikojnë pasuesit e Isisit, al-Kaidës, Talibanëve dhe tekfirxhinjve është pengesa më e madhe që gjendet para Islamit të vërtetë. Ky perceptim është një projekt që po vihet në skenë për të penguar shtrirjen e Islamit të vërtetë, të cilin bota e pret dhe i nevojitet fort. Ky është një projekt që ka mbështetës poshtërsinë e skenaristit dhe injorancën e aktorëve.

Panorama e botës islame sot përbën një perde të zezë para Islamit të vërtetë. Me të drejtë, një aktivist ka thënë: "nëse dëshirojmë t'i ftojmë jomyslimanët në Islam, së pari duhet t'i bindim ata se ne nuk e përfaqësojmë denjësisht Islamin e vërtetë". Injoranca, grindjet, prapambetja dhe varfëria, të përhapura ndërmjet neve myslimanëve, e bëjnë të pavlefshme thirrjen tonë. Natyrshëm njerëzvë iu lind pyetja: "Nëse Islami është zgjidhje për të gjitha problemet materiale dhe shpirtërore që ekzistojnë, atëherë përse nuk është zgjidhje për hallet e myslimanëve?" Të qenit shkak për një pyetjeje të tillë është mëkati më i madh për një mysliman. Prandaj është krejt e qartë se ne si myslimanë po përjetojmë një problem shumë serioz në përfaqësimin e Islamit. Një shkrimtar i yni thotë: "Kjo botë ka nevojë për Islamin, ndërsa Islami ka nevojë për myslimanët."

Është detyrë kryesisht e myslimanëve, predikimi i Islamit simbas natyrës së vërtetë të tij, si vendstrehimi dhe shpresa e vetme e njerëzimit. Ne do ta kemi të pamundur të shpëtojmë prej problemeve dhe vështirësive, derisa të kuptojmë dhe zbatojmë drejt Islamin. Madje ky keqkuptim dhe keqzbatim i Islamit do t'i shtojë edhe më shumë problemet tona.

Mirëpo cili është Islami i vërtetë?

Revista ETIKA

Dhjetor 2018
VITI: XII
NUMRI: 129

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 340 6182

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

ËEBSITE
ëëë.progresibotime.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur
se materialet e sjella në redaksi
pavarësisht nëse botohen apo jo
nuk i kthehen autorit. Koha e botimit
të një materiali përcaktohet
nga redaksia. Honoraret e shkrimeve
autoriale ose përkthimeve duhet të
vini t'i tërhiqni pranë
Shtëpisë Botuese "Progresi"
ose pranë zyrave të përfaqësimit
në Kosovë dhe Maqedoni.



Përmbajtja










5 **Ndjeshmëria e përfaqësimit në predikim**
Ahmet Tashgetiren
11 **Botëkuptimi Islam ndaj jetës dhe ngjarjeve**
Dr. Adem Ergyl
16 **Pamundësia për të qenë në anën e të drejtës dhe të drejtit**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
18 **Durimi të shton fuqinë**
Nuredin Jëlldëz
19 **Dua të rri vetëm**
Mehmet Dinç
23 **Auf ibn Maliku**
Mustafa Erish
26 **Kuptimi i "Moralit të lartë"**
Xhafer Durmush



Problemi i mungesës së seriozitetit 28
Idris Arpat
Një Ajet-Një Hadith 32

El-Hakem 40
Ilir Hoxha
Besa e myslimanit 44
Ferit Piku
Përgëzimi që vjen me pranverën 49
Kadrije Bajraktar
Mbulesa 50
Rukije Gënyly
Problemet e komunikimit në martesë 54
Dr. Timur Harzadin
Gra të lodhura 56
Fatma Allada
Të gjesh argjendarin 57
Urtësi







Ndjeshmëria e përfaqësimit në PREDIKIM

Ahmet Tashgetiren

Analizën e temës mund ta fillojmë nga problematika e çështjes, pra nga elementet e sjelljes së muslimanëve, të cilat ndikojnë negativisht tek predikimi dhe prej nga ushqehet edhe islamofobia.

Islamofobia, e cila është njëra prej fatkeqësive të shekullit tonë, nënkupton shndërrimin e Islamit në një mjet frike dhe përpjekjen për të vendosur humnera ndërmjet njerëzve dhe Islamit. Elementet kryesore tek të cilët mbështetet islamofobia janë sjelljet e vërejtura tek shoqëritë apo individët myslimanë, të cilat konsiderohen si të papapranueshme nga rregullat e njerëzimit. Në fakt qendrat e islamofobisë mund të fabrikojnë gënjeshtra dhe mashtrime, por nuk duhet të harrojmë që vërtetë sjelljet e pahijshme që shikohen tek shoqëritë dhe individët myslimanë, pra sjelljet e ulëta që pretendojnë të burojnë nga Islami, përbëjnë material të gatshëm për islamofobinë. Për shembull, aktet e prerjes së fytit para kamerave, që bëhen në emër të Islamit, mund të përdoren si shembull i xhihadit të Islamit."

Nisur nga çka thamë më sipër, mund të shprehemi:

Çdo njeri që shfaq sjellje të ulëta, nën identitetin e myslimanit, në cilëndo fushë të jetës, është një aktor vullnetar për skenarët e islamofobisë. Qendrat e fabrikimit të islamofobisë mund t'i shkruajnë dhe t'i vendosin në skenë edhe vetë këta skenarë... Ata që bëjnë shfaqje të tilla para kamerave, duke prerë fytin e të tjerëve, mund të jenë pikërisht aktorë të këtyre skenarëve.

Predikimi, përcjellja e Islamit te një person i dytë, është një detyrë që vetë i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ia ka lënë amanet çdo myslimani në Haxhin e Lamtumirës.

Është kusht për çdo mysliman marrja e përgjegjësisë së të qenit "Mbartës i Islamit", në mënyrë që mesazhi universal i Islamit të përcillet deri në horizontet më të largëta. Kjo përgjegjësi mund të shndërrohet në dimensionin e një mesazhi që njeriu mund të shfaqë në mjedisin familjar, në shoqërinë e punës, apo edhe në mjediset edukative e në marrëdhëniet shtet-shoqëri, dhe të arrijë deri tek i gjithë njerëzimi. Mesazhi i Islamit mbartet me fjalë dhe me vepra.

Ju mund t'ua shpjegoni njerëzve Kuranin Fisnik, mund t'u shpjegoni rregullat që ka vendosur i Dërguari i Allahut, (a.s.), mund t'u sqaroni mirësitë që Islami i sjell njeriut... Padyshim ky është predikimi.



MESAZHI I ISLAMIT MBARTET ME FJALË DHE ME VEPRA. JU MUND T'UA SHPJEGONI NJERËZVE KURANIN FISNIK, MUND T'U SHPJEGONI RREGULLAT QË KA VENDOSUR I DËRGUARI I ALLAHUT, (A.S.), MUND T'U SQARONI MIRËSITË QË ISLAMI I SJELL NJERIUT... PADYSHIM KY ËSHTË PREDIKIMI. PREDIKIMI KA QENË NJË PREJ MËNYRAVE KRYESORE, PËRGJATË SHEKUJVE, PËR TAKIMIN E NJERËZVE ME ISLAMIN DHE PËR RRJEDHJEN E KURANIT NËPËR ZEMRA SI SHËRIM.

Predikimi ka qenë një prej mënyrave kryesore, përgjatë shekujve, për takimin e njerëzve me Islamin dhe për rrjedhjen e Kuranit nëpër zemra si shërim. Por njerëzit, shoqëria dhe institucionet që ndërton Islami kanë nxjerrë në pah edhe potencialin e zbatimit të dispozitave që ai ka sjellë, dhe kanë shtruar para syve të njerëzimit shembuj të prekshëm.

Ata që dëshirojnë të shohin se çfarë njeriu, shoqërie dhe civilizimi ka ndërtuar Islami, shohin shembujt konkretë të tij.

Le të mendojmë për kohën kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), mori detyrën e profecisë, mori shpalljen e parë në shpellën Hira dhe shkoi në shtëpi. Pejgamberi ia tregoi lajmet bashkëshortes së tij, Hatixhes (r.anha), dhe më pas ia shpjegoi njerëzve të Mekës... Fjala e parë që i tha Hatixhes (r.anha), e cila po e shikonte me sy kureshtarë, ishte kjo: *"Kush do të më besojë mua tani?"*

Përgjigja e Hatixhesë (r.anha) ishte:

"O i Dërguari i Allahut! Së pari të pranoj dhe të aprovoj unë. Së pari më fto mua në rrugën e Allahut!"

Ka shumë argumente që tregojnë se Hatixheja ka besuar me gjithë zemrën e saj dhe frazën e mësipërme nuk e ka thënë për t'ia qetësuar zemrën bashkëshortit të saj, të cilin e donte shumë. Ajo pasi i tha Pejgamberit: "Betohem në Allahun se Allahu kurrë nuk të poshtëron ty.", i radhiti këto argumente:

"Ti i mbron të afërmit, merr përsipër barrën e punëve që nuk munden të kryejnë vetë, kujdesesh për fukarenjtë , bën mirësi aq sa nuk mund të bëjë askush, e nderon mysafirin dhe ndihmon njerëzit në organizimet që bëhen në rrugë të Zotit..."

Këto ishin cilësitë e një njeriu të virtytshëm në atë kohë. Domethënë, nëse do të dilnin disa pengesa para "Thirrjes islame" të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), siç patën dalë edhe para thirrjeve të të dërguarve të tjerë, arsyeja e parë që do t'i shkatërronte këto pengesa do të ishte kjo: Vërtetë biri i Abdullahut, Muhamedi, ka një personalitet profetik.

Ja pra, ky është sekreti! Ju nuk mund të ftoni askënd në mirësi po patët një personalitet problematik, sepse nëse do ta bënit diçka të tillë, reagimi i parë do të ishte në formën: "Përse nuk gjendet te ju kjo mirësi?"

Muhamedi, (a.s.), kishte moral të lartë. (Surja Kalem, 4.)

Nexhip Fazëlli e shpreh shumë bukur vlerësimin për Profetin: "Ai është Pejgamberi i horizontit!" Ai ishte horizonti i të gjitha bukurive dhe mirësive njerëzore. Të gjithë i drejtoheshin atij dhe përpiqeshin t'i ngjanin. Ai ishte shembulli dhe prijësi i mirësisë njerëzore. Të qenët prijës i njerëzimit në mirësi ka qenë pjesë e personalitetit të tij të lindur. Ai nuk ka qenë udhëheqës nga ata me kamxhik. Ai nuk ka qenë sundimtar e as tiran. (Surja Gashije, 22.) Ai ka qenë një flamur morali, virtyti dhe mëshire.

Feja nuk përbëhet vetëm nga mendimet, por ajo është një kornizë hyjnore që sistemon jetën, pra një disiplinë e jetës dhe një tërësi dispozitash që kanë ardhur për t'u zbatuar në jetë.

Kurani Fisnik ka pas ndikuar deri në palcë të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Për këtë arsye, ai me mirësinë dhe ndihmën e Zotit (xh.xh.), ka nxjerrë "shoqërinë e mëshirës" nga shoqëria e Mekës, pothuajse sikur të kishte nxjerrë të gjallin nga i vdekuri.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: ***"Mos u bëni si ata që thonë "Dëgjojmë", por nuk ia vënë veshin!"*** (Enfal, 21)

Myslimani duhet të përpiqet ta përfaqësojë sa më bukur Islamin me personalitetin e tij, në mënyrë që ata që e shohin të japin një gjykim nëpërmjet perso-

nalitetit të tij në lidhje me Islamin. Myslimani duhet ta perceptojë këtë përgjegjësi të madhe që mbart mbi supe, sepse kjo është çështje jetike për të.

Nëse Islami perceptohet gabim kur lexohet tek personaliteti i një njeriu që njihet për mysliman, atëherë lind rreziku i të qenit një mysliman i dëmshëm dhe mëkati i pengimit të të tjerëve në rrugën e Islamit.

Për sa kohë që përfaqësoni Islamin me personalitetin tuaj, duhet të merrni përgjegjësi njësoj sikur të ishit i vetmi mysliman në këtë botë dhe sikur njerëzit do t'i drejtoheshin Islamit duke parë vetëm pjekurinë tuaj fetare... Nëse e shohim çështjen nga ky aspekt, atëherë, shoqëria myslimane është një predikim më vete, sigurisht vetëm nëse i ngjan shoqërisë që ka ndërtuar i Dërguari i Allahut, (a.s.)... Një familje myslimane është një predikim më vete, sigurisht nëse mbart përgjatë shekujve zbatimin e dispozitave të Kuranit Fisnik dhe jetën familjare të të Dërguarit të Allahut, (a.s.)... Një i ri mysliman është një predikim më vete, sigurisht nëse pajiset me pjekurinë shpirtërore të të rinjve që kapin dorën e Pejgamberit (a.s.)...



Një nënë myslimane, një baba mysliman, një fëmijë mysliman janë një predikim më vete, sigurisht nëse mëshira dhe butësia janë pjesë e karakterit të tyre, në këtë kohë kur nëna po braktis dhembshurinë e nënës, babai po braktis përgjegjësinë e babait dhe fëmija po braktis pajisjen me flatrat e mëshirës...

Një kryetar shteti mysliman, një biznesmen mysliman dhe një mësues mysliman janë një predikim më vete, sigurisht nëse përgjegjësitë që kanë marrë përsipër i kryejnë me parimin "mëshirë ndaj krijesave".

Myslimani është njeriu që zbaton siç duhet Islamin... Myslimani e mbart në vete bukurinë e Islamit, pavarësisht identitetit social që mund të ketë. Ai e realizon predikimin me këtë cilësi të tij.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Buzëqeshja është lëmoshë."* Prandaj gjithmonë duhet ta mbartim buzëqeshjen në fytyrë dhe duhet ta konsiderojnë mbartjen e gëzimit në zemrat e të tjerëve si një nga cilësitë e të qenit besimtar i mirë. Duhet ta konsiderojnë largimin e mundimeve të njerëzve si cilësi të humanizmit. Duhet të konsiderojmë si shkelje të të drejtave, ngarkimin e kafshës me një ngarkesë shumë të rëndë, madje edhe bisedën duke qëndruar mbi kafshë, djegien e folesë së milingonave dhe djegien e pemëve, vrasjen e të moshuarve, të grave, të fëmijëve dhe të atyre që janë të preokupuar me ibadet qoftë edhe në luftë...

Gjithçka u tha më sipër, janë këshilla të Pejgamberit (a.s.). Kështu e ka ndërtuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), njeriun dhe shoqërinë islame, dalëngadalë dhe me mirësi. Si rezultat, "kriteret Mekë-Medine apo kriteret Kuran-Sunet" janë kthyer në "kriteret kryesore të humanizmit" përgjatë shekujve.

Myslimanët nuk duhet të aplikojnë tek ndonjë komision evropian për të marrë "kriterin e epërsisë së drejtësisë", por duhet të gjejnë dinjitetin për të aplikuar tek standardi i drejtësisë hyjnore që mbart në jetë ndriçimin e Mahsherit.

Ata që përkujdesen për çështjen e predikimit dhe përfaqësimit të Islamit, para së gjithash frikësohen nga mëkati që sjelljet dhe veprimet e tyre të mos përbëjnë produkt për Islamofobinë.

Këta njerëz janë të kujdesshëm në shtëpi, në punë, në rrugë dhe në mjetet/rrjetet e komunikimit masiv/social. Ata bëjnë kujdes, në mënyrë që të mos keqkuptohen nga dikush që nuk ka informacion për Islamin, apo që të mos merren si shembull i keq nga ndonjë fëmijë. Të kundërtën e kësaj, ata e shohin si ligësinë më të madhe që i bëhet Islamit.

Ata e mbartin gjithmonë në zemrat e tyre kënaqësinë që u jep afrimi i dikujt ndaj Islamit, si rezultat i sjelljeve dhe veprimeve të tyre, që u ngjajnë sjelljeve dhe veprimeve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili ka thënë: *"O Ali! Nëse për shkakun tënd dikush bëhet mysliman, kjo do të ishte më e mirë për ty se e gjithë pasuria e kësaj bote."* Këtë thënie të Pejgamberit (a.s.), e ndjejnë sikur t'ua kishte thënë secilit prej tyre. E gjithë çështja është që të arrijmë pjekurinë fetare dha ta vëmë në praktikë këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.)...

Allahu na e mundësoftë të bëhemi myslimanë të mirë! Gjithashtu, na mbrojttë prej sjelljeve dhe veprimeve që mund të bëhen shkak për devijimin e ndokujt! Amin!..



Cilin Islam Cilin Mysliman?

Ali Riza Temel

Titulli i shkrimit mund të duket i çuditshëm, ngaqë Islami dhe myslimani nuk mund të jenë disa llojesh. Por për fat të keq, në ditët e sotme, perceptimi i Islamit dhe myslimanit është shumë i ndryshëm nga e vërteta. Nga shpirti kryqtar i perëndimit është formësuar imazhi i një Islami që mbështet në frikë, urrejtje dhe armiqësi; dhe nga injoranca, imitimi dhe racizmi i myslimanëve, ka buruar imazhi i një Islami që perceptohet si tragjedi, dhe jo si mëshirë. Nga bashkimi i këtyre dy perceptimevë del në pah një tablo artificiale dhe tmerruese, që nuk ka aspak lidhje me Islamin e vërtetë. Islami që predikojnë pasuesit e Isisit, al-Kaidës, Talibanëve dhe tekfirxhinjve është pengesa më e madhe që gjendet para Islamit të vërtetë. Ky perceptim është një projekt që po vihet në skenë për të penguar shtrirjen e Islamit të vërtetë, të cilin bota e pret dhe i nevojitet fort. Ky është një projekt që ka mbështetës poshtërsinë e skenaristit dhe injorancën e aktorëve.

Panorama e botës islame sot përbën një perde të zezë para Islamit të vërtetë. Me të drejtë, një aktivist ka thënë: "nëse dëshirojmë t'i ftojmë jomyslimanët në Islam, së pari duhet t'i bindim ata se ne nuk e përfaqësojmë denjësisht Islamin e vërtetë". Injoranca, grindjet, prapambetja dhe varfëria, të përhapura ndërmjet neve myslimanëve, e bëjnë të pavlefshme thirrjen tonë. Natyrshëm njerëzvë iu lind pyetja: "Nëse Islami është zgjidhje për të gjitha problemet materiale dhe shpirtërore që ekzistojnë, atëherë përse nuk është zgjidhje për hallet e myslimanëve?" Të qenit shkak për një pyetjeje të tillë është mëkati më i madh për një mysliman. Prandaj është krejt e qartë se ne si myslimanë po përjetojmë një problem shumë serioz në përfaqësimin e Islamit. Një shkrimtar i yni thotë:

"Kjo botë ka nevojë për Islamin, ndërsa Islami ka nevojë për myslimanët."

Është detyrë kryesisht e myslimanëve, predikimi i Islamit simbas natyrës së vërtetë të tij, si vendstrehimi dhe shpresa e vetme e njerëzimit. Ne do ta kemi të pamundur të shpëtojmë prej problemeve dhe vështirësive, derisa të kuptojmë dhe zbatojmë drejt Islamin. Madje ky keqkuptim dhe keqzbatim i Islamit do t'i shtojë edhe më shumë problemet tona.

Mirëpo cili është Islami i vërtetë? Cilat janë qëllimet kryesore të Islamit? Megjithëse është e pamundur të shprehet esenca dhe qëllimi i Islamit në një artikull të vetëm, po përpiqemi të bëjmë një përmbledhje:

Dijetari i njohur Ibn Kajjim El-Xhevzij (v. 751 h.) në librin e tij me titull "I'lamu'l-Muvakkiin", i cili është pjesë e literaturës kryesore të fikhut/jurisprudencës islame, e përmbledh në këtë formë Islamin:

"Sheriati, bazën dhe strukturën e tij e mbështetet në urtësitë dhe rregullat që shërbejnë për t'ua përmirësuar njerëzve këtë botë dhe botën e përtejme. I gjithë sheriati është drejtësi, mirësi, mëshirë dhe urtësi. Çdo çështje që shndërrohet nga drejtësia në padrejtësi, nga mëshira në tirani, nga mirësia në ligësi dhe nga urtësia në injorancë, qoftë edhe me anë të komentimit, asnjëherë nuk përputhet me sheriatin, sepse sheriati është urtësia më e ndritur, që nxjerrë ne pah drejtësinë e Allahut, mëshirën e Tij ndërmjet krijesave, vërtetësinë e Tij dhe të Pejgamberit (a.s.), etj. Sheriati është drita e syve për ata që shikojnë, udhërrëfyesi i atyre që ecin, shërimi për çdo sëmundje dhe busulla e atyre që duan të përparojnë në rrugë të drejtë. Sheriati është ndriçimi i syve, jeta e zemrave dhe ushqimi i shpirtrave. Ai është përmbledhje e burimit të të gjithë jetës, ushqimit, ilaçit, dritës, shërimit, shëndetit dhe të gjitha mirësive në gjithësi. Ndërsa burimi i të gjitha ligësive dhe mangësive është largimi nga sheriati." (IbnKajjimel-Xhevzijje, I'lamu'l-Muvakkiin, 2/14.)

Është detyrë kryesisht e myslimanëve, predikimi i Islamit simbas natyrës së vërtetë të tij, si vendstrehimi dhe shpresa e vetme e njerëzimit. Ne do ta kemi të pamundur të shpëtojmë prej problemeve dhe vështirësive, derisa të kuptojmë dhe zbatojmë drejt Islamin. Madje ky keqkuptim dhe keqzbatim i Islamit do t'i shtojë edhe më shumë problemet tona.

Si mund të shfrytëzohet për padrejtësi, shkatërrim, budallallëk dhe tirani, një fe që e ka bazën në drejtësi, mirësi, urtësi dhe mëshirë?!

Një fe që ka ngritur civilizimin më të ndriçuar të historisë së njerëzimit, që e ka nxjerrë këtë botë nga errësira e periudhës së mesjetës dhe që është bërë strehim për njerëzimin me sistemin e saj të mbështetur në drejtësi, mëshirë, mirësi dhe urtësi, për fat të keq po reklamohet si burimi i terrorit, përleshjeve, injorancës dhe prapambetjes, për shkak të poshtërsisë së armiqve dhe injorancës së ithtarëve të saj. Në këtë mënyrë po formësohet një perceptim shumë negativ, që merr termin "Islamofobi".

Feja është shpjegimi i gjithësisë mbështetur në besimin ndaj Allahut Tealа. Kur themi fe, nënkuptojmë Islamin, sepse origjina e feve të vërteta është Islami. Islami ka për bazë tevhidin, domethënë njësimin e Allahut. Krijuesi është Një. Ndërsa krijesat janë vepër e këtij Krijuesi që është Një. Tevhidi shpreh rregullin dhe harmoninë. Ndërsa e kundërta e tij është anarkia dhe kaosi.

Fetarizmi nënkupton të jetuarit në përputhje me sistemin që ka vendosur Allahu (xh.sh.). Islami është një fe e natyrshme. Feja që Allahu ua ka zbritur njerëzve nëpërmjet pejgamberëve, nuk mund të jetë në kundërshtim me strukturën e njeriut dhe sunnetull-llahun/ligjet e natyrshme. Rregullat e fesë nuk bien në kontradiktë me ligjet e natyrshme, duke qenë se është i njëjti Zot që i ka vendosur të gjitha ligjet. Në gjithësi baza është njësimi dhe tërësia. Asnjë rregull fetar nuk mund të jetë në kundërshtim me natyrshmërinë njerëzore. Allahu Teala shprehet në Kuranin Fisnik:

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu

i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rum, 30)

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun në përputhje të plotë me formatin hyjnor dhe me hierarkinë e përgjithshme. Të gjitha problemet dhe mangësitë shkaktohet nga dalja prej natyrshmërisë dhe të vepruarit në kundërshtim me ligjet që ka vendosur Zoti (xh.xh.). Jurisprudenca islame quhet " jurisprudencë e natyrshme" pikërisht sepse qëndron në përputhje të plotë me natyrshmërinë e njeriut. Qëllimi i Islamit është që njerëzit të arrijnë lumturinë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën e përtejme. Zoti (xh.sh.), i Cili është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëbërës, nuk dëshiron që krijesat e Tij të vuajnë. Ai shprehet në Kuranin Fisnik:

"...Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë..." (Bekare, 185) ***"...Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj..."*** (Haxh, 78) ***"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka..."*** (Bekare, 286)

Islami është lehtësi dhe mirësi për robërit, dhe ta shndërrosh Islamin në mjet dhune dhe ligësie do të thotë të mbivendosësh fenë artificiale ndaj fesë së vërtetë. Si mund të jetë fe dhune dhe terrori, një fe që edhe emrin e ka Islam (paqe)?!

Sheriati islam ka pesë qëllime kryesore që janë: mbrojtja e jetës, mbrojtja e pasurisë, mbrojtja e mendjes, mbrojtja e brezave, mbrojtja e fesë.

E drejta për të jetuar është e drejta më themelore e çdo krijese. Prandaj është i ndaluar çdo lloj kërcënimi dhe dhunimi kundrejt jetës. Parashikohen ndëshkime të mëdha si "Kisasi" (ndëshkimi i njëjtë me fajin) dhe "dijeti" (shpagimi), ndaj fajeve që njeriu bën kundrejt ekzistencës së tij fizike dhe shpirtërore.

Për të jetuar me dinjitet dhe në mënyrë humane, njeriu ka nevojë për pasuri. Pasuria, që një njeri e fiton hallall, ndalohet të preket nga dikush tjetër. Njësoj, për fajet si vjedhja dhe uzurpimi janë vendosur ndëshkime të rrepta.

Njeriu konsiderohet i tillë kur truri i funksionon normalisht, ndërsa i çmenduri nuk ka ndonjë obligim. Mbrojtja e trurit, i cili është pasuria më e vlefshme e njeriut, është e barasvlefshme me mbrojtjen e vetë njeriut. Prandaj janë ndaluar prodhimi dhe përdorimi i lëndëve si alkooli dhe droga, që e dëmtojnë trurin. Këto lejohet të përdoren vetëm në mjekim si qetësues.

Edhe ruajtja e brezave është një prej bazave të sheriatit. Njerëzit janë humanë ngaqë kanë nder dhe prejardhje. Kafshët nuk kanë ndonjë prejardhje të qartë apo të caktuar. Një shoqëri e qetë dhe në harmoni formohet nga njerëz me nder dhe prejardhje. Ngaqë imoraliteti është armiku më i madh i një familjeje të shëndoshë dhe i brezave pasardhës, në fenë tonë janë ndaluar në mënyrë të rreptë si vetë imoraliteti, po ashtu edhe shkaqet dhe rrugët që të shpien drejt tij.

Edhe mbrojtja e fesë është një prej qëllimeve kryesore të sheriatit. Feja është ajo që i jep kuptim jetës dhe ngjarjeve. Cilësia më e rëndësishme që i dallon njerëzit nga krijesat e tjera është fetaria. Lumturia individuale dhe shoqërore lëvizin në raport me mbajtjen gjallë të jetës shpirtërore. Njeriu nuk mund të jetë i lumtur vetëm duke plotësuar nevojat materiale. Plotësimi i nevojave shpirtërore dhe ndërtimi i jetës shpirtërore, bëhen të mundura vetëm përmes perceptimit dhe përjetimit drejtë të fesë. Feja është ajo që e ndriçon jetën përtej vdekjes dhe që i jep kuptim jetës së kësaj bote. Për këtë arsye, ndërmjet detyrave të shtetit është edhe përgatitja e një mjedisi ku secili të ketë mundësi të bëhet fetar, me vullnetin dhe aprovimin e tij, pa u ndikuar nga asnjë lloj shtypjeje apo dhune.

Këto karakteristika, që i përkasin esencës dhe qëllimeve të fesë, domethënë Islamit, dhe që u përpoqëm t'i shpjegojmë pak, përbëhen nga tituj të caktuar. Mbushja e brendësisë së këtyre titujve në përputhshmëri me shpirtin dhe qëllimin e Islamit, para së gjithash është detyrë e neve myslimanëve. Në këtë kohë, kur janë përmbysur të gjitha vlerat, ilaçi po prezantohet si helm dhe helmi si ilaç. Një myslimani kurrë nuk i ka hije që të ndikojë në zhvillimin e këtij perceptimi. Ne kemi detyrë themelore që të formësojmë dhe zbatojmë një perceptim të drejtë për Islamin dhe myslimanët. Në të vërtetë, nuk ka ndonjë mënyrë tjetër me të cilën mund të jetojmë.



Botëkuptimi Islam

ndaj jetës dhe ngjarjeve

Dr. Adem Ergyl

MEDHHEBET DHE JETA JONË FETARE

Medhheb do të thotë "mendim" dhe "rrugë në të cilën përparohet", dhe e vërteta e tij është një çështje e rëndësishme e jetës sonë fetare. Ne e quajmë "medhheb" sistemin e mendimit që ka këndvështrimet e tij specifike, në lidhje me çështjen e të kuptuarit dhe komentimit të bazave të besimit fetar apo të dispozitave të veprave. Pra akumulimi shkencor dhe mental, që është produkt i ekolizimit dhe që del në pah në bazë të këtyre përqasjeve, quhet "medhheb". Medhhebet që kanë pasur për temë bazat e besimit janë quajtur medhhebe itikadi, ndërsa medhhebet e tjera janë quajtur fikhi.

Si mund të vlerësohet ekzistenca dhe legjitimiteti i medhhebeve së bashku me domosdoshmërinë e unifikimit dhe bashkimit të umetit? Përse ekzistojnë medhhebet? A do të ishte e pamundur jeta fetare nëse nuk do të ekzistonin medhhebet? Këto pyetje dhe të tjera të ngjashme me to, shpesh herë janë bërë rend i ditës apo dikush i ka sjellë në rend të ditës në mënyrë të vetëdijshme.

Në Kuranin Fisnik janë ndaluar në formë të prerë ndarjet ideologjike që e prishin unitetin dhe bashkimin shoqëror dhe kontradiktat që synojnë t'i zhvlerësojnë apo t'ua heqin influencën dispozitave fetare dhe bazës së fesë. Krahas kësaj, Kurani Fisnik e ka shprehur qartë se kontradiktat do të jenë prezente nëpër shoqëritë që formohen nga njerëzit që Allahu u ka dhënë lirinë e vullnetit. Përveç të tjerash, në Kuranin Famëlartë thuhet se po të dëshironte Allahu Teala mund t'i bënte të gjithë njerëzit të kishin të njëjtin besim dhe mendim. Gjithashtu, shprehet krejt qartë se njerëzit do të marrin drejtime të ndryshme si domosdoshmëri e qëllimit të krijimit dhe statusit që posedojnë. (Maide, 5/48; Hud, 11/118119.)

Në kohën kur njerëzit mund të kontaktonin lehtësisht me të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, kur ai ishte gjallë, nuk bëhej fjalë të ekzistonte nevoja për medhhebe, sepse atij, si një autoritet fetar, i drejtoheshin të gjitha pyetjet. Edhe përgjigjet që jepte Pejgamberi (a.s.), pranoheshin pa asnjë lloj diskutimi. Por pasi ndërroi jetë i Dashuri i Allahut, Pejgamberi ynë i nderuar, burimi për marrjen e dispozitave të fesë ishin tekstet fetare që përbëheshin nga Kurani Fisnik dhe hadithet. Por jo të gjithë njerëzit kishin të njëjtin nivel në dijen rreth Kuranit dhe hadithit. Gjithashtu, edhe

niveli i të kuptuarit natyrisht që nuk mund të ishte i njëjtë tek të gjithë. Mbi të gjitha, një pjesë e ajeteve të Kuranit Fisnik ishin "muhkem"- të kuptueshme lehtësisht nga të gjithë, ndërsa një pjesë tjetër e ajeteve ishin "muteshabih"- ajete që njëkohësisht mbartin më shumë se një kuptim. Për arsyet që rreshtuam lart, në pah dolën rreth 20-30 sahabë dijetarë/muxhtehidë, të cilëve iu drejtoheshin pyetje dhe iu pranoheshin përgjigjet prej të gjithë sahabëve. Kjo është mënyra se si lindën filizat e parë të medhhebeve.

Ka edhe shumë faktorë të tjerë që kanë shkaktuar nevojën për krijimin e medhhebeve, të tillë janë zgjerimi i kufijve të shtetit Islam, dalja në pah e disa ngjarjeve të reja me kalimin e kohës, pamundësia për të mësuar dije që të gjithë etj.

Disa dijetarë, të njohur për thellësinë e tyre në dije, për besnikërinë, për jetën e denjë personale, për mendimin e mirë të umetit kundrejt tyre dhe për aftësinë për të zgjidhur problemet, u shndërruan në pikë referimi për njerëzit që kishin nevojë të ndihmoheshin në lidhje me çështjet fetare. Me kalimin e kohës, metodologjitë dhe mënyrat që këta dijetarë të njohur përdornin për të zgjidhur problemet, u pranuan edhe nga dijetarë të tjerë. Këto metodologji gradualisht u shndërrua në shkolla dhe kështu u formuan medhhebet.

Ekolet Selefije, Maturidije dhe Esh'arije, si medhhebe të Ehli Sunnetit, fituan mendimin pozitiv dhe besimin e umetit në lidhje me itikadin- me fushat e besimit, dhe arritën një pranim të përgjithshëm. Ndërsa medhhebi Hanefi, Shafii, Maliki dhe Hanbeli përparuan si medhhebe të jurisprudencës në çështjet e ibadetit, veprave dhe në fushat e tjera të jetës. Sigurisht që përveç këtyre ka pasur edhe muxhtehidë të tjerë, të cilët nuk e kanë arritur dot begatinë për të pasur influencë dhe vazhdimësi të tillë brenda umetit.

Shumë çështje vazhdojnë të zgjidhen edhe në ditët e sotme duke ndjekur bazat dhe metodat e këtyre ekoleve, që kanë një të kaluar dhe akumulim afërsisht dymbëdhjetë shekullor. Sigurisht që në pah kanë dalë edhe çështje të reja, si rezultat i nevojave të cilat lindin prej kohës dhe vendit. Por edhe për këto çështje, dijetarët e ditëve të sotme kanë gjetur zgjidhje të tjera duke marrë parasysh bazat e kësaj tradite dhe duke krijuar edhe ixhtihade të reja.

Medhhebet dhe tarikatet, që kanë lindur dhe janë zhvilluar brenda traditës së urtësisë dhe dijes së vërtetë, nuk ndikojnë aspak në përçarjen e umetit, madje shpesh herë kanë qenë shkak për shfaqjen e mëshirës mes besimtarëve. Gjithsesi përgjatë historisë ka pasur edhe medhhebe dhe tarikate që nganjëherë i ka stimuluar politika dhe nganjëherë janë përhapur nga njerëz me qëllime negative. Po ashtu, ka pasur raste kur janë krijuar me vetëdije edhe nga ndonjë projekt i armiqve të Islamit. Në periudhat dhe vendet ku largpamësia politike, shkencore dhe fetare është dobësuar, këto lloj formimesh i kanë shkaktuar përçarje serioze umetit. Dijetarët myslimanë ua kanë dhënë përgjigjet e nevojshme rrymave të tilla në periudhat kur kanë lindur. Disa prej këtyre rrymave i kanë shpallur "fraksione të devijuara" dhe disa të tjera i kanë përkufizuar si rryma jashtë fesë apo që nuk u ka ngelur asnjë lloj lidhjeje me fenë.

Kohët e fundit në vendin tonë ka filluar të vihet në lëvizje një rrymë, e cila fshihet nën një emër të pafajshëm si "Myslimanizmi i Kuranit" apo "Myslimanizmi i Hadithit", dhe synon zhdukjen e medhhebeve. Personat që mbështesin këtë mendim dallohen nga metodat dhe sjelljet tallëse dhe poshtëruese kundrejt dijetarëve të hershëm. Ata përpiqen të formësojnë perceptimin që prijësit e medhhebeve nuk janë mbështetur tek Kurani Fisnik dhe Suneti i Pejgamberit (a.s.). Këta njerëz vazhdojnë gjithnjë ecjen e tyre në linjën e dëshirave dhe epsheve të veta, duke i manipuluar ajetet e Kuranin Fisnik dhe duke i lënë mënjanë hadithet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe duke i shndërruar në idhuj nivelet e tyre të perceptimit. Prandaj rekomandohet të qëndrojmë larg njerëzve të tillë.

Rruga më e drejtë është që të gjithë ata, të cilët nuk e kanë arritur dot gradën e lartë shkencore me të cilën mund të bëjnë ixhtihad në shkencat islame, ta vazhdojnë jetën e tyre fetare duke pyetur dijetarët e konfirmuar. Për këtë arsye, nuk duhet të mashtrohemi nga elokuenca dhe njohuritë e disa njerëzve që nuk kanë respekt për dijen dhe dijetarët, që nuk kanë ndonjë virtyt islam në vepra, moral dhe sjellje përgjatë jetës së tyre dhe që janë kapluar nga sëmundja e privimit prej edukatës dhe mirësjelljes.

TASAVVUFI SI VATËR E URTËSISË DHE EDUKIMIT

Islami është një fe e përsosur me dimensionin e jashtëm dhe shpirtëror të tij. Kjo fe nuk ka asnjë mangësi. Kjo e vërtetë i është shpallur nga Zoti (xh. xh.) të gjithë njerëzimit deri në Kiamet, nëpërmjet ajetit që ka zbritur në fund:

"...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj..." (Maide, 3)

Feja islame është plotësuar me ajetet e Kuranit dhe deklarimet e të Dërguarit të Allahut, (a.s), dhe ka caktuar në formën më të shkëlqyer botën tonë të besimit, vlerat dhe parimet që duhet të kemi në lidhje me veprat, sjelljet e moralin dhe sistemin e marrëdhënieve që duhet të kemi me të gjitha krijesat e tjera. Para nesh qëndron harta e një rruge që na shpie tek kënaqësia e Allahut të Lartësuar. Pasi e vërteta u shpall, u shndërrua në njërën prej çështjeve më themelore për çdo besimtar, prandaj çdo besimtar e ka për detyrë që ta zbatojë atë në jetë.

Islami është një fe e përsosur në të gjitha aspek-

tet, por a e posedon përsosmërinë në të njëjtën gradë individi mysliman që e pranon atë? Si do të rregullohet problemi i përqasjes ndaj ngjarjeve që ka Islami me ato që ka myslimani? Pikërisht në këtë pikë, rend i ditës bëhet çështja e bashkimit të individit mysliman me besimin, Islamin dhe ndjenjën e ihsanit/mirësisë. Procesi për shndërrimin e dijes në urtësi dhe për praktikimin e saj në realitet, në të vërtetë është një proces mjaft serioz. Në historinë e civilizimit tonë islam, pra në kulturën tonë, vatrat e edukimit të cilat kanë prioritet këtë temë dhe që posedojnë një thesar përvoje të gjerë në këtë fushë, i kemi quajtur "institucionet e urtësisë", apo me një shprehje më të përgjithshme "tasavvuf".

Pjekuria në fe ka disa gradë. Në çdo fushë ka thellësi të ndryshme dhe përparime sipas niveleve. Tasavvufi është udhëtimi për të arritur përsosmërinë në iman, i cili është dimensioni i besimit në fe; për të arritur përsosmërinë në Islam që është fusha e ibadeteve, veprave dhe marrëdhënieve; dhe për të arritur përsosmërinë në ndjenjën e mirësisë dhe urtësisë, që janë influencuese për formimin e pjekurisë morale dhe shpirtërore.

Disa prej qëllimeve sublime të edukim mistik janë: shpëtimi nga imitimi në besim dhe arritja te jakini, apo dalja nga ilme'l-jakini dhe arritja te pjekuria e ajne'l-jakinit, madje e hakka'l-jakinit; arritja e sinqeritetit në adhurime, vepra dhe shërbime; arritja e mirësisë, rrugës së drejtë dhe mirësjelljes në të gjitha llojet e marrëdhënieve; përvetësimi i cilësive sublime në edukatë dhe moral, në lidhje me gjërat sipërfaqësore dhe shpirtërore, duke vepruar siç ka vepruar i Dërguari i Allahut, (a.s.); përparimi në rrugën e njohjes së vetes (marifetu'n-nefs) dhe njohjes së Zotit (marifetu'll-llah); rigjallërimi i botës shpirtërore duke shpëtuar nga verbimi i syrit të zemrës dhe arritja e dorëzimit me vetëdije ndaj Zotit (xh.xh.); rritja e vlerës tek Allahu me anë të devotshmërisë; arritja e afrimit me Zotin e Lartmadhëruar, arritja e dashurisë hyjnore dhe e gradave radije dhe mardije, përmes nefsit të qetë e të pastruar nga dyshimet; dëlirja e zemrës nga papastërtia e çdo lloj mëkati dhe pranimi i tyre te Allahu Teala; shpëtimi nga mposhtja e shejtanit dhe ndihmësve të tij dhe hyrja ndërmjet robërve të devotshëm, si një rob që e përmend Allahun në çdo moment e që është lidhur vetëm me Atë e që i është nënshtruar vetëm Atij; përshtatja ndaj ritmit të gjithësisë dhe posedimi i një zemre jokontradiktore, e një zemre miqësore e të gjerë sa deti; dhe së fundi, të qenit një rob i devotshëm që e ka arritur miqësinë e Zotit dhe kënaqësinë e Tij.

Tasavvufi, me këtë dimension të tij, është një institucion i domosdoshëm për ndërtimin e individit mysliman. Përgjatë gjithë historisë, në këto vatra janë edukuar shumë njerëz të mirë të cilët më vonë u janë bashkuar karvanëve të njerëzve të urtë.


Tarikatet janë shkolla të ndryshme brenda tasavvufit, i cili është formuar nga burime të ndryshme.



Secili prej tarikateve, që kanë dalë në pah me mënyra dhe metoda të ndryshme sipas kohës, rrethanave dhe nevojës, ka pasur edhe ndjekës. Këta ndjekës janë përpjekur të arrijnë tek i njëjti qëllim me anë të rrugëve të ndryshme. E rëndësishme është që ata nuk kanë dalë jashtë kornizës së Kuranit Fisnik dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Gjithsesi mund të themi me keqardhje se disa prej këtyre institucioneve nganjëherë kanë gabuar rrugën, madje disa ndjekës të tyre kanë rrëshqitur nga rruga e drejtë dhe kanë formuar rryma të devijuara. Në përgjithësi këto lloj rreziqesh janë shfaqur gjatë periudhave që dija dhe udhëheqja kanë qenë të dobëta. Siç ka ndodhur edhe në institucionet e tjera, edhe në këtë fushë herë pas here ka pasur tentativa për rinovime dhe rregullime. Por duhet theksuar se kundërshtimi në mënyrë të përgjithshme i këtyre vatrave, me pretendimin se në pah dalin shembuj të gabuar dhe të devijuar, padyshim është një shfaqje e qartë e verbimit të perceptimit dhe largpamësisë.

Tasavvufi nuk është braktisje e kësaj bote dhe murgëri, nuk është një fe tjetër që bie në kundërshtim me Islamin e as ndonjë sistem që i është shtuar fesë islame. Tasavvufi është një disiplinë dëlirjeje dhe edukimi, që është trashëguar që në epokën e lumturisë, pra në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Bazuar në këto që thamë, tasavvufi nuk është një çështje bidati që është shfaqur vonë në fe. Sigurisht që përgjatë historisë ka pasur prej praktikave të tasavvufit që kanë hyrë si bidate, por dijetarët dhe mistikët e urtë, periudhë pas periudhe, i kanë pastruar vatrat e edukimit mistik prej këtyre gabimeve. Kjo nevojë për pastrimin e gabimeve sigurisht që gjithmonë do të jetë prezente, sipas kohës dhe vendit.

Rindërtimi i vlerave njerëzore, që vazhdimisht po dobësohen prej kërcënimeve dhe rreziqeve të botës moderne, e cila ka hyrë nën udhëheqjen e nefsu'l-emmares; fluturimi në formë të lirë në qiejt e urtësisë, që është verbuar dhe burgosur nga ana materiale e kësaj bote; rilindja e strukturës morale në horizontin e virtytit; mund të realizohen vetëm me plotësimin e nevojës së qartë që ndjehet për këto vatra urtësie. Pjekja e individit dhe shoqërisë realizohet përmes përjetimit si gjendje të besimit, Islamit dhe ihsanit/mirësisë. Ja pra, tasavvufi është një mejtep civilizimi që posedon aftësinë për ta siguruar këtë proces. Sigurisht se çdo mejtep është cilësor po aq sa hoxhallarët që japin mësim në të. Detyra që i takon umetit islam është që të edukojë mjeshtra të cilësisë së lartë edhe në këtë fushë, si në të gjitha fushat e tjera.



Rendja drejt pafundësisë

Ibrahim Bozbeshparmak

Qëllimi i krijimit është njëri prej argumenteve që mbahet si dëshmitar për ekzistencën e Allahut në shkencën e Kelamit. Dijetarët e Kelamit theksojnë se ky sistem, që funksionon në formë të përsosur, është krijuar me një qëllim dhe se rastësia apo diçka tjetër e ngjashme me të, është tepër larg natyrshmërisë së gjithësisë. Ky perceptim, që profesor Nexhip Fazëlli e ka përmbledhur shumë bukur me frazën: "Botën e krijove për mua, ndërsa mua më krijove për veten Tënde!", në të njëjtën kohë është edhe një shpjegim që Islami ka dhënë në lidhje me shkakun e ekzistencës së njeriut në këtë botë. Gjithashtu kjo frazë shërben edhe si shpjegim bindës për mallëngjimin ndaj pafundësisë, që ia ka dalë mbanë të hyjë në rendin e çdo fushe në të cilën ka folur njeriu, duke filluar që nga sistemet më të thjeshta të mendimit e deri te teoritë filozofike më të vështira, nga letërsia e deri te muzika dhe nga arkitektura e deri te shkencat e artit...Bota e brendshme e njeriut nuk e pranon zhdukjen dhe fshirjen nga ekzistenca, kështuqë ai mund të gjejë prehje vetëm përmes bindjes në mundësinë e arritjes së një jete të pafundme (jetës së Xhenetit).

"Xheneti" dhe "Shikimi i bukurisë së Allahut", që janë konceptet më magjepsëse të botës shpirtërore të besimtarit, janë vënë në horizontin e njeriut si qëllime. Njeriu në këtë botë është si në kurbet. Përmallimi i tij për të afërmit dhe aroma që i ka mbetur që nga "elestu birabbikum", vendos në fronin shpirtëror të njeriut këto qëllime me një mallëngjim tepër të madh. Lutjet zbukurohen me këtë qëllim. Sprovat kalohet me këtë qëllim. Plagët, që janë shkaktuar nga dhimbjet dhe vuajtjet, mbyllen prej këtij qëllimi. Lehtësimi i kryerjes së ibadeteve është me këtë qëllim. Njeriu mund të shpëtojë nga krizat e mendimit, nga gjendjet depresive dhe nga frika e vdekjes vetëm prej këtij qëllimi. Allahu Teala, që e njeh shumë mirë mangësinë e botës shpirtërore të njeriut që ka krijuar, ka përdorur këtë mënyrë për ta ndaluar krijesën e Tij nga zvarritjet drejt kaosit dhe tragjedisë. Rëndësia e qëllimit në jetën e njeriut na prezantohet si një mësim tejet i rëndësishëm.

Shumë lehtë mund të themi se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, e ka përdorur qëllimin si një metodë për të mbajtur të lartë moralin e njeriut dhe të gjallë përshpirtshmërinë e këtij të fundit... Literatura islame na tregon se i Dërguari i Allahut, (a.s.), në vitet e para të profecisë kur besimtarët ishin të dobët dhe të paktë në numër, u jepte atyre lajmet për çlirimin e Shamit, Medainit dhe San'asë. Këto lajme ishin, në të njëjtën kohë, edhe horizonti dhe qëllimet që duhej të arrinin besimtarët. Gjithashtu, megjithëse ishin përgëzime, lajmet se së pari do të çlirohej Roma Lindore dhe se emri i bekuar i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), do të arrinte në të katër anët e botës, ishin edhe qëllime të caktuara për t'ua shtuar vendosmërinë dhe synimet besimtarëve. Ndërkohë që edhe vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ka qenë njeriu më i mirë, edhe vetë jeta e tij, edhe të qenët i tij shembulli më i shkëlqyer, janë qëllim për njerëzit.

Dijetarët e urtë e përdorin në një formë influencuese çështjen e qëllimit, kur u japin njerëzve edukatën shpirtërore. Njeriu i përsosur që vendoset

para të gjithëve është qëllimi i madh që kërkohet të arrihet. Ndërsa dhikri ditor dhe detyrat në lidhje me këtë të fundit, janë qëllime të vogla që duhet të arrihen prej njerëzve. Njerëzit e urtë e dinë shumë mirë se në çfarë errësire mund ta degdisë njerëzimin mungesa e qëllimit.

Gjyshërit tanë të nderuar e kanë valëvitur flamurin e teuhidit në të katër anët e botës, duke pasur qëllime të pafundme. Paraardhësit tanë kanë kaluar kontinente dhe dete me qëllimin për ta lartësuar fjalën e Allahut Teala. Në lidhje me këtë çështje ka shembuj pafund.

Tashmë, le t'i drejtojmë vetes disa pyetje për t'i kërkuar llogari: Çfarë qëllimesh të mëdha apo të vogla kemi në lidhje me jetën? Cilat qëllime u injektojmë fëmijëve tanë me ninullat, përrallat, këngët popullore dhe historitë e heronjve? Cilat qëllime i premton sistemi jonë i edukimit fëmijëve tanë, sepse shigjeta, që gjuhet drejt një shënjestre, pritet që të arrijë te kjo e fundit. Një vrapues që ka një pikë arritjeje, përfundon vetëm garën. Garat kurorëzohen me shpërblimin dhe nderin e fitimit. Nëse nuk kemi ndonjë qëllim deri më tani, atëherë menjëherë duhet t'i vendosim vetes qëllime të mëdha dhe të vogla. Vetëm vendosja e qëllimit nuk është e mjaftueshme. Për të arritur një qëllim kërkohet vendosmëri, një vrap pa reshtje dhe një përpjekje e pastruar nga dembelizmi.

Çdo ditë dëshmojmë që çdo gjë në gjithësi lëviz pa reshtur. Bimët, kafshët dhe të gjitha krijesat e tjera, çdo moment janë në lëvizje. Jetën tonë e vazhdojmë në sajë të rrotullimit të pareshtur të tokës mbi të cilën banojmë. Me mijëra gjallesa e vazhdojnë lëvizjen e tyre sipas qëllimit që u është caktuar. Ky funksionim madhështor i gjithësisë nuk e pranon zbrazëtinë.

Ata që bëjnë studime në lidhje me historinë e jetës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), e dinë se në jetën e bekuar të Pejgamberit tonë të nderuar nuk ka asnjë shenjë zbrazëtie, pushimi apo ndalimi. Përkushtimi në ibadet, predikimi i Islamit, mbajtja e marrëdhënieve me të afërmit dhe shërbimi ndaj njerëzve, kanë mbushur çdo moment të jetës së shkëlqyer të tij. Edhe sahabët e nderuar, të cilët janë edukuar nën përkujdesjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në bazë të këtyre rregullave, e kanë kaluar jetën e tyre pa shfaqur asnjëherë shenja dembelizmi, apo siç shprehet poeti i famshëm Nexhip Fazëlli, e kanë kaluar jetën e tyre në një aksion të pareshtur besimi.

Kurani Fisnik e quan dembelizmin një cilësi të hipokrizisë. Shpërthimi i Kiametit, në një kohë të paditur brenda jetës së kësaj bote, është lënë i pasaktësuar për arsye që t'u shtojë besimtarëve vendosmërinë dhe të inkurajohen për të punuar sikur Kiameti mund të ndodhë në çdo çast. Edhe fshehja e vdekjes në një kohë të paditur në jetën e njeriut është vendosur për të njëjtin qëllim. Edhe fshehja e natës së Kadrit në muajin e Ramazanit, si dhe fshehja e momentit kur pranohen lutjet në ditën e Xhuma, janë caktuar kështu për t'i mundësuar besimtarit shfrytëzimin në mënyrën më efikase të këtyre segmenteve kohore dhe shtrirjen në kohë të ibadeteve dhe bindjes ndaj Allahut (xh.sh.), pa i lënë vend dembelizmit.

Të mëdhenjtë e tasavvufit/mistikës islame e kanë përkufizuar tasavvufin si vlerësim të momentit, në formën më të mirë, duke e shndërruar çastin në kapital të Ahiretit. Sipas kësaj përqasjeje, pasuesi i tasavvufit duhet t'i vlerësojë në formën më produktive natën dhe ditën e tij. Në këtë mënyrë fetarizmi vendos një pengesë të madhe përpara dembelizmit.

Gjyshërit tanë ishin të gatshëm në çdo moment dhe rehatinë e linin për në Ahiret. Poeti i ndjerë, Mehmet Akif Ersoji i përkujton ata në frazën: "Mos pandeh së gjyshërit kanë fjetur përgjatë shekujve! Përndryshe ku do ta gjeje atdheun në të cilin gjendesh tani?!". Ata kanë punuar nëpër mejdanet e luftërave, kuvendet e dijes dhe vatrat e urtësisë, duke ia shtuar natën ditës. Disa prej tyre e kanë mbyllur jetën me Kuran në dorë, disa nëpër mejdanet e luftës me shpatë e pushkë, dikush tjetër me plagë në fytyrë e me gjak në këmishë dhe ndonjë duke mjekuar plagët e kafshëve apo duke ledhatuar kokën e ndonjë jetimi. Dembelizmi nuk ka gjetur dot asnjë hapësirë ku mund të merrte frymë në jetën e tyre.

Ata që e kanë lënë rehatinë dhe kanë rendur për të arritur qëllimet e tyre, përgjatë historisë islame, kanë ndriçuar botën me shkëndijat që dilnin nga nallat e kuajve të tyre. Ata u kanë dhënë mirëqenie shumë të skamurve dhe drejtësi shumë të dhunuarve, me hijen e flamurit të tyre. Shtetet madhështore janë krijuar me emocion dhe përpjekje, e ndërkohë po këto shtete janë shkatërruar prej dembelizmit dhe pasionit për rehatinë. Vini re emocionin në epokën e lumturisë, përpjekjen në periudhën e kalifëve të drejtë, sinqeritetin e Tarik ibn Zijadit para Andaluzisë, përpjekjet e dhjetë sulltanëve të parë të Shtetit të Lartë Osman, etj... Pastaj shikoni të kundërtën e këtyre, pra periudhat kur pasioni për rehati, dembelizmi dhe mungesa e qëllimit, shkatërruan shtetet...

Për të përparuar shpirtërisht duhet të kemi qëllime për jetën e përtejme, duhet të kapemi fort pas tyre dhe duhet të mundohemi pa reshtur për arritjen e këtyre qëllimeve, pa shfaqur dembelizëm dhe plogështi. Myslimani ideal është ai që çlodhet me një preokupim tjetër, që e fshin fjalën dembelizëm nga fjalori i tij dhe që nuk i jep mundësi shejtanit për t'i shkaktuar fitne. Myslimani ideal është ai që jo vetëm flet, por edhe vepron për të arritur kënaqësinë hyjnore. Myslimani ideal është ai që nuk gjen kohë dhe fuqi për t'u marrë me haramin për shkak të preokupimeve të shumta për të arritur qëllimet dhe për t'i kryer punët që ka në lidhje me botën e përtejme. Myslimani ideal është ai që përpiqet për të arritur qëllimet e botës së përhershme dhe që nuk mbytet në dallgët e dëshirave vetjake në këtë botë të përkohshme...



Pamundësia për të qenë në anën e të drejtës dhe të drejtit

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Njëra prej cilësive themelore të umetit të Profetit Muhamed (a.s.) është "mbështetja e të vërtetës" dhe "mbështetja e atij që është në rrugën e të vërtetës". Kjo cilësi buron nga një ndjenjë e thellë, e fuqishme dhe e përhershme e të vërtetës. Për fat të keq, kjo cilësi e bukur dhe e veçantë e umetit është duke u përballur me rrezikun e zhdukjes, deri në atë masë saqë myslimanët të mos ndjejnë keqardhje nëse ajo e humb ndikimin e saj në gjendje të tilla si dashuria, mbrojtja, armiqësia dhe urrejtja.

Njeriu në përgjithësi preferon që miqtë t'i mbrojë në momentet e gjykimit dhe përzgjedhjes. Sigurisht që kjo dëshirë nuk buron gjithmonë nga dashuria. Në këtë çështje nganjëherë luajnë rol interesat dhe favoret e ndërsjellta dhe nganjëherë ndjenja e dhembshurisë. Cilido që të jetë shkaku, përfundimi është shndërrimi i "mbështetjes së të vërtetës" apo "i mbështetjes së atij që është në të vërtetën" në "mbështetje të mikut" apo në "mbështetje të atij që është në të padrejtë".

Kur situata të arrijë në ekstrem për shkak të dashurisë, miqësisë dhe mbrojtjes, gjendja del jashtë kontrolli dhe njeriu kthehet në post për të tjerët, edhe pse populli shprehet: "Mos u bëj post për mikun!" Për të mos rënë në një gjendje kaq të dhimbshme, miqtë nuk duhet të kaplohen nga një dashuri e verbër që mund t'i pengojë për të parë gabimet dhe padrejtësitë e njëri-tjetrit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith fisnik: *"Hubbuke'sh-shej'eja'mi ve jusimm / dashuria (e tepërt) ndaj një gjëje, të verbon dhe të shurdhon."*[1]

Në të vërtetë, siç deklarohet në librin tonë të shenjtë, Kuranin Fisnik, miqtë e vërtetë të besimtarit dhe të shoqërisë së besimtarëve janë Allahu Teala, i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe besimtarët e tjerë. Miku ynë më i vërtetë dhe më i madh, Zoti (xh.xh.), e paralajmëron umetin në lidhje me këtë temën në një ajet fisnik, duke u shprehur:

"O ju që keni besuar! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni)***, Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni."***[2]

Siç shikohet, në këtë ajet fisnik urdhërohet drejtësia dhe të pasurit parasysh të urdhrave të Allahut Teala në çështjen e dashurisë, mbrojtjes dhe miqësisë. Domethënë, këtu jepet mesazhi se dashuria, mbrojtja dhe miqësia e vërtetë është mbështetja e drejtësisë dhe e atij që është në të drejtën.

Dashuria që njeriu ka ndaj vetes, të afërmve dhe popullit nuk shërben si justifikim apo arsye për animin nga e pavërteta dhe mbështjetjen e atij që nuk është në të vërtetën, duke bërë padrejtësi. Për këtë arsye, pjestarët e umetit duhet të bëjnë shumë kujdes ndaj fjalëve, shkrimeve dhe veprimeve që kryejnë në mbështetje të atyre që i duan dhe i preferojnë, sepse mospërfillja e rregullave të vlerave shkakton pranime që janë në kundërshtim me parimet e besimit Islam dhe me vlerat e umetit. Ndërsa një situatë e tillë absolutisht nuk i shkon umetit të një Pejgamberi që ka qenë anëtar i Hilfu'l-Fudulit (unioni i të virtytshmëve) që u formua për të luftuar kundër të padrejtëve dhe padrejtësive, para periudhës së profecisë, dhe që ka thënë edhe në periudhën e profecisë: *"Nëse edhe sot do të kishte një union të tillë, përsëri do të bëhesha anëtar i tij."*[3]

1. Ebu Davud, Edeb, 116; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 120. Për k - tëhadithështë dhënë gjykimi se është i "dobët".

2. Nisa, 135.

3. El-Fakihi, Ahbaru Mekke, III, 376; V, 276; IbnKajjimel-Xhevzijje, Tehzibu Suneni Ebi Davud, II, 77.

Grupimet fetare dhe politike ndikojnë në largimin e umetit nga "mbështetja e të vërtetës dhe e atij që është në të vërtetën". Kjo gjendje është realiteti i hidhur i myslimanëve të vendit tonë dhe i të gjitha vendeve të umetit.

Pranimi se të gjitha epërsitë i ka vetëm grupi, të afërmit apo populli që përkasim, si dhe tentativat për t'i shfrytëzuar të gjitha gjërat dhe të gjithë ata njerëz që mund të shfrytëzohen në shkallë populli dhe umeti, për fat të keq nuk janë në mbështetje të atij që është në të vërtetën, por janë mbështetje e atij që është i fuqishëm. Ky poshtërim po përjetohet në shumë fusha dhe vende të umetit.

Nga ana tjetër, nuk mund të mohohet se njerëzit posedojnë ndjenjën e sjelljes së ashpër kundrejt armiqve dhe njerëzve që urrejnë. Por edhe kjo ndjenjë mund të frenohet dhe njerëzit mund të pengohen nga të qenit radikal dhe të padrejtë, nëse zgjedhin të "mbështesin të vërtetën dhe atë që është në të vërtetën". Kështu në librin tonë të shenjtë, Kuranin Fisnik, urdhërohet:

"O ju që keni besuar! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju."[4]

Në këtë ajet sqarohet se nuk lejohen hapësira për të qëndruar larg drejtësisë, për të mos mbështetur të vërtetën dhe për të mos mbështetur atë që është në të drejtë për shkak të kaplimit nga ndjenjat e urrejtjes dhe zemërimit. Gjithashtu urdhërohet që të gjitha punët të kryhen për hir të Allahut Teala duke ua dhënë hakun: dëshmia të bëhet duke u mbështetur tek e vërteta, e drejta dhe realiteti të shprehen ashtu siç janë, ngjarjet të rrëfehen siç kanë ndodhur, historitë të shkruhen duke u bazuar në fakte reale dhe popujt e shoqëritë armike, ndaj të cilave ndjehet urrejtja dhe zemërimi më i madh, të trajtohen gjithashtu me drejtësi.

Tashmë, nën dritën e këtyre dy ajeteve del në pah qartazi fytyra e shëmtuar dhe djallëzore e përçarjeve, padrejtësive dhe e fajësimeve reciproke të pakuptimta që po ndodhin ndërmjet myslimanëve.

Nga një aspekt, në këto dy ajete është caktuar linja kryesore që duhet të ndjekë umeti në punët e brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu theksohet se mbështetja e të vërtetës dhe e atij që është në të vërtetën është e mundur vetëm sipas rregullit "madhërim ndaj Allahut dhe dhembshuri ndaj krijesave", domethënë është e mundur vetëm me mbajtjen e drejtësisë.

Edhe një pikë tjetër e cila bie në sy është fakti se nuk ka rëndësi niveli i të vërtetës apo se kujt i përket kjo e fundit, por vlerësimi qëndron në të qenit apo jo e vërtetë. Asnjë e vërtetë, qoftë e madhe apo e vogël, nuk mund të shtypet apo të neglizhohet. E vërteta është e vërtetë edhe pse mund të jetë krejt e vogël. Ata që e mbështesin të vërtetën janë të obliguar që të mos e humbasin qoftë edhe të vërtetën më të vogël.

Umeti duhet të marrë vendime gjithmonë në përputhje me këtë parim: "Edhe e vërteta, edhe njerëzit janë të dashurit tanë. Kur këta të gjenden ballë për ballë më njëri-tjetrin, atëherë e vërteta është më e dashur për ne dhe ka më shumë përparësi për t'u zgjedhur." Për fat të keq, realiteti sot është tepër larg nga ndjekja e këtij parimi.

Nëse individi dhe umeti e sundojnë dashurinë dhe urrejtjen, do të arrijë suksesin për të bërë vepra të mira brenda kornizës së të vërtetave që besojnë. Edhe Allahu Teala e ka shpjeguar më poshtë se si do ta shpërblejë një sukses të tillë në këtë pikë:

"Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) ***dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira."***[5]

Çdo njeri shqetësohet nëse i janë falur apo jo mëkatet dhe nëse do të arrijë apo jo ndonjë mirësi të re. Allahu i Lartësuar në këtë ajet u premton "falje (mëkatesh)" për të kaluarën dhe "shpërblim të madh" për të ardhmen, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, domethënë, të mirëve të umetit dhe atyre që ia dalin mbanë për të jetuar duke mbështetur të vërtetën.

"...Allahu nuk e thyen premtimin e vet..."[6]

Brenda kornizës së këtyre të vërtetave dhe nisur nga gjendja e përgjithshme e umetit të Profetit Muhamed (a.s.), jemi të detyruar ta pranojmë se myslimanët nuk po paraqesin ndonjë pamje që mund të vërtetojë se janë mbështetës, jo me fjalë por me vepra, të së vërtetës dhe të atij që është në të vërtetën.

Xhihadi më i madh dhe i shenjtë i ditëve të sotme është të jetuarit pa ua vënë veshin reagimeve të drejta apo të padrejta, me vend apo pa vend, të duhura apo gabuara të shoqërisë; pa u dhënë rëndësi orientimeve të fuqive të huaja, që duken sikur janë në të vërtetën dhe duke e mbështetur të vërtetën dhe atë që është në të vërtetën; pa u mposhtur nga dashuria apo urrejtja.

Umeti i ditëve të sotme, që e ka humbur ndjenjën dhe zbatimin e të vërtetës dhe drejtësisë, umeti ynë që është në një gjendje të trazuar dhe të dërmuar, umeti që e ka humbur cilësinë për të qenë "umeti i mesëm dhe i drejtë" e "umeti më i mirë", dhe umeti që e ka humbur qëllimin e ekzistencës, do ta humbasë edhe mundësinë për të qenë shpresë për njerëzimin, nëse do të vazhdojë në këtë ecuri. Ky do të jetë dëmi më i madh dhe më serioz që do të pësojë umeti në ekzistenën e tij.

4. Maide, 8.

5. Maide, 9.

6. Rum, 6, 20.

Durimi të shton fuqinë

Nuredin Jëlldëz

Pejgamberët, të cilët Allahu Teala i ka vendosur para nesh si shembull, janë njerëz të krijuar si ne prej mishi dhe kockash. Paqja e Allahut qoftë mbi ta! Ata kanë ndarë të njëjtën botë me ne. Çfarëdo nevoje që kemi për të jetuar, të njëjtën nevojë e kanë pasur edhe ata. Gjërat që ne i quajmë problem, me shumë mundësi kanë qenë problem edhe për ta. Të dërguarit e Allahut janë përballur me probleme të rënda që ne shpesh herë nuk i kemi në listën tonë. Ata janë martuar dhe kanë jetuar me bashkëshortet e tyre. Janë bërë me fëmijë dhe kanë pasur halle prej tyre. Ata kanë hyrë në shoqëri, por shoqëria në përgjithësi i ka përjashtuar, internuar dhe shtypur. Ata nuk kanë pasur jetë pa probleme. Disa prej tyre ishin të pasur, por kishte edhe prej atyre që ishin të varfër dhe të sëmurë. Edhe ata kanë qenë të detyruar të punojnë dhe të sigurojnë jetesën. Ditët e numëruara i kanë jetuar në këtë botë të përkohshme. Ata nuk kishin ndonjë ndryshim prej nesh as në fizik, e as në jetën e tyre. Por mbartja e vulës së profecisë që ua dha Allahu, ishte një ndryshim i paarritshëm. Ajo vulë reflektonte pozitën që përfaqësonin ata. Ajo pozitë i lartësoi ata në nivele të paarritshme. Krahas asaj vule, edhe ata kanë pasur dy duar, dy këmbë dhe të njëjtin trup si ne. Në këtë kontekst nuk kanë pasur asnjë ndryshim prej nesh.

Dallimi më evident qëndron tek e vërteta se ata punonin jashtëzakonisht, pra punonin dhe duronin sa disa njerëz së bashku. Në të njëjtat ditë dhe net ata kanë bërë më shumë punë se kushdo dhe kanë jetuar një jetë shumë të ngjeshur. Ata kanë jetuar më shumë për të tjerët se sa për veten e tyre. Edhe armiq kanë pasur më shumë se kushdo tjetër.

Ata rezistuan krahas çdo gjëje. Asnjëherë nuk treguan gjurmë lodhjeje dhe bezdisjeje. Ata i qanë hallet e tyre me Zotin (xh.xh.). Edhe ankesat që kishin ia parashtruan Allahut Teala. Ndërsa njerëzve asnjëherë nuk ua shtrinë dorën. Ata nuk qëndruan në vend pa bërë asgjë dhe nuk kërkuan ndihmë prej njerëzve. Edhe nëse mbeteshin të uritur, bënin sikur ishin të ngopur. Ata preferonin të jepnin edhe pse vetë ishin në nevojë.

Këta njerëz, që bënë të njëjtën jetë si ne, që jetuan në të njëjtën botë si ne dhe që kishin të njëjtët trupa si ne, jetuan të fuqishëm dhe nuk u dorëzuan asnjëherë ngaqë posedonin një të fshehtë që ne e kërkojmë shumë. Kjo e fshehtë nuk është gjë tjetër veçse durimi. Pejgamberët, alejhimu's-selam, me kuptimin e plotë të fjalës, ishin të pajisur me durim. Vështirësitë që kishin në shtëpi dhe vuajtjet që u shkaktonin njerëzit, nuk i bënë dot të dorëzoheshin, ngaqë përdornin si armë durimin. Ata e dinin se kjo botë është një shteg durimi dhe e vazhduan rrugën e tyre duke bërë durim.

Dje kjo vlerë iu shërbente profetëve, ndërsa sot është në shërbim të besimtarëve. Në të vërtetë do të fitojnë vetëm ata që bëjnë durim. Vetëm ata që bëjnë durim do të arrijnë te Zoti (xh.xh.), pa rënë në kurthet e kësaj bote provizore. Në këtë botë do të fitojnë ata që bëjnë durim në shtëpitë e tyre, ata që përkujdesen me durim për prindërit e fëmijët dhe ata që e përdorin durimin si armë ndaj të gjitha gjaknxehtësive të shoqërisë.

Ata do të lodhen në këtë botë, por do të pushojnë nëpër kopshtet e Xhenetit, me lejen e Allahut.

Secili prej nesh duhet t'i pikturojë vetes një tablo durimi. Aspektet në të cilat përjeton vështirësi, njerëzit me të cilët përjeton probleme dhe fushat në të cilat frikësohet në mos i rrëshqet këmba apo gjuha, duhet t'i konsiderojë si momente të përshtatshme për durim. Në këtë mënyrë, duhet ta vendosë durimin në funksion. Secili prej nesh duhet ta mësojë durimin prej ajeteve fisnike dhe hadithe të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Në këtë formë do të fitojmë, me lejen e Allahut Teala.

Nëse humbet durimi, humbjet e njëpasnjëshme shndërrohen në zinxhir.

Dua të rri vetëm

Mehmet Dinç



Vajza vjen me hapa të shpejtë në shtëpi. Pasi i drejtohet dhomës së saj pa përshëndetur askënd, pjesëtarët e familjes dëgjojnë kërcitjen e derës që përplaset me forcë. Pasi e shohin njëri-tjetrin me shikime kureshtare dhe të shqetësuar, e dërgojnë nënën në emër të të gjithëve për të mësuar se cili është problemi dhe për t'i dhënë vajzës ndihmën e nevojshme. Nëna troket në derë ndërkohë që nuk e di se çfarë mund të bëjë. Ndërsa përgjigjen që do ta dëgjojë e di që më parë:

"Dua të rri vetëm."

I zoti i shtëpisë vjen në shtëpi i mërzitur dhe pasi i përshëndet pjesëtarët e familjes me një zë të paqartë, kalon në qoshen më të qetë. Pastaj i ngul sytë në një vend sikur të jetë betuar se nuk do t'i largojë asnjëherë prej aty. Ndërsa përgjigjen që do t'i japë bashkëshortes, që i afrohet pranë e dëshpëruar dhe duke mos ditur si të sillet, e ka përgatitur që më parë:

"Dua të rri vetëm."

Zonja e shtëpisë vazhdon të hajë buzët ndërkohë që i lëviz vazhdimisht bebet e syve nga vendi ku është ulur, pa i kushtuar aspak rëndësi derës së shtëpisë që është e hapur. Ndërkohë që bashkëshorti i saj afrohet, ia vendos dorën lehtë në supe dhe mendon se si duhet të fillojë t'i flasë, zonja e shtëpisë reagon si gjithë të tjerët:

"Dua të rri vetëm."

Njeriu vendos duart në kokë dhe mendon me vete: "Sa shpesh e dëgjoj dhe e shqiptoj edhe vetë këtë fjali mjaft dëshpëruese!"

Njeriu shpesh herë ka qenë vetë aktor apo dëshmitar i këtyre skenarëve, por akoma nuk e kupton dot se përse një njeri dëshiron të rrijë vetëm. Veçanërisht kur bëhet fjalë për bashkëshortin apo bashkëshorten e dashur, për nënën që e do më shumë se çdo gjë apo për shokun/shoqen më të ngushtë. Njeriu e ka gati justifikimin: "Më duhet të pushoj. Më duhet ta mbledh veten.", kundrejt atyre që nuk i bind dot për ta lënë vetëm.

Ndërkohë e keqja shtohet edhe më shumë kur njeriu rri vetëm. Barra e jetës që ndjehet mbi supe shtohet edhe më shumë. Në këtë mënyrë, jeta bëhet edhe më e vështirë. Sytë fillojnë të shikojnë vetëm gjërat negative, hallet dhe vështirësitë. Çdo gjë e bukur e humbet jehonën e saj në zemër. Pastaj gjuha fillon të këndojë: "Në fund gjithmonë ka vetmi. Vetmia zgjat për gjithë jetën." Pastaj fillojnë ankesat prej vetmisë së kërkuar dhe të përgatitur që më parë. Për shkak të fjalës "dua të rri vetëm", që i thuhet atij që vjen për ndihmë, pengohet edhe mundësia për t'u ndihmuar. Ndërkohë nevoja është tepër e qartë: Mosqëndrimi vetëm. Pastaj njeriu fillon t'i hedh një sy listës së emrave në telefon. Përpara syve i kalojnë me qindra njerëz dhe në mendje i vijnë me qindra fytyra, por prapë askënd nuk e ndjen afër për t'i telefonuar, në mënyrë që të bisedojë dhe t'i qajë hallet me të. Ai nuk gjen asnjë të besueshëm, të cilit mund t'i tregojë anën më të dobët dhe gjendjen më të dëshpëruar të tij. Tashmë dëshira për të qëndruar vetëm është realizuar, por më në fund e kupton se nuk është vetmia ajo që dëshiron. Madje, vetmia është ajo që nuk e do dhe prej të cilës ikën vazhdimisht. Dhimbja i shtohet dhe i vjen një barrë më e rëndë se ajo që mund ta përballojë një zemër.

Kur njeriu të arrijë në këtë gjendje, nevoja për të mos qëndruar vetëm bëhet emergjente. Për këtë arsye, njeriu e hedh veten nëpër rrugë. Ai dëshiron që të flasë me dikë pavarësisht nëse e njeh apo jo, mjafton që të shohë dikë të dëlirë, të besueshëm dhe të sinqertë. Në fakt, tashmë nuk e ka kusht që t'i flasë për hallet dhe t'i tregojë gjendjen e vështirë. Edhe nëse bisedojnë për parashikimin e motit, atij do t'i mjaftonte së tepërmi. Mjafton që bashkëbiseduesi ta dëgjojë atë me shikime plot dashuri, me zemër dhe me vëmendje. Pastaj njeriu shëtit me orë të tëra, por ja që nuk e gjen dot atë që kërkonte. Pastaj mbështetet për muri i lodhur dhe i pikëlluar. Dhe në fund, bërtet me të gjithë fuqinë që i ka mbetur në trup, duke u shprehur qoftë edhe me një zë të dobët:

"NUK DUA TË RRI VETËM".



Hipokrizia: Një dyshe e ndyrë

Senai Demirxhi

Vetëm gjërat e vlefshme imitohen dhe falsifikohen. Paratë që falsifikohen zakonisht janë kartëmonedhat që kanë vlera të mëdha. Xhamat e zakonshëm përpiqen t'i bëjnë të duken si diamante. Disa njerëz duan t'i bindin të tjerët që t'i pandehin xixëllonjat yje. Për të njëjtat motive bëhet imitimi i perlës, i koralit, smeraldit dhe rubinit. Njerëzit përpiqen të nxjerrin në treg imitime të markave të shtrenjta. Gjithashtu shtypen ilegalisht librat që lexohen më shumë. Dikujt që është i rëndësishëm i caktojnë dublues. Imitimi i një gjëje që s'ka vlerë, gjithmonë mbetet e pavlerë, prandaj nuk ka ndonjë kërkesë për imitimin e gurëve të zakonshëm.

Falsifikatori e di se çfarë është e vlefshme. Njerëzit e tillë rendin pas gjërave që kanë vlerë të madhe.

Njeriu është një vepër arti madhështore. Njeriu është një vlerë që e bën çdo gjë të vlefshme. Njeriu është pasqyra e vetëdijes. Njeriu është spektatori që vlerëson shfaqjen e gjithësisë. Njeriu është shijuesi i kënaqësive që japin bukuritë dhe mirësitë. Çdo gjë është e bukur me njeriun. Njeriu është një vulë që nuk mund të imitohet në sipërfaqen e tokës. Njeriu është një pikë kulmore e pashoqe e ekzistencës. Ai është krijuar qelizë pas qelize në formë të veçantë dhe specifike, duke filluar që nga fytyra e deri te sytë dhe që nga majat e gishtave e deri te fijet e flokëve. Çdo njeri është një art "punëdore". Ai është aq origjinal saqë nuk mund të zërë vendin e një njeriu tjetër. Vendi i njeriut ka një vlerë të paçmueshme. Ai është një xhevahir të cilit nuk mund t'i kompensohet mungesa.

Atëherë le të pyesim: A nuk mund të ketë imitues të njeriut që është kaq i vlefshëm? A nuk mund të ketë prej atyre që e falsifikojnë këtë vepër të qartë dhe të vetme? A nuk ka mashtrues që imitojnë njeriun i cili është i lehtë në peshë dhe i rëndë në vlerë? A nuk nxirren në treg imitimet e njeriut sikur të ishte njeri? A nuk ka njerëz falsë?

Si jo?!

Por kush e bën këtë punë të shëmtuar? Kush jep mund në këtë rrugë të pakuptimtë, të padobishme, të pavirtytshme dhe të paqenë? Kush përpiqet që ta bëjë fals njeriun e vërtetë? Kush përpiqet të vendosë identitet fals në vend të identitetit origjinal? Kush përpiqet ta shfaqë si njeri me zemër të nxirë njeriun që mbart një zemër të pastër në kraharor? Kush hedh dyshime mbi vërtetësinë e njeriut?

Këto pyetje kanë një përgjigje të ithët: Vetë njeriu. Kujt mund t'i shkojë në mendje një projekt kaq i ulët përveçse njeriut! Le të themi që njeriu ka vendosur të falsifikojë një njeri tjetër. Kë do të zgjidhte ai për ta falsifikuar? Sigurisht që do të zgjidhte atë që e konsideron si më të vlefshëm, pra do të zgjidhte atë që i jep përparësi, do të zgjidhte atë prej të cilit nuk mund të heqë dorë, do të zgjidhte veten e tij. Po, po,

veten e tij. Ai nuk do të zgjidhte askënd tjetër, përveçse veten e tij.

A është punë që bëhet kjo? A e falsifikon njeriu veten e tij? A mund t'i detyrojë që ta kontrollojnë të gjithë ata që e shohin në fytyrë, siç kontrollohen paratë duke i kthyer nga drita? A mund të marrë kënaqësi njeriu nga vendosja e një identiteti fals në vend të identitetit të vërtetë të tij? A mund ta ulë veten deri në atë gradë saqë të mos i besohet fjala dhe premtimi? A mund të jetë i kënaqur nga një falsifikim tmerrues që të bën të dyshosh kur e shikon në brendi të syve dhe të mendosh: Me të vërtetë, a ka një njeri tjetër aty brenda? A mund ta bëjë njeriu veten e tij të pavlefshme?

Për fat të keq, po! Madje, një po e madhe... Në të vërtetë, ky duhet të jetë përkufizimi i hipokrizisë: Falsifikimi i njeriut nga vetvetja. Zhvlerësimi i kapitalit të tij të paçmueshëm.

Nëse njeriu zgjedh hipokrizinë, do të thotë se po falsifikon veten me duart e tij, pra do të thotë se po shkatërron edhe vulën e vërtetësisë që i është vënë në fytyrë, po djeg frymën e shpirtit të fshehur në sytë e tij dhe po fshin logon e të Gjithëmëshirshmit, e cila i shkëlqen në buzëqeshje.

Hipokrizia ia turbullon njeriu zërin e tij të pastër si uji. Hipokrizia e falsifikon zemrën e njeriut e cila është qendra e vërtetësisë. Hipokrizia e falsifikon origjinalitetin e shikimit të njeriut. Ajo e bën të padobishëm vëllimin në të cilin pandehet se gjendet njeriu i vërtetë. Hipokrizia e çon dëm atë që pritet prej ndërgjegjes. Hipokrizia nuk e lejon njeriu që të plotësojë pritshmëritë e atij që e mban në pëllëmbë të dorës. Hipokrizia e bën njeriun që t'i lërë në mes të rrugës ata që e duan. Ajo nuk lë asgjë të mirë te njeriu, madje ia shkatërron atij edhe humanizmin. Hipokrizia ia shkatërron fisnikërinë njeriut. Për këtë arsye, ai fillon të humbasë vlerë me shpejtësi te sytë seriozë.

Për fat të keq, njeriu ia shkakton vetë vetes të gjitha këto. Hipokrizia është e njëjta gjë me dyfytyrësinë. Nëse një njeri përpiqet të bëhet me dy fytyra, ndërkohë që ka një, nuk i mbetet më as ajo fytyrë që ka. Pastaj, as ai vetë nuk e gjen dot se cila fytyrë e tij është e vërteta. Vendin e fytyrës së vërtetë e zë ajo false. Kur ky njeri të shihet në pasqyrë, nuk do e njohë dot veten e tij.

Prandaj hipokrizinë preferoj ta quaj dyfytyrësi. Njeriu hipokrit nuk e mban fjalën. Ai bën shumë mashtrime dhe asnjëherë nuk është i pastër. Në fjalët e tij ngatërron shapin me sheqerin, prandaj njerëzit nuk janë të sigurtë se cilës fjalë të tij mund t'i besojnë. Pasi hipokriti thotë edhe mashtrime krahas të vërtetave, gjithmonë të vërtetat e tij konsiderohen të pavërteta. Tashmë këtë lloj njeriu nuk ia vlen as ta dëgjosh. Në fund të fjalive të tij, hipokriti nuk vendos pikë. Fjalët e hipokritit i bëjnë njerëzit të turpërohen. Fjalët e pastra ndyhen në gojën e dyfytyrëshit.

Hipokrizia është përpjekja e njeriut për ta zhvlerësuar veten. Hipokrizia është humbje e fisnikërisë. Hipokrizia është humbje e origjinalitetit. Hipokrizia është përpjekja e njeriut për ta bërë të panevojshme ekzistencën e tij në sipërfaqen e tokës. Hipokrizia është përpjekja e njeriut për ta bërë xhevahirin mbeturinë. Hipokrizia është shndërrim i gjallërisë në vdekje. Hipokrizia është hedhje e nderit në baltë.

"Mjeshtri" e ka krijuar njeriun kaq origjinal, kaq të vërtetë dhe kaq të gjallë, dhe kërkon nga ai vërtetësinë, pastërtinë, cilësinë dhe ndershmërinë. Të jesh njeri, nëse mund të bëjmë një përkufizim origjinal, do të thotë të përballesh me të vërtetën tënde dhe ta pohosh atë edhe nëse ke gabime apo mangësi. Ajo që pritet prej njeriut nuk është përsosmëria, por mosshtirja si perfekt. Theksojmë, prej njeriut nuk pritet përsosmëri, por përpjekje për të jetuar me gabimet dhe mirësitë e tij. Edhe xhevahiri, edhe balta e Ademit (a.s.), i cili doli i pari në skenën e ekzistencës, janë në pah dhe nuk e fshehin veten e tyre, por ja që shejtani i atribuon epërsi zjarrit të tij, pohon se nuk ka asnjë mangësi dhe mohon të vërtetën e vet. Djalli nuk e pranon gabimin e tij, prandaj përpiqet të gjejë diçka për ta kamufluar. Ai pranon edhe një dhimbje të gjatë, edhe një jetë plot vështirësi, vetëm e vetëm për të mos u dukur ashtu siç është. Po ta nxirrte atë që ka brenda dhe po të mos hezitonte për ta pohuar të vërtetën, as nuk do të binte në pesimizëm, as nuk do të shfaqte mendjemadhësi. Djalli e refuzoi rrugën njerëzore, pra vazhdimin e jetës pa mendjemadhësi dhe pa rënë në pesimizëm. Rruga e përparimit që iu hap njeriut në personalitetin e Ademit (a.s.), ishte rruga e lehtë dhe e bukur: "Mos e shtrëngo veten dhe ji i qetë! Shfaqu siç je apo ji siç shfaqesh! Barazoje botën tënde të brendshme me botën tënde të jashtme! Ato që thua le të jenë të njëjta me ato që bën! Po ashtu, fol aq sa mund të bësh!.."

Kjo qartësisht tregohet si rruga e vetme përmes fjalisë që doli nga goja e Ademit dhe Havasë: "Ata thanë: ***"O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah,***

NË TË VËRTETË, KY DUHET TË JETË PËRKUFIZIMI I HIPOKRIZISË: FALSIFIKIMI I NJERIUT NGA VETVETJA. ZHVLERËSIMI I KAPITALIT TË TIJ TË PAÇMUESHËM.

NËSE NJERIU ZGJEDH HIPOKRIZINË, DO TË THOTË SE PO FALSIFIKON VETEN ME DUART E TIJ, PRA DO TË THOTË SE PO SHKATËRRON EDHE VULËN E VËRTETËSISË QË I ËSHTË VËNË NË FYTYRË

prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit."[1]

Domethënë se fitorja e njeriut qenka e fshehur në shfaqjen dhe pranimin e mangësisë, nëse bëhet fjalë për diçka të tillë. Njeriu ekziston vetëm me gabimet për të cilat do të kërkojë falje dhe me gjynahet për të cilat do të kërkojë mëshirë. Nëse njeriu përpiqet t'i shpikë vetes të vërteta fallso në mënyrë djallëzore, ndërkohë që e vërteta e tij është tjetër, atëherë e gjithë përpjekja që bën nuk është gjë tjetër veçse një humbje e madhe.

Përse duhet të jetë dyfytyrësh njeriu i cili nuk mund të fshehë asgjë prej Zotit (xh.xh.)? Përse duhet të përpiqet njeriu që të mos duket siç është, ndërkohë që e di se Zoti mund t'ia falë gabimet me mëshirën e Tij dhe mund t'ia mbulojë gjynahet? Nëse njeriu bëhet hipokrit dhe ka prioritet dukjen, atëherë është e qartë se nuk është njohur mjaftueshëm me Zotin e madhëruar.

Hipokrizia ta trazon stomakun: Nëse njeriu nuk bën çfarë thotë apo thotë çfarë nuk bën, atëherë gjendja e tij është e neveritshme.[2]Dyfytyrësia është e ndyrë. Nëse njeriu flet për vëllain e tij gjëra që nuk mund t'ia thotë përballë, nëse flet në mosprezencën e vëllait të tij gjëra që nuk mund t'ia thotë në fytyrë, atëherë ky veprim është i fëlliqur.[3] Pra, kjo është një gjendje e shëmtuar, është njësoj si të hash mishin e vëllait të vdekur dhe jo duke ndjerë neveri, por duke ndjerë kënaqësi." Në suren Huxhurat, i Gjithëmëshirshmi u thotë robërve të Tij: ***"...Sigurisht që ju do ta urrenit këtë!.."*** Pra, duket qartë se kjo gjendje nuk i ka hije aspak njeriut. Për këtë arsye, Allahu Teala nuk dëshiron të shikojë një veprim kaq të ulët te krijesa e Tij që e ka quajtur njeri. Zoti (xh.sh.) thërret për në sinqeritet dhe dëlirësi. Ai dëshiron që robi të jetë njëlloj para dhe prapa, brenda dhe jashtë, në fjalë dhe në vepra.

Krijuesi i lartësuar i ka caktuar njeriut gjendjen që i shkon dhe kërkon nga ai që të mos e humbasë këtë hijeshi. Ai e fton njeriun në fushën e shfaqjes së dy emrave të tij të veçantë në suren Ihlas[4], në mënyrë që robi të ndërtojë pastërtinë dhe dëlirësinë e tij. Këto emra të veçantë janë el-Ehad dhe es-Samed.[5]

Mënyra për t'u dëlirur mësohet nga zbatimi i dispozitave të emrit el-Ehad. Shkaku që njeriu ndryshon herë pas herë dhe e fut veten në gjendje të ndryshme është mosnjohja e es-Samedit. El-Ehad e konsideron njeriun të vetëm. Kjo e vërtetë lexohet në fytyrën e njeriut. Çdo fytyrë është e pashoqe dhe kjo e vërtetë është vula e Ehadijetit/njësimit. Njeriu ka një fytyrë specifike. Zoti i Cili është el-Ehad, nga një aspekt i thotë robit: "Ti je i vetmi për mua! Si ti nuk ka!", kurdo që njeriu e nxjerr në pah lehtësisht identitetin e tij me fytyrën e vet. Tek njeriu gjendet vula e kësaj cilësie deri te shenjat e gishtave. Shtresa retinale prapa syrit dhe konfiguracioni gjenetik i triliona qelizave janë shkronjat e heshtura të thënies: "Ti je i vetmi Im! Ty nuk të ndërroj me askënd!" Një njeriu, i cili është i ndërgjegjshëm se në fytyrën e tij gjendet shfaqja e emrit el-Ehad, pritet të jetë i shpëtuar nga shqetësimi për dukjen. Atij, që e di se është i dashuri i el-Ehadit, i mjafton si nder që të duket vetëm para el-Ehadit. Të zënët vend vetëm në shikimin e Atij, është burimi i nderit të vetëm të vërtetë dhe një lavdërim i pashoq.

Zoti i njeriut është el-Ehadi. Njeriu gjithmonë është para syve të Tij. Zoti (xh.sh.) nuk është i shkujdesur ndaj njeriut. Ai çdo moment është me njeriun. Robi nuk mund të gjejë ndonjë vend ku mund të fshihet prej Tij. Asnjë fjalë nuk mund të ikë prej dëgjimit të Zotit. Njeriu nuk mund të ketë ndonjë qëllim që mund ta fshehë prej dijes së Allahut Teala. Nëse njeriu dëshiron ta vazhdojë bukurinë e ekzistencës së tij, atëherë duhet të shfaqet ashtu siç është. Ai që luan prej fjale, ai që mundohet të dëgjojë ndonjë fjalë vjedhurazi, ai që i ndryshon fjalët, ai që përpiqet të fshehë qëllimin dhe që shikon me bisht të syrit për të përfituar diçka, do të thotë se nuk e merr seriozisht vëzhgimin e el-Ehadit.

Nëse njeriu nuk përpiqet për të qenë i dashuri i el-Ehadit edhe pse e di se Ai e do, nëse ka dashuri të tjera për të cilat e anashkalon el-Ehadin, atëherë ai duhet të dijë edhe një të vërtetë tjetër: Zoti i njeriut është es-Samed. Një njeri që e njeh Zotin e tij si es-Samed, shpëton nga halli për të përfituar nga të tjerët. Ai është es-Samed, domethënë, nuk e bën njeriun që të ketë nevojë për të tjerët, nuk e çon te dyert e të tjerëve dhe nuk e ul në gradën që t'ua ketë nevojën të tjerëve.[6]

Çfarëdo që të jetë ajo që të tjerët ia premtojnë njeriut dhe cilido qoftë ai interes që e bën njeriun ta ulë kokën përpara të tjerëve, edhe të tjerët i marrin mbrapsht këto nga es-Samedi, apo jo?! Es-Samedi e di se kujt nuk ia thyen dot hatrin njeriu. Ai di çdo gjë, apo jo?!

Allahu është ai që nuk u ngjan atyre që lindin. Ai nuk u ngjan as atyre që linden nga dikush. Tashmë ka ardhur koha, madje po kalon, që t'i drejtojmë sytë nga el-Ehadi dhe t'i ngremë duart drejt es-Samedit, duke i harruar dashuritë kundrejt atyre që na bëjnë ta harrojmë dashurinë kundrejt Zotit (xh.xh.).

1. A'raf, 23.

2. Saf, 2.

3. Huxhurat, 12.

4. Fjala "ihlas" shpreh të qenit i sinqertë, i pastër dhe i dëlirë. Surja Ihlas e cila ka zbritur në Mekë, e mbron njeriun që të mos humbasë identitetin origjinal dhe esencën e pastër të tij duke e ftuar që të marrë mësim nga atributet e Zotit el-Ehad dhe es-Samed.

5. Emrat el-Ehad dhe es-Samed në Kuranin Fisnik përmenden vetëm një herë, në një mënyrë që u theksohen edhe kuptimet e tyre, sepse fjalia shpreh të vërtetën e "njësimit" në të cilin Emsau'l-Husna kapen për tij sikur të ishte një shtyllë. Njeriu pothuajse është gjendja e shfaqjes së emrave el-Ehad dhe es-Samed, e shndërruar në mish dhe kocka. Për këtë arsye, njeriu nuk kërkon nderim prej të tjerëve dhe nuk pret dobi prej askujt përveç Zotit (xh.sh.).

6. Edhe ajeti i sures Fatiha: "Ijjake na'budu ve ijjake nestain", shpreh drejtimin nga el-Ehadi dhe es-Samedi në formën: "O Zot! Ti je el-Ehad! Ne të adhurojmë vetëm Ty. O Zot! Ti je es-Samed. Vetëm prej teje kërkojmë ndihmë."



Auf ibn Maliku

- RADIJALLAHU ANHU -

Mustafa Erish

Auf ibn Maliku (r.anh) ishte një fatlum që u takua me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në vitin e gjashtë të hixhretit!.. Ai ishte sahab që mbajti flamurin e fisit "Eshxha" në çlirimin e Mekës dhe një hero që ka marrë pjesë në luftën për çlirimin e Stambollit!.. Ishte një ushtar i besimit që i dashuronte shakatë e gazmoret, por dhe një i dashuruar pas dijes, që përpiqej vazhdimisht të mësonte gjëra të reja nga i Dërguari i Allahut, (a.s.)!..

Ai thirrej me llagape të ndryshme si Ebu Abdullah, Ebu Muhamed, Ebu Amr dhe Ebu Hammad. Emri i tij i vërtetë ishtë Ebu Abdurrahman Auf ibni Malik ibni Ebi Aufel-Eshxhai. Në literaturë nuk gjenden shumë informacione në lidhje me datën e lindjes dhe vitet e rinisë së Auf ibn Malikut (r.a.), por transmetohet se ai është bërë mysliman në vitin e gjashtë të hixhretit (627). Auf ibn Maliku (r.a.) ka marrë pjesë në luftërat e Hajberit, Mutesë dhe Tebukut, ndërsa në çlirimin e Mekës ka mbartur flamurin e fisit Eshxha. Gjithashtu ka marrë pjesë edhe në luftën për çlirimin e Stambollit në periudhën e Emevitëve.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka pas formuar një lidhje vëllazërore ndërmjet tij dhe Ebu'd-Derdasë (r.a.).

Auf ibn Maliku (r.a.), ka kryer shërbime të rëndësishme në Luftën e Zatu's-Selasilit. Koma-

ndanti Amr ibn Asi (r.a.) e dërgoi atë si lajmëtar për të njoftuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në lidhje me rezultatin e luftës.

Për sa u përket shakave, tregohet se ai ishte një sahab mjaft gazmor. Si shembull për këtë transmetohet një ngjarje e tillë: Ai pati marrë pjesë në Luftën e Tebukut, e cila cilësohet si "Xhejshu'l-Usra" dhe që përmendet si një luftë e vështirë në historinë islame. Tebuku ishte një qytet shumë larg Medines. Përveç të tjerash, nisja për në këtë luftë filloi në muajin më të nxehtë të stinës së verës, pra në muajin korrik.

Kur ushtria ndalohej në ndonjë vend për të pushuar, menjëherë ngrihej një çadër e vogël ose ndonjë vend me hije për të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Në njërin prej këtyre pushimeve Auf ibn Maliku (r.a.) deshi të hynte në çadrën e vogël të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). U ul dhe filloi të priste para çadrës. Kur iu dha leje për të hyrë brenda, e hodhi hapin, zgjati kokën drejt çadrës dhe pyeti duke buzëqeshur: "O i Dërguari i Allahut! A të hyj me të gjithë trupin?.." Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, buzëqeshi ndaj kësaj sjelljeje gazmore dhe pyetjes së tij dhe iu përgjigj: *"Hyr me të gjithë trupin!.."* Atij i tregoi për disa ngjarje që do të ndodhnin kur të afrohej Kiameti. (Shik. EbuDavud, "Edeb", 84; IbnMaxhe, "Fiten", 25; veçanërisht shik. Buhari, "Xhizje", 15.)

Auf ibn Maliku (r.a.), aq sa ishte sahab gazmor, aq ishte edhe i dashuruar pas dijes dhe përpiqej që çdo ditë të mësonte gjëra të reja nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Prej tij na kanë ardhur rreth gjashtëdhjetë transmetime të hadithe.

Auf ibn Maliku (r.a.), aq sa ishte sahab gazmor, aq ishte edhe i dashuruar pas dijes dhe përpiqej që çdo ditë të mësonte gjëra të reja nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Prej tij na kanë ardhur rreth gjashtëdhjetë transmetime të hadithe. Një pjesë e tyre gjenden në Kutubu's-Sitte, ndërsa rreth tridhjetë e shtatë hadithet e tjera gjenden në "Musnedin" e Ahmed ibn Hanbelit. (VI, 22-29.) Disa prej këtyre hadithe janë:

Ebu Abdurrahman Auf ibn Malikel-Eshxhai (r.a.) ka thënë: Një grup prej nëntë, tetë apo shtatë vetash, po qëndronim ulur pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ai na tha: *"A nuk po ia jepni besën të Dërguarit të Allahut?"* Ndërkohë ne sapo ia patëm dhënë besën. Për këtë arsye, i thamë: "O i Dërguari i Allahut! Ne ta kemi dhënë besën!" Ai përsëri na tha: *"A nuk po ia jepni besën të Dërguarit të Allahut?"* Këtë herë i zgjatëm duart për t'i dhënë besën dhe i thamë: "O i Dërguari i Allahut! Ne ta kemi dhënë besën. Tani për çfarë të ta japim besën?" I Dërguari i Allahut, (a.s.), na tha duke ulur zërin:

"Do të më jepni besën për ta adhuruar Allahun dhe për të mos i bërë shirk asnjëherë, për të falur pesë kohët e namazit, për t'u bindur dhe për të mos kërkuar asgjë prej askujt!"

Auf ibn Maliku (r.a.) thotë: 'Betohem se kam parë disa njerëz prej këtij grupi, që nuk kërkonin asgjë prej askujt. Edhe kur u binte në tokë shkopi, nuk kërkonin që t'ua jepte kush, edhe pse ishin mbi kafshë.' (Muslim, Zekat, 108. Veçanërisht shik. EbuDavud, Zekat, 27; Nesai, Salat, 5; Biat, 18; IbnMaxhe, Xhihad, 41.)

Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik duhet të nxjerrim në pah këto karakteristika të rëndësishme:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tri temave themelore si besimit, ibadetit dhe bindjes u ka shtuar edhe "moskërkimin e asgjëje nga askush". Ai ua ka tërhequr vëmendjen myslimanëve për rëndësinë e kësaj karakteristike. Ndërkohë e ka ndaluar lypjen dhe shtrirjen e dorës ndaj të tjerëve, sepse një mysliman i mirë është një njeri që di ta fitojë vetë riskun e tij dhe që nuk pret asnjë gjë prej askujt.

Sipas shpjegimit që jep Auf ibn Maliku (r.a.), disa prej atyre personave, që morën pjesë në këtë besatim, e kanë vlerësuar në kuptimin e përgjithshëm "moskërkimin e ndonjë gjëje prej askujt". Për këtë arsye, edhe nëse u binte në tokë shkopi kur ishin në kurrizin e kafshës, nuk kërkonin prej askujt që t'ua jepte. Sahabët e nderuar kanë qenë jashtëzakonisht të përpiktë në këtë çështje. Në këtë mënyrë, është treguar qartë se ndërmjet çështjeve që mundësojnë nderin dhe krenarinë e jetës së myslimanit, siç është besimi, ibadeti dhe bindja, rëndësi të jashtëzakonshme ka edhe moskërkimi i asgjëje prej të tjerëve.

Në një transmetim të një hadithi tjetër, Auf ibn Maliku (r.a.) thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin

e Allahut, (a.s.), duke thënë: *"Udhëheqësit më të mirë të shtetit janë ata që ju duan dhe që i doni, që luten për ju dhe që marrin lutjet tuaja. Ndërsa udhëheqësit më të këqij të shtetit janë ata që ju urrejnë dhe që janë bërë objekt i urrejtjes suaj, që ju mallkojnë dhe që marrin mallkimet tuaja."* Nisur nga këto fjalë, e pyetën: "O i Dërguari i Allahut! A të luftojmë kundër tyre?" Ai na dha këtë përgjigje: *"Jo, përderisa të falin namaz ndërmjet jush. Jo, përderisa të falin namaz ndërmjet jush."* (Muslim, Imare, 65-66.)

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në këto hadithe tregon se ata që udhëheqin dhe ata që udhëhiqen duhet të jetojnë në harmoni dhe paqe të plotë, sepse njerëzit kanë nevojë për paqe dhe qetësi, në mënyrë që të kryejnë detyrat fetare dhe detyrat e kësaj bote. Pra nëse udhëheqësit si kryetari i shtetit dhe administruesit si prefekti, etj., janë të drejtë në jetën e tyre personale e në qëndrimet administrative dhe veprojnë me drejtësi e mëshirë kundrejt popullit, edhe populli i do ata, lutet për ta dhe i bindet atyre. Ky qëndrim i popullit e kënaq udhëheqësin. Për këtë arsye, edhe ai e do popullin dhe i lutet Allahut Teala që t'i çojë mirësi. Dashuria dhe mirëkuptimi i ndërsjellë mundësojnë zhvillimin dhe forcimin e shtetit, të jetuarit në paqe dhe i motivon të dy palët që të jenë më produktivë.

Udhëheqësit që nuk bëjnë jetë të ndershme, që nuk veprojnë me drejtësi kundrejt popullit dhe që nuk sillen me mëshirë kundrejt shtetasve të tyre, gjithmonë shkaktojnë pakënaqësi. Populli nuk i do ata dhe për këtë arsye nuk u bindet dhe lutet që të rrëzohen e në vend të tyre të vijnë të tjerë. Këta udhëheqës , duke parë pakënaqësinë e popullit dhe kundërshtimin e tij, bëhen edhe më të ashpër në qëndrimet e tyre. E gjithë kjo situatë largon mundësinë e të jetuarit në paqe, si për popullin, ashtu edhe për udhëheqësit.

Auf ibn Maliku (r.a.) rrëfen se i kanë thënë Pejgamberit tonë të nderuar: "O i Dërguari i Allahut! Kur të gjendemi në këtë situatë, a të luftojmë kundër këtyre udhëheqësve të këqij për t'i rrëzuar dhe hequr qafe?" Në një transmetim në Sahihun e Muslimit është përdorur shprehja: "A t'i nxjerrim shpatat dhe të luftojmë kundër tyre?"

Ngaqë veprimet, si kryengritja kundër udhëheqësve dhe luftimi i tyre, mund t'i shkaktojnë shtetit dëme të mëdha dhe mund ta zhdukin paqen e qetësinë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka sqaruar: *"Jo, mos luftoni kundër tyre përderisa të falin namaz ndërmjet jush!"*

Ky hadith fisnik tregon se namazi me të vërtetë është shtyllë e fesë dhe se është një faktor që i bashkon njerëzit me njëri-tjetrin dhe që e mban shtetin në këmbë. Ndërsa në pjesën e fundit të këtij hadithi, që nuk e dhamë deri tani në këtë material, thuhet:

"Nëse dikush e shikon personin që udhëheq shtetin duke bërë një mëkat të madh, le ta urrejë atë mëkat, por të mos bëjë kryengritje kundër udhëheqësit të tij!"

Një kryetar i mirë shteti duhet ta dojë popullin dhe duhet të përpiqet për mirëqenien e tij. Ndërsa një popull i mirë duhet ta vlerësojë administruesin e mirë, duhet ta dojë dhe duhet ta ndihmojë që të arrijë suksesin.

Për sa kohë që personat që udhëheqin shtetin, falin namazin dhe nuk e kundërshtojnë haptazi Allahun, nuk mund të bëhet kryengritje kundër tyre.

Transmetohet se Ebu Abdurrahman Auf ibn Maliku (r.a.) ka thënë: I Dërguari i Allahut, (a.s.), fali një namaz xhenazeje. Atë e dëgjova duke u lutur dhe menjëherë e mësova përmendsh lutjen e tij:

"O Allah! Fale, mëshiroje dhe mbroje nga ndëshkimi e vështirësitë atë! Falja mangësitë! Dhuroji pjesë prej Xhenetit dhe zgjeroja vendin ku do të hyjë (varrin)! Pastroje atë me ujë, dëborë dhe akull! Pastroje atë nga mëkatet siç pastrohet rroba e bardhë nga papastërtia! Jepi një shtëpi më të mirë se shtëpinë e tij, jepi një familje më të mirë se familjen e tij dhe jepi një bashkëshorte më të mirë se bashkëshorten e tij! Fute në Xhenet dhe mbroje nga dënimi i varrit dhe Xhehenemit!"

Auf ibn Maliku thotë: "Kur e dëgjova këtë lutje të bukur, me vete thashë: 'Ah sikur të isha unë në vend të këtij të vdekuri!' (Muslim, Xhenaiz, 85. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Xhenaiz, 38; IbnMaxhe, Xhenaiz, 23.)

Auf ibn Maliku (r.a.) u largua nga Medina në periudhën e kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.) dhe shkoi në Humus. Deri në vitet e para të periudhës së Abdulmelik ibn Mervanit jetoi në Humus dhe aty ndërroi jetë. Prej tij kanë transmetuar hadithe sahabët si Ebu Hurejra (r.a.), Ebu Ejjub el-Ensariu (r.a.), Mikdam ibn Ma'dikerib dhe tabiinët si Ebu Muslimel-Havlani, Ebu Idrisel-Havlani dhe Shabi.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu na bëftë të gjithëve të dashuruar pas besimit dhe dijes si Auf ibn Maliku (r.a.)! Amin!



KUPTIMI i "Moralit të Lartë"


Xhafer Durmush

Në suren Kalem, për të Dërguarin e Allahut, (a.s.), thuhet: ***"Sigurisht që ti ke një moral të lartë."***[1] Domethënë ai lavdërohet në formën: "Ti ke një moral të lartë, esencën e të cilit nuk mund ta kuptojë asnjë krijesë." Fjala "huluk", që këtu i jepet kuptimi "moral", është cilësuar me atributin "azim", që shpreh madhështinë dhe sublimitetin. Me këtë term është shprehur shumë qartë se morali i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), përfshin të gjitha moralet e larta. Këtë të vërtetë e shpreh edhe hadithi fisnik në të cilin thuhet: *"Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e lartë."*[2] Gjithashtu, edhe nëna jonë, Aishja (r.anha), ka thënë: "Morali i tij ishte Kurani."[3] Siç shprehet edhe në literaturën e tefsirit, në moralin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), gjendej falënderimi i Nuhut (a.s.), miqësia e Ibrahimit (a.s.), sinqeriteti i Musait (a.s.), mbajtja e premtimit të Ismailit (a.s.), durimi i Jakubit dhe Ejubit (a.s.) dhe modestia e Sulejmanit dhe Isait (a.s.), gjithashtu gjendej edhe morali i lartë i pejgamberëve të tjerë.[4] Pra virtytet që u ishin dhënë pejgamberëve të tjerë, ishin mbledhur të gjitha në personalitetin e Pejgamberit tonë të nderuar.

Morali i lartë që Allahu Teala dëshiron për robin e Tij, ka arritur përsosmërinë te personaliteti i të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Morali dhe cilësitë e bukura janë bashkuar në veprimet dhe sjelljet e tij (a.s.). Të gjitha gjendjet njerëzore duke filluar që nga bujaria e deri te kursimi, nga marrja e masave e deri te mbështetja te Zoti (xh.xh.), janë bërë shembull e model praktikimi përmes personalitetit të tij.

Edhe pse cilësitë e bukura nuk janë të kundërta me njëra-tjetrën, bashkimi i të gjithave tek një person, në nivelin e përsosmërisë, është mjaft i vështirë. Në përgjithësi, një cilësi e lartë që shfaqet tek një njeri në nivelin më të lartë, mund të dobësohet nga një cilësi tjetër që edhe ajo është prej moralit të lartë. Për shembull, kur butësia e qetësia të bashkohen me trimërinë, kur të bashkohen modestia dhe madhështia, drejtësia dhe mëshira, kursimi dhe bujaria, kur të bashkohen mbështetja te Zoti me marrjen e masave, nuk është e lehtë që të mbahen në një ekuilibër, të mbahen në nivelin më të lartë dhe të përfaqësohen e të përsosen në të njëjtën kohë, cilësi të tilla së bashku. Kjo është mrekullia që pasqyrohet në moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Pra, sjelljet me dinjitet që duken sikur janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, janë shfaqur në personalitetin e tij të bekuar dhe që të gjitha kanë dalë në pah në nivelin më ideal.

Për këtë arsye është thënë: "Trashëgimia më e madhe që i ka mbetur umetit nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), pas predikimit të Kuranit Fisnik, është morali i lartë i tij, sepse ai si një rob dhe i Dërguar i Allahut ka përjetuar përgjatë jetës çdo lloj gjendjeje që mund të përjetojë një njeri dhe ka treguar se cila është zgjidhja më e drejtë. Çdo vepër e tij (a.s.) ka qenë për hir të Allahut Teala. Pra, dhënia, marrja, zemërimi, gëzimi dhe ndëshkimi që bënte Pejgamberi ishin për hir të Allahut dhe në emër të Allahut



(xh.sh.). Marrëdhënia e tij me krijesat gjithmonë ka qenë brenda kornizës së dhembshurisë dhe mëshirës. I Dërguari i Allahut, (a.s.), gjithmonë falte, toleronte, jepte dhe këshillonte mirësi e bukuri. Ai njëkohësisht bënte shumë kujdes që të mos i shkelte kufijtë e Allahut dhe shfaqte ndjeshmëri të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njerëzve. Ai u mësoi sahabëve modestinë, bujarinë, altruizmin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira me njerëzit. Kurdo që i jepej mundësia, fliste për shëmtinë e mendjemadhësisë, smirës, egoizmit, urrejtjes dhe lakmisë. Ai i mësoi sahabët që t'i jepnin përparësi vëllait mysliman qoftë edhe kundrejt vetes dhe u tregoi atyre për rëndësinë e hapjes së zemrës ndaj umetit. Nisur nga ky kontekst, u tregoi atyre se një buzëqeshje në vendin e duhur mund të jetë e vlefshme dhe e dobishme sa një lëmoshë që i plotëson nevojat.

Ndër të tjera mund të themi edhe që gjëja më e rëndësishme që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka mësuar njerëzimit, është se vlerat njerëzore nuk ndryshojnë me kalimin e kohës dhe ndërrimin e kushteve. Prandaj mund të themi se buzëqeshja, butësia, bujaria dhe sakrifica gjithmonë janë cilësi të bukura. Deri në ditën e Kiametit zemrat do të çlirohen nga cilësi të tilla. Njëlloj, mendjemadhësia, smira dhe egoizmi përgjithmonë do të jenë të padëshiruara.

Ndërtimi i personalitetit të myslimanit mund të bëhet duke zhvilluar cilësitë pozitive që radhitëm këtu dhe duke edukuar largimin nga cilësitë e urryera, që gjenden në natyrshmërinë e njeriur për ndonjë urtësi të caktuar. Në suren Ahzab thuhet:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."[5]

Në këtë ajet fisnik, përmendja e moralit të lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe shkaqeve që e kanë bërë atë shembull për njerëzimin, nuk bëhet thjeshtë për të na njohur ne me to, por ka si qëllim që ne të kemi parasysh se si e kalonte natën e ditën Pejgamberi dhe të ndikohemi që ta pasojmë atë në ibadet e tregti. Pra, qëllimi është që ne të ndjekim traditën e atij, morali i të cilit ishte Kurani.

Islami përbëhet nga bazat si itikadi/besimi, ibadeti, veprat dhe morali. Çka përbën kuptimin e tri bazave të para dhe i zbukuron të gjitha, është morali i lartë. Moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nuk e kundërshtuan dot as armiqtë e tij, ndonëse me propozimin e fesë së re trondit totalisht gjendjen në të cilën ndodhej shoqëria e injorancës. Atëherë, thelbi i kësaj çështjeje është që shfaqjet e atij morali të lartë t'i mbartim edhe në ditët e sotme.



NIVELI I PENDESËS

Në suren Nebe' thuhet: ***"Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: "Ah, sikur të isha pluhur!"***[6] Prej këtij ajeti fisnik kuptojmë se në Ditën e gjykimit, të gjithëve do t'u sillen përpara të detajuara veprat që kanë bërë. Para secilit do të vendoset grafia e detajuar e jetës së tij. Siç thuhet në suren Kaf, çdo njeriu do t'i hapen perdet pasi të vdesë dhe do t'i shikojë në një mënyrë mjaft të qartë ngjarjet dhe natyrën e tyre.[7]

Ndoshta njeriu do t'i shohë të gjitha ngjyrat në filmin e jetës së tij. Ndoshta edhe adhurimet që nuk i ka kryer dot me sinqeritet do t'i dallojë ngaqë do të kenë ngjyrë të dobët përgjatë filmit. Atëherë ai do të ndjejë pendim duke thënë me vete: Përse nuk i kam kryer më mirë? Ndërkohë, niveli i pendimit te të gjithë do të jetë i ndryshëm. Pendimi i atyre që e kanë kaluar jetën me mohim, mëkat dhe shkujdesje ndaj Zotit (xh.sh.), do të jetë shumë i madh. Ndërsa ata që kanë qenë qafirë do të thonë: "Ah, sikur të isha bërë pluhur!" Ata do të shprehen në këtë mënyrë, sepse grafia e jetës së tyre do të jetë krejt e zezë, apo krejt e kuqe. Aty nuk do të shohin asnjë dritë shprese.

Siç na ka njoftuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), të gjithë ata që do të vdesin do të pendohen. Edhe ata që përpiqen ta thurin jetën e tyre me vepra të mira, do të ndjejnë pendim duke thënë: "Mund t'i bëja më mirë." Dëshmorët do t'i përgjërohen Zotit (xh.sh.) që t'i dërgojë edhe një herë në këtë botë, në mënyrë që ta marrin përsëri shpërblimin e dëshmorit. Kështu që të gjithë njerëzit do të pendohen sipas veprave të tyre. Ndërkohë vlen të theksojmë se ndjenja e pendimit që do të kenë qafirët, mëkatarët dhe të shkujdesurit nuk do të jetë e njëjtë me ndjenjën e shqetësimit që do të kenë ata që kanë jetuar duke u përpjekur që të mos jenë të shkujdesur ndaj Allahut Teala.[8]

Tashmë pyetja që mund të parashtrojmë është kjo: "Sa mund ta afrojmë nivelin e pendimit tonë tek niveli i pendimit të miqve të Allahut, të cilët vazhdimisht janë përpjekur të përparojnë në përsosmëri?

Referencat: ***1.*** Kalem, 4; ***2.*** Muvatta, Husnu'l-Hulk, 8; ***3.*** Muslim, Salatu'l-Musafirin, 139; ***4.*** Ismail Hakki Bursevi, Ruhu'l-Bejan, Botimet Erkam, vëll. 22, fq. 96; ***5.*** Ahzab, 21; ***6.*** Nebe', 40; ***7.*** Kaf, 22; ***8.*** Shik. Surja Junus, 62-63.



PROBLEMI I MUNGESËS SË SERIOZITETIT

Idris Arpat

Në Shqipëri po përjetohet një problem mjaft i rëndë, që konsiston në mungesës e seriozitetit. Pavarësisht shkaqeve që kanë sjellë këtë situatë, e vërteta e hidhur është se jeta nuk po merret seriozisht dhe nuk po jetohet duke iu dhënë haku. Le ta hapim çështjen dhe ta bëjmë edhe më të kuptueshme:

Nëse jam mysliman dhe dua të jetoj si i tillë, atëherë a nuk më duhet që së pari të mësoj fenë time? Këtë ishte dashur ta bëja të paktën që kur kam filluar të mendoj dhe të kem fuqi. Pastaj duhet të përpiqem të jetoj duke u bazuar në dijet, mendjen dhe ndërgjegjen time. Nëse mësoj gjëra të rëndësishme përgjatë jetës, atëherë këto duhet të përpiqem t'i reflektoj. Në këtë mënyrë, jeta do të jetohet me bukurinë që vlerëson Allahu i madhëruar. Serioziteti këtë kërkon.

Një jetë e tillë përputhet plotësisht me konceptin ubudijet. Ubudijet do të thotë përpjekjë për të realizuar të gjithë jetën, veprat, fjalët, qëllimet dhe ndjenjat, nga a-ja deri te z-ja, në një formë të përsosur, që t'i pëlqejë Allahut, gjithmonë duke marrë për bazë kënaqësinë e Tij. Ndryshe, kjo mënyrë të qeni emërtohet " Ihsan".

Sa u tha më sipër, përmbledh formën ideale të qenies e cila fatkeqësisht nuk shihet e zbatuar në realitetin tonë. Shumica e njerëzve nuk kanë qëllim primar mësimin e fesë në formën e duhur dhe as të jetuarit drejt dhe ndershmërisht. Njerëzit zvarriten në rrugën e tyre me indiferentizëm dhe pastaj përjetojnë një rehati psikologjike, e cila është një mashtrim në plot kuptimin e fjalës. Madje, është fillimi i një fundi të qartë.

Feja është vetëdija se çdo gjë ia kemi borxh Allahut dhe përpjekja për ta kthyer këtë borxh, duke u shkrirë me urdhrin hyjnor dhe duke iu dorëzuar Zotit me gjithë vullnetin tonë. Të jesh mysliman, në kuptimin më të gjerë të fjalës, do të thotë që cilatdo qofshin detyrat tona, të jemi të gatshëm t'i kryejmë. Këtë na e shpjegon Kurani Fisnik, nga fillimi deri në fund.

Tani le ta shohim gjendjen aktuale edhe nga ky aspekt:



Problemi në thelb nis nga fakti se personat që shpjegojnë fenë, nuk e njohin mjaftueshëm Kuranin Fisnik, i cili është burimi kryesor i fesë, dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), që është gjendja në zbatim e Kuranit. Ato që u mësohen njerëzve në emër të fesë nuk janë prej burimit kryesor, por riprodhim nga materiale të dëgjuara nga të tjerët. Njerëzve iu mësohet vetëm "Islami i ilmihalit", ndërkohë që Ilmihali është veçse hapi i parë në dijen e pafundme të Islamit. Për këtë arsye, Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), duhet të vendosen para njerëzve si libra mësimor, me të cilët ata do të edukohen fazë pas faze. Njerëzit e aftë dhe autoritarë në çështjet fetare, duhet t'i njohin myslimanët me fenë. Mësimi i fesë nuk mund të lihet në dorën e njerëzve të papërgatitur dhe të papërshtatshëm, përndryshe vazhdimisht do të ketë edhe skandale paralele. Ndërsa myslimani nuk mund të lejojë të kafshohet (nga gjarpri) dy herë në të njëjtën pikë.

Për fat të keq, në çdo fushë të jetës, punët po ndjekin këtë menefregizëm.

Tashmë le të flasim për institucionin e edukimarsimimit:

Ata që e njohin mirë mësimdhënien në të gjitha dimensionet dhe e dinë se ky është "profesion profetik", a mund të thonë se i është dhënë përkujdesja e duhur? Nga çdo anë dëgjojmë ankesa për këtë temë: "Kemi arritur fundin!" Duket sikur e gjithë kjo përpjekje po bën që fëmijët të arrijnë në gradën: "Sa më shumë lexojnë, aq më shumë bëhen injorantë." Zot na fal! Edukimi është një çështje mjaft serioze. Ai kurrë nuk duhet të shpërfillet dhe as të trajtohet si lojë apo dëfrim. Sado i ndjeshëm të jetë një njeri që nuk ka marrë edukim të mirëfilltë, gjithsesi do të mbetet në oborrin e jashtëm të jetës. Në çdo mendim dhe ndjenjë ka zëra që nuk mund t'i kuptojë një vesh që nuk ka marrë edukim. Edukimi është pothuajse shqisa jonë e gjashtë. Edukimi është një proces i domosdoshëm për të zhvilluar aftësitë tona, deri tek më delikatet.

Njeriu duhet të përpiqet ta marrë dijen si një mjet që e shpie atë tek mendimet e vyera, e jo si një qëllim. Edukimi duhet ta ndihmojë njeriun që të kuptojë jetën, më shumë se sa që të fitojë para. Gjithsecili nga ne duhet të ndihmojë për të arritur kënaqësitë e pafundme.

Le të supozojmë se jeni një kryetar bashkie. Çfarë ju kërkon serioziteti në këtë post?

Së pari duhet ta njihni punën tuaj në çdo aspekt. Gjithashtu duhet t'i dini edhe përgjegjësitë tuaja. Pastaj në aspektin e planeve dhe projekteve, ju mund të bëni planifikim të kohës duke marrë parasysh mundësitë tuaja. Pastaj duhet të vendosni njerëz specialistë nëpër pozita të rëndësishme dhe të filloni punën. Qëllimi juaj duhet të jetë i pastër.

Ndërkohë mund të hulumtoni edhe për ato që kanë arritur të bëjnë kryetarët e suksesshëm të bashkive nëpër botë dhe në Shqipëri.

Duhet theksuar se ne duhet të jemi prej atyre që mendojnë se çfarë mund t'i japin këtij populli dhe jo prej atyre që mendojnë se çfarë mund të marrin prej popullit, duke përdorur pozitën ku gjenden. Ky niet është jetik për këtë post. Gjithashtu ka disa cilësi të rëndësishme që duhet të kemi gjithmonë parasysh, të cilat janë: të mos kënaqesh lehtë me përpjekjet tuaja, të kesh vizion, botë të gjerë dhe imagjinatë.

Punët tona duhet të aprovohen dhe vlerësimin tonë duhet ta presim nga Arshi i Lartë.

Gjithmonë duhet të kemi kujdes që të mos humbasim emocionin, përndryshe do të xhirojmë në vend, do të biem në pesimizëm para çdo vështirësie të vogël dhe do të tërhiqemi. "Dedikimi" është shpirti i punës.

Një shprehje e famshme thotë: "Dita kur do ta kuptosh ndryshimin ndërmjet asaj që je dhe asaj që duhet të jesh, është një ditë e madhe." Prandaj, duhet ta shohim çdo fushë të jetës në këtë këndvështrim.

Serioziteti arrihet duke e lexuar jetën drejt dhe duke e kuptuar saktë. Nëse çdo krijesë në këtë botë është krijuar për t'i shërbyer njeriut, atëherë edhe njeriu duhet t'i shërbejë njeriut. Kjo arrihet duke prodhuar ushqime për mendjen, zemrën dhe stomakun. Zbukurimi i vetë njeriut dhe i botës ku ai jeton, është shërbim ndaj njeriut - "Maslahatiibad, tamiribilad".

Një njeri që përpiqet të marrë moralin që ia jep feja islame, duhet ta marrë seriozisht punën e tij dhe duhet të përpiqet ta kryejë detyrën pa mangësi.

Për çfarëdo teme që mund të flasim, çështja kthehet tek rëndësia e mësimit dhe edukimit. Mirësitë para së gjithash duhet të gjenden në mendjen dhe zemrën e njeriut, pastaj mund të reflektohen jashtë. Për këtë arsye, urdhri i parë fetar që ka ardhur është: "Lexo!"

"Allahu i Lartësuar ia mësoi "emrat" njeriut të parë."

Ndryshim pa ndryshuar

Nuredin Nazarko

Shoqëria njerëzore është e kategorizuar. Nuk mund të jetë uniforme. Përbrenda këtij kategorizimi hasim nivele të ndryshme të standardeve jetësore. Në jetë do të ndeshësh që nga më të varfrit e deri tek më të pasurit. Nuk mund të japësh shpjegime racionale se përse kjo panoramë në shoqëri. Prezenca e disniveleve është realitet. Lind pyetja se a mund të ndryshohet ky realitet?

Ata që kanë dashur ta ndryshojnë dhe ta sjellin shoqërinë në uniformitet standardi jetësor i kanë dhënë provat. Shoqëria rrëshqet në dhunë dhe degradim. Arsyeja? Çdo sistem organizimi shoqëror që hyn në luftë kundër natyralitetit nuk mund të sjellë ndryshime veçse përdhunshëm.



Natyrisht që kjo është rrugë e vështirë. Edhe fundi i saj nuk është më pak i tmerrshëm sesa fillimi. Në emër të ndryshimit të realitetit me ngarkesa negative sociale, bëhet kërdia përmbi shoqërinë, liritë dhe të drejtat themelore të qenies njerëzore. Nuk besoj që dikush që mendon me akull të mendjes t'u besojë broçkullave për një shoqëri të drejtë nën diktatin e një sistemi politik që qeveris mbi shtypjen flagrante të lirisë.

Atëherë ç'qëndrim të mbajmë ndaj këtij realiteti, ku gjejmë 99 lloje rrojtjesh? Të pajtohemi më statusin social të gjithsecilit dhe të qëndrojmë indiferent? Apo të fillojmë e të besojmë përrallat me shoqëri pa shfrytëzues e të shfrytëzuar edhe njëherë?

Ne jemi të vetëdijshëm se realiteti nuk mund të ndryshohet. Natyralitetit nuk mund t'i kundërvihesh për ta kthyer përmbys, sepse kthehet vetë shoqëria përmbys sikundërse edhe ka ndodhur. Atëherë?

Para se të nisim të veprojmë duhet të jemi të qartë se nëse ky është natyraliteti (99 lloje rrojtjesh) ne nuk mund ta zhbëjmë dhe ta kthejmë përmbys. Po kështu duhet të jemi katërçipërisht të bindur se ky realitet është gur prove për këdo që i qan zemra për një shoqëri ndryshe. Gjëja më e thjeshtë që mund të bëjë njeriu është ankesa dhe dhënia mend si mund të bëhen gjërat mirë.

Vazhdimisht ankohemi. Ankohemi se nuk ecin punët siç duhen. Ankohemi se segmentet e shoqërisë nuk sinkronizohen në lëvizjet e tyre për ndryshime pozitive. Ankohemi se injoranca po na përmbyt dhe nuk po kemi çfarë të bëjmë. Në të njëjtën kohë japim edhe mend, duke u shndërruar në reformatorë e rregullatorë të shoqërisë. Kjo rregullohet kështu. Kjo tjetra rregullohet ashtu. Kjo po të rrotullohesh andej. Kjo tjetra po të rrotullohesh këndej. Teorizime pa fund sesi t'i vendosim punët në binarë. Ankesa dhe teorizime. Binom i preferuar për një shoqëri të ngarkuar emocionalisht. Për një shoqëri që i ka qejf shumë bishtnimet. Për një shoqëri që e ka qejf pasimin e përgjegjësisë, me pasa të shkurtra, të gjata apo krosime. Dhe në fund fare topi i mbetet në duar lojtarit më të dobët. Atij që mund të jetë në pikën më të ulët të standardeve jetësore apo statusit social.

Ndodh kësisoj pasi binomi ankesa dhe teorizime nuk lejon një pjesë të konsiderueshme energjish të vihen në lëvizje në rrjedhën e duhur të ndryshimit. Ndryshimi lidhet me vlerësimin e këtij guri prove që qëndron sfidues përballë nesh. Ne mund të ndryshojmë gjërat duke punuar për ndryshimin e tyre. Dhe ndryshimi vjen duke u përpjekur, duke sakrifikuar në transformimin e perceptimeve të njerëzve që na rrethojnë për mënyrën e të jetuarit. Ky është kushti që gjërat të rrjedhin drejt ndryshimit real dhe jo thjesht ndryshimit fasadë që përdoret për t'u hedhur hi syve njerëzve.

Ata të cilët vazhdojnë t'i mëshojnë binomit ankesa dhe teorizime, presin ndryshime por pa ndryshuar perceptimi mbi mënyrën e jetesës. A mund të ketë kahje pozitive ndryshimi kur ata të cilët flasin për ndryshim, qëndrojnë indiferent ndaj ndryshimit të perceptimit për mënyrën e jetesës? Ose flasin aq pak ndaj së keqes saqë duket sikur janë palë me të. Ose nuk reflektojnë aspak ndryshim në mënyrën e tyre të jetuarit. Atëherë ç'është kjo ankesë, ky teorizim dhe kjo padëshirë për ndryshim?

Duan ndryshim pa ndryshuar. Duan që gjërat të lëvizin duke qëndruar ende në vend. Dhe kjo është absurde. E më pas ankohen se shoqëria ka rrëshqitur në absurd. Ankohen se shoqëria nuk reagon. E ç'mund të bëjnë muskujt kur nervat flenë gjumë? Aq më keq kur nervat ndihen të kënaqur me gjumin që i përngjan gjumit letargjik të shoqërisë.

Shoqëria e masave e ka të vështirë të reagojë vetvetiu. Kjo për të mos thënë e pamundur. Ndihet komode në guaskën e koracuar të 99 lloj rrojtjeve dhe nuk i bën zemra të luajë vendit edhe pse çdo sekondë dëshiron të përmbysë gjendjen ekzistuese. Më parë pranojnë të tërhiqen zvarrë se të ndryshojnë mënyrën e të jetuarit. Por ajo që të çudit janë dakordësimet e atyre që çirren për dobësitë e masës, me mënyrën e jetesës që ka zgjedhur masa të jetësojë.

Nëse dikush ngre zërin kundër ngjarjeve jetësore që i bien ndesh parimeve të epërme, binomi ankesë dhe teorizim, vihet në lëvizje për të bërë avokatin e masës duke u justifikuar se s'ka ndonjë problem me këtë pjesë. Jeta duhet jetuar. Atëherë le të jetojnë me ankesat dhe teorizimet, me absurdin e krijuar nga ky letarg i dëshirueshëm për ta. Nëse gjërat do të viheshin në lëvizje për mirë nuk do të kishte kaq shumë lëndë amorfe mbi të cilën do të zbraznin mllefin e pafuqisë së tyre për të qëndruar fort përballë letargut si e keqja më e rëndë se vetë e keqja.

Natyrisht që kjo është fatkeqësi. Por tek e fundit çdo joanëtar i binomit mund të vazhdojë hapërimin kontribues në shkundjen e çdo anëtari të masës nga letargu. Nuk është me rëndësi primare sasia. Mjafton qoftë dhe një i vetëm të ndryshojë dhe kjo është shenjë se diçka po lëviz. Më mirë të ecim si breshka sesa të qëndrojmë në vend vetëm me ankesa dhe teorizime në xhep.

"O besimtarë! Kërkoni ndihmë
për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!
Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit."

(Bekare, 49)

Një Ajet

Kurani e konsideron jetën si një shkollë, kurse njeriun si nxënësin e saj përmes së cilës njeriu aftësohet, zhvillohet duke arritur pjekurinë e duhur për të përmbush qëllimin për të cilin është krijuar. Allahu na urdhëron të dalim nga kjo shkollë të çliruar nga veset e këqija dhe të zbukuruar me virtyte.

Në shumë vende të Kuranit flitet për durimin dhe shpërblimin e madh që i sjellë ai njeriut, duke nxitur që durimi të bëhet veti e pandashme e çdo besimtari. Sepse përgjegjësia me të cilën është ngarkuar njeriu në këtë botë është e madhe. Nga njëra anë besimtarit i duhet të përballet me pengesat që i dalin përpara gjatë rrugës së komunikimit dhe përçimit të mesazhit islam nga ana tjetër i duhet të luftojë me botën e tij të brendshme kundër egoizmit i cili është në natyrën e njeriut dhe ngacmimeve të shejtanit. Për këtë arsye njeriu duhet të pajiset me vetinë e durimit për të ngadhënjyer mbi vështirësitë.

Durimi është aftësia për të duruar e për të përballur vështirësi, shqetësime vuajtje fatkeqësi në rrugë të drejtë, pa u ankuar e pa u ligështuar. Ashtu si nuk ka lidhje me kokëfortësinë, durimi nuk ka lidhje as me mungesën e reagimit ndaj të keqes. Besimtari duhet të jetë krenar dhe i nderuar dhe jo t'i nënshtrohet padrejtësive. Durimi së pari është cilësi dalluese e Pejgamberëve të Zotit dhe ndjekësve të tyre besnikë. Një sërë cilësish morale fitohen nëpërmjet durimit, të jetuarit si mysliman është e lidhur ngushtë me durimin kur u pyet Pejgamberi a.s se çfarë është imani? Tha **"të jesh durimtarë dhe tolerant"** durimi është faktor vendimtar në sigurimin e ndihmës së Allahut dhe për pasojë suksesit **"Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit"**. Pra ndihma e Allahut është pranë durimtarëve. Durimi është një veti që i sjellë besimtarit, përfitime materiale dhe shpirtërore. Durim është formula për sukses në këtë botë dhe lumturi të përjetshme në botën tjetër. Pa durim nuk mund të arrihet as morali i lartë dhe as ibadetet nuk do mund të kryhen siç duhet, pa durim njeriu nuk mund të ketë sukses as në studime as në jetën profesionale. Besimtari duhet të jetë i durueshëm me familjen, me të afërmit, me fqinjët, me shokët në çdo kohë dhe çdo mjedis duke i përballuar me qetësi shqetësimet që mund të vijnë prej tyre.

Një nga mënyrat më të mira për t'i kërkuar ndihmë Allahut është namazi. Rukuja dhe sexhdja në një mënyrë është lutje për ndihmë. Durimi dhe namazi janë përmendur puqur për rolin që kanë në arritjen e ndihmës së Allahut ,durimi dhe qëndresa përballë vështirësive të kësaj botë kanë nevojë për mbështetje shpirtërore. Namazi nëpërmjet, lidhjes së ngushtë që krijon ndërmjet besimtarit dhe krijuesit e bën të qëndrueshëm përballë vështirësive. Namazi gjatë rrugës së jetës është ushqimi më i rëndësishëm për besimtarin sepse namazi e mban larg njeriun nga vesveset e shejtanit dhe kështu njeriu vazhdon rrugën e tij pa u ligështuar.

Durimi merr vlerë vetëm në një moment të caktuar dhe ai është momenti i parë i përballjes me vështirësitë. Një karakteristike e jetës së njeriut është ndryshueshmëria, për një moment jeton i gëzuar i lumtur pastaj papritur mund të përballet me një fatkeqësi ose anasjelltas.

Jeta nuk është gjithmonë bardh e zi ajo është e mbushur me të gjithë spektrin e ngjyrave

Jeta e njeriut nuk është gjithmonë e lumtur apo e trishtueshme shpesh këto gjendje zëvendësojnë njëra-tjetrën gjatë jetës. Jeta e njeriut rrjedh ndërmjet këtyre dy gjendjeve. Për rrjedhojë duhet të jemi të përgatitur për çdo të papritur dhe surprizë që mund të na ofrojë jeta me uljet dhe me ngritjet e saj.

Ebu Hurejra (r.a.) transmeton se Resulullahi (a.s.) ka thënë:

"Prej shenjave të besimtarit të mirë është braktisja e të padobishmes."

(Buhari)

Një Hadith

Allahu çdo gjë në këtë botë e ka krijuar për dobi të njerëzve për rrjedhojë asgjë në këtë botë nuk është e padobishme por jo gjithmonë çdo gjë është në dobi të çdo njeriu. Në hadithin e mësipërm çdo gjë që nuk sjell përfitim për këtë botë apo botën tjetër konsiderohet e padobishme.

Pejgamberi a.s përmes hadithit nxit besimtarët të përsosin besimin e tyre duke braktisur çdo gjë që nuk është në interes dhe dobi të tyre. Tregues i besimtarit të mirë janë virtyte të tilla si drejtësia, besnikëria, ndershmëria kurse tregues i besimtarit të dobët është gënjeshtra, tradhtia, pabesia. Ky hadith i drejtohet gjithë bashkësisë islame për të pajisur me virtyte që zbukurojnë besimin dhe i afrojnë tek Krijuesi. Eliminimi i një sërë dukurive negative në shoqëri bëhet e mundur me braktisjen e gjërave të padobishme. Preokupimi i njeriut me gjëra të dobishme është në interes të tij sepse nëse ai nuk e bën këtë do të bjerë në kurthet e mëkateve. Kush preokupohet me njerëzit harron veten e tij dhe merret me thashetheme.

Një tjetër kuptim i rëndësishme që nxjerrim nga hadithi është edhe rëndësia e kohës sepse njeriu që merret me gjëra të padobishme ka harxhuar kohën, mirësinë më të madhe që i është dhuruar njeriut.

Kriter për të përcaktuar saktë çfarë është e dobishme dhe çfarë jo është feja dhe jo opinioni i njerëzve për sepse sot po vihet re në mesin e myslimanëve indiferentizëm i theksuar ndaj shumë dukurive negative që janë urdhëruar me sheriat të pengohen, me pretekstin se nuk iu interesojnë. Kjo nuk është largim nga e padobishmja por shmangie nga përgjegjësitë siç është këshillimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Mos preokupimi me punë të padobishme është shenje e besimit të përsosur

2. Njeriu duhet të angazhohet me punë që sjellin përfitime në këtë botë dhe në botën tjetër

3. Braktisja e të padobishmes vjen si pasojë e ndërgjegjësimit të personit se në çdo moment është në mbikëqyrjen e Allahut.

UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- PJESA I -



Është një ligj hyjnor që Allahu i Madhëruar e ka caktuar për çdo gjallesë që ka krijuar: Çdo i lindur jeton afatin kohor që i është caktuar dhe kur të arrijë fundin e këtij afati, do të vdes patjetër. Asnjë gjallesë nuk mund të përjashtohet nga ky ligj. Jeta shkon në formë cikli brenda një rrjedhe përkohshmërie.

Kjo e vërtetë shprehet në këto ajete fisnike:

"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra *(Qenia)* ***e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."*** (er-Rrahman, 26-27.)

Kjo botë është krijuar si një vend sprove hyjnore. Në çdo ngjarje që ndodh në të gjenden manifestime të panumërta urtësie. Për rrjedhojë edhe në çdo mirësi apo fatkeqësi që ndodh, gjenden shumë mësime për ata që mendojnë thellë. Detyra e kësaj bote do të përfundojë me vdekjen e njeriut të fundit që do të jetojë mbi tokë, e më pas do të shkatërrohet. Pas kësaj, me vullnetin e Allahut të Madhëruar, do të fillojë një rregull i ri dhe një tjetër lloj jete.

Kjo gjithësi, e cila është pasqyrë e shfaqjes së qëllimeve dhe urtësive të pafundme, është një shkollë e madhe hyjnore e pajisur më së miri dhe e zbukuruar, për t'i dhënë njeriut vetëdijen dhe kuptimin e devotshmërisë ndaj Allahut. Pra, njeriu është dërguar në këtë botë për t'u arsimuar në devotshmëri dhe për të vërtetuar (me vepra) besnikërinë e tij ndaj Allahut.

Ekzistenca e njeriut mbi tokë nuk është aspak një aventurë e rastësishme dhe pa urtësi. Me qëllim që njeriu të fitojë vetëdijen dhe kuptimin e devotshmërisë, atij i janë dhënë mendja, logjika dhe aftësia për të kuptuar. Përveç këtyre, Allahu i Madhëruar gjithmonë i ka treguar atij rrugën e drejtë me anë të profetëve që ka dërguar dhe fletëve apo librave që ka zbritur. Të gjitha krijesat, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, që prej mikros e deri tek makroja, janë krijuar me një urtësi dhe qëllim të caktuar. Në Kuranin Fisnik sqarohet:



"Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur!" (Duhan, 38.)

"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?" (Kijame, 36.)

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?!" (Mu'minun, 115.)

ÇDOKUSH DO TA SHIJOJË VDEKJEN!

"Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit(për asgjë tjetër), përveçse që të Më adhurojnë Mua!" (Dharijat, 56.)

Në këtë ajet, Zoti ynë i Madhëruar shprehet se prej nesh dëshiron vetëm që ta adhurojmë Atë. Pra njëkohësisht, Ai dëshiron që ne të ngrihemi në gradë shpirtërore dhe të arrijmë njohjen e Tij (marifetullah), pra ta njohim Atë me zemër.

Nisur nga kjo, mund të themi se, nëse dikush jeton dhe vepron si një udhëtar i shkujdesur, pa e ditur qëllimin e ardhjes së tij në shkollën e kësaj bote të përkohshme, përgjegjësinë e tij në këtë jetë dhe urtësinë e lindjes në këtë botë dhe hedhjes së tij në vorbullën e vdekjes, ai me të vërtetë është i mashtruar. Është me të vërtetë një dështim i hidhur nëse dikush e kthen këtë botë në sheshin e veprave të tij të ulta, pa e menduar se do të japë llogari për gjithçka në botën tjetër! Shpëtimi prej këtij dështimi të hidhur është i mundur vetëm nëse frymëmarrjet e numëruara i vlerëson si lëvizje në udhëtimin e përjetësisë.

Padyshim se **"vdekja"**, tek e cila do të arrijë patjetër çdo udhëtar i jetës, është një enigmë të cilën janë të detyruar ta zgjidhin të gjithë ata që kuptojnë. Për rrjedhojë, në ajetin 35 të sures Enbija, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Çdokush do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe e me të mirë dhe te Ne do të ktheheni."

Ndërsa në ajetin 2 të sures Mulk urdhëron:

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..."

Pra vdekja është një realitet i paevitueshëm i së ardhmes për çdo të përkohshëm. Të mos harrojmë se nuk ekziston as vend ku të ikim prej vdekjes, as mundësi të kthehemi prej varrit dhe as strehë ku të strehohemi prej tmerrit të Kiametit. Kurani Fisnik u drejtohet me këto fjalë atyre që duan të ikin nga realiteti i vdekjes:

"Thuaj: «Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë ju për atë që keni bërë.»" (Xhum'a, 8.)

"Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!.." (Nisa, 78.)

E meqenëse nuk ka shpëtim nga vdekja, ajo që duhet të bëhet është:

TË PËRPIQESH TË ZBUKUROSH VDEKJEN

Por, si zbukurohet vdekja? Për kë bëhet vdekja si një kthim nga kurbeti dhe takim me të dashurit?

Ashtu siç është kusht një ecuri e mbarë për një përfundim të mirë, ashtu është e domosdoshme edhe një jetë e zbukuruar me vepra të mira dhe në rrugë të drejtë në këtë botë, për të gëzuar një jetë të lumtur në botën tjetër. Një vdekje që hapet drejt lumturisë së përjetshme, fitohet vetëm nga një jete e pastër e kaluar nën dritën e besimit dhe Kuranit.

Për rrjedhojë një mysliman nuk duhet ta harrojë Islamin në asnjë fazë të jetës së tij. Ai duhet të përpiqet që t'i përdorë njëzet e kater orët e tij si Profeti ynë i nderuar (a.s.), që i është prezantuar atij si udhëzuesi më i mirë. Madje, në lidhje me këtë çështje, ai duhet ta peshojë veten vazhdimisht.

Omeri (r.a.), ka thënë:

"Llogariteni vetveten para se të llogariteni. Zbukurohuni (me vepra të bukura) për audicionin tuaj më të madh (për ditën kur të dilni para Allahut)! Padyshim se për atë që e ka llogaritur vetveten në jetën e kësaj bote, llogaridhënia do të jetë e lehtë në Ditën e Gjykimit." (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459.)

Për shembull, një mysliman duhet që çdo natë të bëjë llogarinë e ditës së shkuar dhe t'i drejtojë vetes këto pyetje:

- Si e hape librin e jetës këtë mëngjes? A e falënderove Zotin tënd që të fali një ditë të re?

- A nxitove të takoheshe me Zotin tënd në kohën para agimit, kur Ai të fton për t'i kërkuar falje? Sa arrite të përfitoje prej mëshirës dhe faljes hyjnore që gufon në atë kohë? Apo mos ndoshta i ke humbur në gjumë këto mundësi të vyera?

- A ke mundur ta bartësh gjatë gjithë ditës frymë-

zimin e kohës para agimit? Sa kohë ke kaluar sot në atmosferën e përmendjes së Allahut? Sa kohë qëndrove në frymëzimin shpirtëror të përmendjes së Zotit tënd?

- A meditove sot në lidhje me vdekjen, e cila t'i asgjëson kënaqësitë e egos?

- Sa i je drejtuar Zotit sot duke u zhveshur nga shqetësimet e panevojshme të jetës? Sa thellë të kanë bërë të meditosh manifestimet dhe shfaqjet hyjnore të cilat ke hasur?

- Sa kohë namazi ke falur me xhemat, duke iu përgjigjur ftesës hyjnore që ngrihej prej minareve? A munde t'i falje namazet me përkushtimin e duhur dhe harmoninë zemër-trup me të cilën kënaqet Allahu?

- A ke bërë kujdes nëse fitimi yt i sotëm, ushqimi, pija dhe veshja jote janë hallall, të dyshimta apo haram? A të ka shoqëruar ndjenja e ruajtjes prej harameve në çdo veprim?

- A je kujdesur sot për të drejtat e njerëzve të tjerë? A mund të thuash, "unë s'i kam hyrë në hak asnjë robi dhe nuk kam lënduar askënd!"?



- A ke mundur sot t'i shohësh krijesat me syrin e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë së Krijuesit?

- A je kujdesur ndaj të drejtave të maces apo të qenit, që ke gjetur tek dera jote? A je sjellë me mëshirë ndaj krijesave duke kujtuar faktin se një person meritoi ndëshkimin hyjnor për shkak se e la macen të ngordhte nga uria, kurse një tjetër gëzoi faljen hyjnore për shkak se i dha ujë një qeni të etur për vdekje?

- A ke mundur ta shohësh sot familjen tënde me syrin e zemrës, si kopshtin tënd të Xhenetit, duke u përpjekur ta mbrosh atë nga ndikimet negative të rrugës, tregjeve, modës, reklamave, televizionit dhe internetit? Sa ke arritur ta zbatosh Urdhrin Hyjnor:

"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!.." (Tahrim, 6.)

- Nëse je zonjë shtëpie, a e ke përcjellë burrin tënd me fytyrë të qeshur e dashuri, duke u lutur që të sjellë furnizim hallall në shtëpi? Po ashtu, a e ke pritur me fjalë të ëmbla në mbrëmje, duke u përpjekur t'i largosh lodhjen dhe të bëheni një familje e pastër e shembullore?

- Nëse je zot shtëpie, me sa butësi dhe mëshirë je sjellë ndaj gruas dhe fëmijëve të tu? A e ke menduar se trashëgimia më e madhe që mund t'u lësh atyre është ajo e botës tjetër dhe, a je përpjekur aq sa duhet për zhvillimin e tyre fetar, moral e shpirtëror?

- Çfarë u mësove sot nga edukata fëmijëve të tu që Allahu i Madhëruar t'i ka lënë amanet? A ke mundur të fusësh në zemrat e tyre dashurinë për të Dërguarin e Allahut, (a.s.), profetët e tjerë dhe robërit e mirë të Allahut?

- Fëmijët e tu, janë ata që nesër do të të përfaqësojnë dhe do të jenë një pjesë e vazhdimësisë tënde! Për rrjedhojë, çfarë ke bërë ti sot që ata të fitojnë personalitetin Islam?

- Çfarë virtytesh ke mbjellë sot në kopshtin e zemrave të fëmijëve të tu, që ata të jenë drita e syve të tu dhe krenaria jote në ditën e Kiametit?

- A ke mundur t'i vetëdijësosh fëmijët e tu se feja, besimi, atdheu dhe të gjitha gjërat e shenjta janë amanete që duhen mbrojtur? A ia ke kujtuar fëmijëve të tu dëshmorët që kanë rënë në mbrojtje të atdheut? A i ke mësuar ata se Kurani që është mirësia më e madhe e Allahut, ezani që jehon në qiejt tanë dhe flamuri ynë që valëvitet i lirë në këtë vend, janë nderi dhe krenaria jonë më e madhe?

- Ti shpenzon kohë dhe pasuri për një periudhë të gjatë në arsimimin e fëmijëve të tu në këtë botë. Po për arsimin në lidhje me Ahiretin e tyre çfarë ke bërë? Apo mos vallë i ke konsideruar të mjaftueshme disa ditë mësimi fetar në kurset e verës, për një arsimim që ka të bëjë me botën tjetër?

- A ke mundur që sot, atyre që kanë nevojë për udhëzim t'u afrohesh me gjuhë të ëmbël dhe me një zemër që shpërndan mëshirë? A i ke urdhëruar ata për të mirë dhe i ke ndaluar nga e keqja? A je lutur për udhëzimin e tyre? A ke mundur të bëhesh shembull "i një personaliteti mysliman" për ta?

- Duke filluar prej familjes, a ke marrë masa mbrojtjeje për njerëzit që ke nën përgjegjësi, kundër të këqijave dhe problemeve të kohës, ndërkohë që sot breza të tërë po humbasin si trungjet në përrenj?

- A ke mundur ta marrësh përdore një fëmijë apo një të ri, e të shkoni bashkë ne xhami? A je përpjekur të mbledhësh rreth vetes disa të rinj për t'i qerasur materialisht e shpirtërisht, duke ua bërë të dashur të vërtetën? Çfarë dhurate i ke dhënë një personi të cilin e do për hir të Allahut?

- Me kë dhe sa prej të mirave që të ka dhuruar Allahu i Madhëruar i ke ndarë sot? A ke mundur të bëhesh bamirës sot?

- A e ke përjetuar sot kënaqësinë shpirtërore që të jep gëzimi i një besimtari?

- A e ke përkëdhelur sot kokën e një jetimi? A e ke vizituar ndonjë të sëmurë? A e ke përcjellë ndonjë xhenaze?

- A je interesuar sot për fqinjët dhe nevojtarët përreth teje? A ta ka drithëruar zemrën një fqinj që ka mbetur i uritur apo ndonjë i pastrehë që dridhet në të ftohtë?

- A të kanë hidhëruar sot hallet e myslimanëve që vuajnë qoftë edhe në anën tjetër të botës?

- A ke bërë ndonjë përpjekje sot për ngopjen e të uriturve, shërimin e të sëmurëve dhe për lehtësimin e atyre që janë të shtypur nën barrën e borxheve? A je lutur për këtë çështje me fjalë, me zemër, dhe ç'është më e rëndësishme, me vepra?

- A ke përshëndetur sot me selam të gjithë njerëzit që i njeh dhe nuk i njeh? A i ke pritur njerëzit me fytyrë të qeshur duke e ditur se buzëqeshja është sadaka?

- A je sjellë me mirësi dhe a e ke falur sot ndonjë që të ka bërë keq ose është sjell keq me ty?

- A ke fituar sot ndonjë mik dhe me sa miq e ke freskuar miqësinë?

- A je përpjekur sot të qëndrosh me ndonjë njeri të mirë? A ke bërë miqësi me ndonjë besimtar të sinqertë që do t'i thotë të vërtetat për hir të Allahut edhe pse nuk do t'i pëlqenin egos tënde? A ke bartur ndopak shqetësim në zemrën tënde për t'u ruajtur nga qëndrimi me gjynahqarët dhe njerëzit e këqij?

- A ke hequr sot nga rruga ndonjë pengesë që i bezdis kalimtarët?

- A je marrë sot me ndonjë shërbim apo veprimtari që të ka shtuar diturinë dhe të ka zhvilluar kulturën?

- A ke mundur që sot, nëpërmjet bisedave fetare që janë si farmaci zemre, të marrësh prej ilaçeve shpirtërore që të shërojnë zemrën e shpirtin dhe të shtojnë frymëzimin?

- Sa faqe ke lexuar sot prej Kuranit Fisnik, i cili është mrekullia më e madhe që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit? A ke mundur të punosh siç duhet me të duke medituar mbi mesazhet që jep ai? A je prej atyre që ia kanë mësuar të tjerëve Kuranin, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ndihmuar atë për t'u bërë prej robërve më të mirë?

- A ke treguar vullnet të fortë për t'iu vënë kundër zakoneve të këqija që përpiqen të hyjnë në jetën tënde?

- A e ke ruajtur gjuhën tënde sot nga fjalët e kota e të padobishme, nga gënjeshtrat dhe thashethemet, nga përgojimet dhe debatet dhe nga shpimi i ndonjë zemre me fjalë helmuese?

- Si e ke mbyllur ditarin e jetës sot? Çfarë janë shkruar në librin tënd të punëve në lidhje me ditën e sotme? A do të mund të japësh llogari në ditën e gjykimit për faqen e kësaj dite?

- Shkurtimisht, a e ke menduar se sot je duke u regjistruar nga kamerat hyjnore në çdo lëvizje dhe çdo veprim tëndin për të mbushur kasetën e jetës tënde? A e ke bërë llogarinë e 24 orëve të fundit që ke kaluar dhe a e ke kontrolluar veten?..

Besimtarët që përpiqen të bëjnë një vetëllogaritje të tillë duke u përgatitur për vdekjen, në vend që ta kenë frikë, e konceptojnë atë si një mundësi për takimin e përjetshëm. Në këtë mënyrë, vdekja, e cila është si një portë midis dy botëve, fillon dhe bëhet e bukur.

Ja pra, besimtarët që përpiqen të bëjnë një vetëllogaritje të tillë duke u përgatitur për vdekjen, në vend që ta kenë frikë, e konceptojnë atë si një mundësi për takimin e përjetshëm. Në këtë mënyrë, vdekja, e cila është si një portë midis dy botëve, fillon dhe bëhet e bukur.

Nisur nga kjo, mund të thuhet se zgjidhja e vetme për të shpëtuar nga drithërimat e ftohta të vdekjes, është të përpjekja për të bërë një jetë të devotshme, duke u thelluar në meditimin e shprehjes: *"Vdisni, para se t'ju vijë vdekja!"*. Kjo, sepse:

VDEKJA E SECILIT DO TË KETË NGJYRËN E TIJ

Vdekja do ta arrijë patjetër çdo gjallesë, por veçanërisht për njeriun ajo do të jetë një kiamet personal. Ashtu siç nuk do të ketë frikë dhe hidhërim në ditën e Kiametit për ata që i besojnë Allahut dhe jetojnë në rrugë të drejtë, edhe në çastin e vdekjes, që është një kiamet i veçantë për çdo person, do të përjetohet e njëjta gjendje. Për rrjedhojë, vdekja do të manifestohet sipas gjendjes shpirtërore të gjithsecilit.

Mevlana është shprehur bukur kur ka thënë:

"Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e tij. Atyre që e urrejnë vdekjen dhe janë armiq të saj, sepse nuk mendojnë se vdekja është takim me Allahun, ajo ka për t'iu dukur një armik i frikshëm. Ndërsa atyre që janë miqësuar me të, iu shfaqet si mik.

"O shpirt që frikësohesh dhe ikën nga vdekja! Nëse dëshiron të dish se si është puna dhe cila është e vërteta, dije se në të vërtetë ti nuk ke frikë nga vdekja, ti ke frikë nga vetja."

"Ajo që sheh në pasqyrën e vdekjes dhe frikësohesh, nuk është çehrja e vdekjes, por fytyra e shëmtuar e botës tënde të brendshme. Shpirti yt i ngjan një peme. Ndërsa vdekja është gjethja e asaj peme. Dhe çdo gjethe është sipas llojit të pemës..."

"Dita e Kiametit është një "Bajrami i Kurbanit" i frikshëm për qetë laramane, pra për mohuesit dhe gjynahqarët me mendime të këqija. Ajo ditë është vdekje për qetë dhe Bajram për besimtarët."

Në ditën e Bajramit të Kurbanit, besimtarët festojnë ndërsa kafshët bëhen kurban. Në paralelizëm me këtë, edhe njeriu në ditën e Kiametit do të vendoset në njërin nga këto dy role, në bazë të zgjedhjeve dhe prirjeve të tyre në këtë botë: Ose do të jetë prej atyre që do festojnë, ose prej atyre që do të meritojnë dënimin...

Nisur nga këto të vërteta, nëse një njeri jeton duke e robëruar veten sikur kjo botë të ishte zoti i tij, varri do ta presë si një burg i errët dhe i mbushur plotë me ndodhi e sende të frikshme. Ndërsa tmerri i vdekjes e bën këtë njeri të vuajë aq shumë, sa nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër. Mirëpo, nëse njeriu i respekton parimet Islame, duke i kapërcyer dëshirat e ulëta të egos dhe përparon në drejtim të virtyteve të larta që gjenden në shpirtin e tij, atëherë vdekja shihet si një kusht i detyrueshëm i takimit me Zotin, i Cili është i Lartë dhe Madhështor përtej çdo imagjinate. Vetëm në këtë mënyrë, vdekja, e cila shkakton drithërima të ftohta tek shumica e njerëzve, kthehet në entuziazmin e takimit me "Mikun më të Lartë".

I nderuari Mevlana, vdekjen e vet e ka konsideruar si "Sheb-i Arus / Natë dasme", pra si shpëtim prej kurbetit në këtë botë dhe rrugëtim drejt takimit me të Dashurin e tij:

"Ditën kur të vdes e trupi im të bartet, mos kujto se shqetësohem për këtë botë! Mos pandeh se jam hidhëruar prej ndarjes nga kjo botë! Mos guxo të qash pse kam vdekur; mos thuaj as: «vaj medet, e mjerë ai!». Nëse unë kam rënë në kurthet e shejtanit sa kam qenë gjallë, atëherë mund të qash!

Dhe kur të më lëshojnë në tokë, mos thuaj: «Lamtumirë, lamtumirë»! Dije se ajo nuk është koha e ndarje sime, por e takimit (me Zotin tim)!

Varri është një perde, pas së cilës gjendet paqja e Xhenetit! Perëndimin e ke parë, apo jo? Shikoje edhe lindjen! A i humbet gjë Diellit dhe Hënës kur zhduken në horizont?

Edhe pse kjo gjendje të duket si perëndim apo zhdukje, në fakt kjo është një lindje, takim i ri me jetën!

Nëse fara bie në tokë, a mund të thuhet se ajo «vdiq»?..

Dije se vdekja është dhimbja e lindjes së shpirtit në një botë tjetër. Në lidhje me këtë botë të përkohshme, emri i saj është «vdekje», por në raport me botën tjetër të përjetshme emri i saj është «lindje»!..

A nuk është Allahu Ai që e merr shpirtin?.. Pra, dije se vdekja për robërit e mirë është e ëmbël si sheqer. Edhe nëse vdekja është zjarr, për atë që është mik/halil i Allahut, ajo është kopësht Xheneti, ujë i jetës..."

Shkurtimisht, vdekja nuk është asgjësim, por lindje në jetën e përjetshme. Ashtu siç është lindje ardhja në këtë botë për një bebe, ashtu edhe dalja e shpirtit nga trupi dhe hyrja në botën e varrit është lindje në një botë tjetër. E më pas, ai do të lindë në botën e përjetshme.

TA JAPËSH SHPIRTIN SI MYSLIMAN

Allahu i Madhëruar, na ka paralajmëruar shumë herë se si duhet të jenë veprimet dhe sjelljet tona me qëllim që jeta jonë të mos përfundojë në mënyrë të hidhur. E mbase një prej më të rëndësishmëve prej tyre, është edhe ky:

"O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!" (Al-i Imran, 102.)

Ne jemi sjellë nga mosekzistenca në ekzistencë, pa paguar asnjë çmim, pra falas. Po ashtu, ne u nderuam mes të gjitha krijesave duke u krijuar si "qenie njerëzore", dhe si myslimanë ndër të gjithë njerëzit. Allahu i Madhëruar na ka pajisur me cilësi të veçanta me të cilat mund të arrijmë njohjen dhe dashurinë e Tij. Ai na ka krijuar si, *"ahsen-i takuim / krijimin më të mirë"*. Na ka dhuruar mirësi të mëdha duke na dërguar libra dhe profetë. Po ashtu, Ai ka shfaqur manifestimet e mistereve dhe urtësive hyjnore për sytë që shohin në Librin e gjithësisë, që është edhe dëshmitari i fuqisë dhe madhështisë së pakufishme të ekzistencës dhe njëshmërisë së Tij. Të gjitha këto janë mirësi dhe bukuri madhështore për të cilat nuk jemi mjaftueshëm të aftë të falënderojmë...

Përveç këtyre, Allahu i Madhëruar ka përgatitur edhe lumturinë e përjetshme për ne, pra Xhenetin e Tij. E për Xhenetin ekziston një çmim që duhet paguar. Domethënë, edhe pse në këtë botë kemi ardhur pa paguar asnjë çmim, ne jemi të detyruar të shkojmë në botën tjetër duke paguar njëfarë çmimi. E në fakt nuk e kemi aspak të garantuar se mund të shkojmë si myslimanë në botën tjetër. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë «Ne besojmë», pa u vënë në provë?!" (Ankebut, 2.)

Kjo do të thotë që e gjithë jeta jonë është sprova e dorëzimit të shpirtit amanet, tek i zoti, në mënyrë të kënaqshme, pa lëshuar pe nga besimi ynë dhe pavarësisht çdo ndodhie.

Me shprehjen, ***"Vdisni vetëm duke qenë myslimanë!"***, Allahu i Madhëruar duket sikur na paralajmëron: *"Mos guxoni të vdisni pa e shpëtuar edhe besimin tuaj!"*, duke na tërhequr vëmendjen se ky është rreziku më i madh për robin në këtë botë. Pra, Ai na bën të ditur se vdekja ndodh vetëm një herë dhe se fryma e fundit që jepet duke qenë larg besimit është një katastrofë e përjetshme e pakompensueshme.

Në Kuranin Fisnik, Zoti ynë na sjell shembull heronjtë, si magjistarët e Faraonit dhe As'hab-i Uhdud, të cilët sakrifikuan jetën, pasuritë dhe gjithçka që kishin, për të shpëtuar besimin e tyre. Po ashtu Ai na njofton edhe për fundin e fatkeqëve si Bel'am bin Baura dhe Karuni, të cilët pavarësisht jetës shumë të devotshme, u larguan nga rruga e drejtë dhe pësuan dështimin e përjetshëm.

Shqetësimi për dhënien e frymës së fundit me besim është domosdoshmëri dhe tregues i besimit të vërtetë, sepse përveç profetëve dhe atyre të cilët janë përgëzuar me Xhenet prej profetëve, askush tjetër nuk e ka të garantuar se do të jetë prej të shpëtuarve në botën tjetër. Madje edhe sahabët, të cilët janë përgëzuar me Xhenet që në këtë botë, kanë jetuar vazhdimisht me shqetësimin për frymën e fundit dhe gjendjen e tyre në botën tjetër, nga frika se mos nuk e ruanin dot gradën e tyre të besimit.

Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë kjo ndodhi:

Njëherë, dy persona shkuan tek sahabi Selman Farisiu (r.a.) dhe pasi e përshëndetën me selam, e pyetën:

"A je prej sahabëve të Profetit (a.s.)?"

"Nuk e di!" – u përgjigj ai.

"Mos vallë kemi ardhur gabim?" – thanë ata duke ngurruar.

Mirëpo, edhe pse ishte përgëzuar nga vetë Profeti (a.s.), me fjalët: *"Selmani është prej nesh, prej Ehl-i Bejtit"*[1] dhe gëzonte virtyte të larta, ky sahab i bekuar nuk i quante asnjëherë të mjaftueshme përpjekjet e tij fetare dhe, me zemrën që i dridhej midis ndjenjave të "frikës" dhe "shpresës", ai u shpreh me këto fjalë:

"Po, unë e kam parë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe jam gjendur në tubimet e tij. Por sahabi i vërtet i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është ai që arrin të hyjë së bashku me të në Xhenet." (Hejthemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549.)

Ja pra, kjo është ndjesia e zemrës së një sahabi të zgjedhur prej sahabëve të nderuar, të cilët janë brezi më shembullor për të gjithë ummetin Islam deri në ditën e Kiametit...

Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se ne ecim në një terren të rrëshqitshëm deri në frymën e fundit. Ashtu personi që detyrohet të bëjë kujdes në çdo hap që hedh, kur kalon në një zonë të minuar, ashtu edhe besimtari duhet të bëjë kujdes me devotshmëri të lartë ndaj gjendjeve dhe sjelljeve që ka ndaluar Allahu në rrugëtimin e kësaj jete të përkohshme, me qëllim që të mos devijojë nga rruga e drejtë.

Gjithashtu, Zoti ynë i Madhëruar na tregon rrugën e drejtë, me qëllim që këmbët të mos na rrëshqasin dhe të ecim me hapa të sigurt në këtë rrugë:

"O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja." (Muhammed, 7.)

Kjo do të thotë se në asnjë fazë të jetës sonë nuk duhet ta hedhim Islamin në plan të dytë. Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë Zotin tonë as në shtëpi, as në punë, as në rrugë, as në treg, e as në shkollë dhe duhet t'i respektojmë urdhrat e Tij në çfarëdolloj situate. Përpjekja më e madhe në jetën tonë duhet të jetë dhënia shpirt vetëm si myslimanë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Nëse dikush dëshiron të shpëtojë prej Xhehenemit dhe të hyjë në Xhenet, duhet të vdesë me besim tek Allahu dhe Dita e gjykimit." (Muslim, Imare, 46; Nesai, Bej'at, 25; Ibn-i Maxhe, Fiten, 9.)

E gjithë çështja është që këtë jetë të përkohshme ta jetojmë në kuadrin e këtyre të vërtetave hyjnore dhe profetike.

1. Hakim, III, 691/6541; Hejthemi, VI, 130; Ibn-i Hisham, III, 241; Ibn-i Sa'd, IV, 83.



EL-HAKEM

GJYKATËSI I GJYKATËSVE

Ilir Hoxha

"el-Hakem", është Ai që zotëron autoritetin e gjykimit dhe të drejtën e fjalës së fundit. Ky emër hyjnor përfshin të gjitha ligjet që Zoti ynë ka vendosur në natyrën e krijesave që prej krijimit të tyre, ligjet që përmbajnë librat të cilat Ai i ka zbritur njerëzimit që prej njeriut të parë dhe gjykimet përfundimtare që do të jepen në botën tjetër në lidhje me gjithçka që ka ndodhur në këtë botë.

Zoti ynë i Madhëruar njeh plotësisht fillimin dhe fundin e gjithçkaje, sepse Ai e ka dizajnuar dhe krijuar gjithçka që ndodh në gjithësi. Ai e ka krijuar gjithësinë në atë mënyrë, që gjithçka të jetë e lidhur me njëra-tjetrën dhe gjithçka të realizojë më së miri funksionin për të cilin është krijuar. Për rrjedhojë, Krijuesi ynë i Madhëruar ka edhe autoritetin absolut për të gjykuar dhe zbatuar këto gjykime për gjithçka që ka krijuar me Dijen, Urtësinë, Drejtësinë dhe Fuqinë e Tij. (shih. Kasas. 70.)

Mirëpo, brenda këtij sistemi të pashoq, Allahu i Madhëruar ka krijuar edhe qenie që zotërojnë vullnet dhe të drejtë vendimmarrjeje, siç është njeriu. Por, megjithëse përgjegjësia e vendimeve që merr dhe e hapave që hedh i takon plotësisht njeriut, Allahu i Madhëruar e ka paralajmëruar atë që më herët lidhur me gjykimin dhe përfundimin që kanë tek Ai këto vendime dhe veprime të tij. (shih. En'am, 114.)

Allahu është Ai që do t'u japë zgjidhje përfundimtare të gjitha çështjeve, atëherë kur në këtë botë gjithçka të përzihet, e të mos dallohet e drejta nga e shtrembëta, sepse askush përveç Tij nuk e di çdo gjë me shkaqet dhe rezultatet e veta, duke njohur edhe çdo alternativë të mundshme të ngjarjeve. Për këtë arsye, edhe gjykimi përfundimtar i mbështetur në drejtësi absolute, do të jepet nga Allahu i Madhëruar në botën tjetër. (shih. Zumer, 46.)

Disave mund të mos u vijë mirë që gjykimi përfundimtar të ngelet për në botën tjetër, sepse atyre mund t'u duket e padrejtë të presin aq gjatë për të marrë verdiktin përfundimtar të ngjarjeve. Mirëpo, ashtu siç na mëson edhe feja jonë, jeta fillon me lindjen dhe vazhdon deri në pafundësi. Vdekja është vetëm kalim në një dimension tjetër. Por, kjo nuk do të thotë se vendimi ka mbetur jashtë jetës, atëherë kur çdo gjë ka përfunduar. Përkundrazi, ky është një vendim shumë efikas i cili jepet në pikën kur ka mbaruar jeta e kësaj bote, e cila është thjesht si një hyrje e librit të jetës, dhe fillon jeta e vërtetë. Përveç kësaj, për sa kohë që vazhdojmë jetën e kësaj bote, vazhdojnë edhe përgjegjësitë dhe veprat tona, gjë e cila i shton çdo ndodhie një dimension të ri për çdo moment që kalohet.

Njeriu që e beson Allahun në kuptimin e vërtetë të fjalës, nuk ndjen asnjë lloj dyshimi dhe shqetësimi lidhur me autoritetin e Tij për të dhënë gjykimin e fundit. Çështja që duhet të ketë më tepër kujdes një besimtar, është të jetë i kënaqur me gjykimin e Tij. Ai që nuk arrin t'i pranojë gjykimet e Allahut, ndjehet i pakënaqur prej parimeve dhe rregullave të Tij dhe rebelohet kur Allahu vendos ndryshe nga ajo që shpreson, duhet t'i kthehet vetes e ta pyesë se, ku e gjen guximin dhe autorizimin të përzihet në vendimet e Krijuesit të tij! Kështu, ata që ndjehen të pakënaqur prej autoritetit gjykues dhe vendimeve të marra prej Allahut, duhet ta analizojnë rolin "hyjnor" që i kanë ngarkuar vetes dhe të pyesin veten se ku e mbështesin drejtësinë e gjykimeve dhe kërkesave të tyre!



Ata që studiojnë natyrën e njeriut në lidhje me arritjen e lumturisë dhe paqes në këtë jetë, thonë se sekreti i gjithë kësaj, qëndron në faktin e të qenit në paqe me veten dhe jetën, pra, të jesh i kënaqur me çdo gjë që zotëron. Njeriu përpiqet dhe i lutet Allahut për të arritur ato me të cilat lumturohet. Nëse ai ndjehet i kënaqur dhe i mjaftojnë ato kur i arrin, atëherë ai do të shijojë lumturinë dhe paqen më të madhe. Dhe kjo, ka të bëjë drejtpërsëdrejti me besimin në gjykimin e Allahut dhe respektimin e vendimeve të Tij, sepse Allahu është "Hakem" dhe një hakem/gjykatës i vërtetë, nuk mban anë, nuk bën padrejtësi, nuk favorizon dhe nuk dëmton askënd. Për rrjedhojë, gjykimi i Hakem-it është në favor të të gjithëve. ***"...Vendimi i takon vetëm Allahut. Ai e shpall të vërtetën dhe Ai është Gjykatësi më i mirë!"*** (En'am, 57.)

Manifestimi i emrit hyjnor "el-Hakem" në jetën e kësaj bote, shihet në gjykimin e çështjeve të njerëzve me anë të librave që Allahu i Madhëruar i ka zbritur atyre. ***"Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin..."*** (Bekare, 213.)

Fjala arabe *"hukm"*, në Kur'an përdoret në forma të ndryshme, në 210 vende. 37 prej këtyre i atribuohen Allahut në formën e foljes dhe emrit. Në tre ajete termat *"hukm"* dhe *"hakem"*, i atribuohen Allahut duke u kombinuar si, *"hajru'l-hakimin"* (më i miri i gjykatësve) dhe në dy ajete si, *"ahkemu'l-hakimin"* (Gjykatësi i gjykatësve).

Në Kur'anin Fisnik bëhet fjalë edhe për faktin se njeriu ka të drejtë të luajë rolin e gjykatësit sipas mundësive që zotëron (shih. Nisa, 35.). Por, në të njëjtën kohë, bëhet fjalë edhe për rregullat dhe parimet që duhet të respektojë ai kur të gjykojë ndër njerëzit e tjerë (shih. Nisa, 58; Maide, 8.). Të gjitha këto, tregojnë se ne njerëzit jemi të autorizuar të gjykojmë vetëm brenda kufijve dhe rregullave të vendosura prej Allahut të Madhëruar. Për rrjedhojë, personi që ngarkohet me detyrën e gjykimit midis njerëzve, nuk duhet të harrojë për asnjë çast "Gjykatësin e gjykatësve", i Cili e vëzhgon atë pandërprerë.

Fakti që rrënja e fjalës *"Hakem"* (h-k-m) në fjalor ka kuptimin, *"të ndalosh, të korrigjosh me qëllim përmirësimi"*, është shumë domethënës. Kjo tregon qartë se Allahu i Madhëruar, me anë të vendimeve të Tij ndalon padrejtësinë, dhunën dhe gabimet, duke vendosur drejtësi në çështjet e njerëzve.

Aty ku ekzistojnë njerëzit, janë të paevitueshme edhe mosmarrëveshjet, përplasjet dhe mendimet e kundërta. Edhe pse rivaliteti në një nivel të pranueshëm i shërben përparimit shoqëror, kur ai arrin nivele të cilat e destabilizojnë paqen dhe qetësinë, duhet patjetër të funksionojë një mekanizëm ndërhyrës. Pikërisht në këtë situatë, një besimtar i mirë e pranon gjykimin e një gjykatësi i cili respekton ligjet dhe kufijtë e caktuara nga Allahu i madhëruar, edhe nëse gjykimi është kundër tij.

Dijetarët thonë se kur emri "Hakem" manifestohet tek dikush, ai njeri e vendos të drejtën mbi çdo gjë, madje edhe mbi veten e tij. Ai zotëron një intuitë të fortë për të zbuluar të vërtetën dhe për të vendosur të drejtën. Mendimet e tij janë të sakta dhe gjykimet e tij përputhen plotësisht me ato të Allahut. Ai ka aftësi të veçanta për të vendosur të drejtën mes njerëzve, gjykon me drejtësi dhe e drejta trupëzohet në sajë të tij.

Urtësitë nga jeta e Jusufit a.s.

Ma. Behrim Jusufi

'Në Jusufin dhe vëllezërit e tij, gjenden mësimet për të gjithë që gjurmojnë (pyesin).' (12:7)

Prej ajkës kuranore janë nxjerrë mësime e urtësi të panumërta, por megjithatë, duke pasur parasysh se Kurani është det i pashtershëm, gjithmonë mund të thellohen dhe nxirren mësime plotësuese mbi ato që tanimë janë të njohura. Janë urtësi të shumta që mund të nxirren nga jeta e Jusufit a.s. por në vazhdim do të veçohen: *mbështetja në Zotin; mos shpërfillja vëllazërore; unikja përballë sfidave; kodi moral dhe kujdesi ndaj ndershmërisë.*

MBËSHTETJA NË ZOTIN

Pa dyshim se parimi esencial mbi të cilin sendërtohet besimi islam është mbështetja në Zotin. *Me mbështetje në Zot nënkuptohet që e gjithë çështja t'i besohet Mëshiruesit, tërë qenia njerëzore të jetë e nënshtruar vullnetit të Tij, dhe se të kihet bindje se çfarëdo që i ndodh njeriut, e mirë apo e keqe në sytë e tij nuk mund t'i ndodhë pa caktimin e Tij.* Me një fjalë, që në mënyrë paralele edhe ana fizike edhe ajo shpirtërore të jenë njëkohësisht në pajtueshmëri të plotë, në besim, nënshtrim dhe bindje ndaj Krijuesit Fuqiplotë.



Nga jeta e Jusufit a.s. hasim në urtësi të dyfishtë në këtë pikë. Fillimisht e gjejmë Jusufin a.s. si një rob të sinqertë, dhe që gjithmonë mbështetet tek i Lartësuari, por, kemi një rast kur këtë rregull paksa nuk e 'përfilli', dhe kjo padyshim se ishte urtësia Hyjnore, në rastin kur ai u mbështet fillimisht në të burgosurin, të cilit i tha përkujtomë tek mbreti, kështu i Gjithëdijshmi bëri që ta harrojë ky i burgosur, për dhjetë vite të plota, dhe kjo vetëm e vetëm pse në çast e 'harroji' Zotin dhe nuk tha: '*më përmend me lejen e Zotit tek mbreti.*'

MOS SHPËRFILLJA VËLLAZËRORE

Jeta e të dërguarit Jusuf a.s. bart plotë urtësi se si duhen të jenë raportet vëllazërore. Atë e gjejmë shumë bujar dhe të mëshirshëm ndaj vëllezërve të vetë, përkundër asaj se atë deshën ta vrisnin vetëm e vetëm se dëgjuan për ëndrrën të cilën ai ia tregoji babait të vetë, dhe për dashurinë që Jakubi a.s., tregonte ndaj të birit të tij Jusufit a.s.

Kështu, përkundër asaj që vëllezërit ia bënë Jusufit a.s. nga zilia, ai sigurisht nuk ua ktheu në të njëjtën mënyrë sikurse vepruan ata ndaj tij. Por, ai u tregua shumë bujar, i mëshirshëm dhe u doli në ndihmë në çastin kur ata më së shumti patën nevojë. Nga ky gjest mund të nxirret urtësia *se përkundër asaj se çfarë vepron dikush ndaj tjetrit vendimi i Zotit do të çohet në vend,* sepse përkundër zilisë vëllazërore e lajkave, për ta përbuzur Jusufin a.s. është Krijuesi Ai që, kë do e ngit lartë dhe kë do e poshtëron.

Jusufi a.s. prapëseprapë u bë ministër i financave në Misir, edhe përkundër zilisë që kishin ndaj tij, përsëri erdhi koha kur do të vërtetohej ëndrra e kamotshme e tij, por edhe vëllezërit e tij të bëhen nevojtar për të. Prandaj, këtu ka edhe një urtësi se nuk duhet shpërfillur vëllazërinë, sepse përsëri një ditë dëshira e Zotit do t' na dërgojë që të bëhemi nevojtarë për ta, dhe se i huaji nuk mund të ndjejë kurrë më shumë dhembshuri për dikë se ai që e ka nga po i njëjti bark. Jusufi a.s. u tregua i mëshirshëm, i fali u ndihmoi dhe përsëri i pranoi në gjirin e vetë në Misir, që t'i ketë pranë.

UNIKJA PËRBALLË SFIDAVE

Nga jeta e bujshme e këtij pejgamberi, shohim se si njeriu duhet të jetë unik përballë sfidave jetësore, edhe atëherë kur ai është në vështirësi edhe atëherë kur është në mirësi, lehtësi e begati. Këtu Jusufin a.s. e gjejmë si njeriun universal, të gjithanshëm por edhe unik ndaj çdo situate jetësore.

Universal e gjejmë në të gjitha raste, sepse përkundër asaj se ishte i dërguar ai punon si shërbëtor, si rob i cili punon të gjitha punët gjatë viteve të burgut. Jeta e tij në burg ishte mësim për të burgosurit se si duhen të sillen, se si duhet të mbajnë qetësi e higjenë në hapësirat ku qëndronin të burgosur, dhe të gjitha këto ai u tregoji përmes veprës dhe jo vetëm fjalës, sepse ai bëri që burgu të dukej ndryshe, që të ketë rend, pastërti, kuptim dhe dashuri vëllazërore mes të burgosurve.

Unik e gjejmë si të lirë si të burgosur, si fisnik si varfanjak. Në pozitë si ministër apo i burgosur në burg ai vepron njëjtë, kujdeset për të varfërit, e ndihmon nevojtarin, dhe për më tepër nuk ngopet shumë dhe agjëron, edhe atëherë kur ai pati kohën e lulëzimit të tij, respektit më të madh, në periudhën e begatisë së tij jetësore kur mund të zgjidhte ushqimet e llojllojshme. Por një gjë të tillë, e bënte nga dhimbja ndaj nevojtarëve dhe atyre që nuk kishin, dëshironte të '*shijonte si është gjendja e atij që nuk ka për ta ngopur barkun, në çastet kur ai ka me bollëk zgjidhje.*'

KODI MORAL DHE KUJDESI NDAJ NDERSHMËRISË

Në Jusufin a.s. gjejmë shembullin më të mirë për moral, dhe mënyrën se si njeriu duhet t'i qaset në jetë tematikës së intimitetit, dhe asaj se si duhet të kujdeset edhe për nderin e tjetrit. Nga kjo pikë mund të nxjerrim urtësi, se njeriu përkundër lakmisë ndaj gjinisë së kundërt, ai doemos duhet të kujdeset për moralin dhe parimet e ndershmërisë, sepse shtylla esenciale e një shoqërie njerëzore, e veçanërisht asaj islame është morali i mirë.

Zaten kjo fe është e sendërtuar mbi parimet e moralit, sjelljes, etikës, respektimit ndaj tjetrit dhe konsideratës se po qese u bën keq fqinjit, ti veç se i bëre dëm vetes. Aq larg islami i çmon parimet etike e morale saqë në fjalët kuranore hasim: '*Ty me të vërtet o, Muhamed (a.s.), të dërguam që t'ua përsosësh moralin atyre.*'

Pastaj, sa i përket asaj se nuk duhet cenuar sovranitetin e gjithanshëm individual të tjetrit dhe atë moral, hasim në thëniet autentike profetike qortime për ata prej të cilëve nuk janë të qetë dhe rahat të tjerët: '*Nuk është besimtar i mirë ai që prej dorës dhe gjuhës së tij, nuk janë të qetë besimtarë tjerë.*'



Hutbe
të zgjedhura

Besa e myslimanit

Ferit Piku

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: "…**dhe mbajeni besën e Zotit, kur ia jepni Atij, e mos e thyeni premtimin tuaj, pasi keni bërë ndërmjetës Allahun (xh.xh)".** (Nahl: 91).

Flitet gjithmonë për moralet dhe sjelljet e muslimanit e ata janë shumë. Ata nuk mund të përmenden në hytbe, ata nuk mund t'i përfshijnë librat. Gjithë jeta jonë është sjellje e moral.

Po mundohemi të flasim për ato morale, që sot po dobësohen e po veniten, por të paktën të përpiqemi që këto morale t`i ruajmë në zemrat e besimtarëve, sepse janë moralet e besimit. Përderisa ka besim në zemrën e besimtarit, duhet të ekzistojnë edhe ato morale.

Morali për të cilin do të flasim këtu, është **mbajtja e besës**. Flasim për këtë moral, sepse sot shumë pak njerëz e mbajnë besën.

Sot njerëzit e drejtë dhe të sinqertë po befasohen nga mosmbajtja e besës. Prindërit që martojnë vajzat e tyre, befasohen kur dëgjojnë pas një farë kohe, se vajza e tyre është në rrugët e Italisë, se burri që i dha asaj vajze nuk e mbajti besën, por e tradhëtoi.

Po dëgjojmë deputetin, që i jep besën elektoratit të tij e sapo hipën në pushtet, e harron besën e dhënë. Po dëgjojmë presidentë, që vënë dorën mbi kushtetutë e betohen për mbajtjen e besës, por edhe ata e harrojnë besën e tyre.

Po dëgjojmë për mosmbajtjen e besës edhe në mes shokëve. Kjo pra është kriza e mbajtjes së besës, por me sa duket jetojmë në atë kohë kur thonë: "Po të mbash besën, nuk mund të jetosh". Është ajo kohë kur njerëzit thonë: "Duhet të jesh i shkathët, duhet të dish edhe të mashtrosh, nëse të vjen situata në dorë".

Besimtari nuk është i tillë, sepse ai beson në ahiret, beson tek Allahu (xh.sh). Besimtari nuk është i tillë, sepse profeti Muhammed (a.s) thotë: "**Nuk ka fe, nuk ka besim ai njeri që nuk ka besë**"[1].

Ai njeri që nuk mban besën, le ta dijë se nuk ka besim. Besa është mes teje dhe Allahut (xh.xh), prandaj kur të mendosh ta thyesh atë, dije se sipër kokës tënde ke Allahun (xh.xh), të Cilit i ke dhënë besën.

Njerëzit e ngushtojnë shumë konceptin e besës, por në fakt ajo ka kuptim shumë të gjerë. Besa është në radhë të parë lidhje me Allahun (xh.xh), me Zotin e gjithësisë, me Krijuesin tënd. Të gjithë ne i kemi dhënë besën Allahut (xh.xh) para se të vijmë në këtë jetë. Kur Zoti i gjithësisë i krijoi shpirtrat në botën e shpirtrave, u tha: "**A nuk jam unë Zoti juaj?**"? Ata i thanë: "**Posi o Zot, ti je Zoti ynë**". Atëherë Allahu (xh.xh) tha: "**Kujdes! Mos e thyeni besën tuaj kur të shkoni në dynja, mos e harroni këtë zotim**". (A`raf: 172). Ne duhet ta mbajmë këtë besë, që i kemi dhënë Allahut (xh.xh). Cilësia e parë e besimtarit musliman, është që e mban besën me Zotin e tij, e të mbash besën më Allahun (xh.xh) do të thotë, të mos i afrohesh asaj, që ka ndaluar Zoti i gjithësisë. Kjo do të thotë, që Allahu të të shohë

1. Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi me varg të pranuar.

aty ku të ka urdhëruar. Kjo është mbajtja e besës me Allahun (xh.xh).

Allahu (xh.xh) u flet të gjithë njerëzve duke iu thënë: "**A nuk më keni dhënë besën Mua o njerëz, që nuk do të adhuroni shejtanin, nuk do të shkoni pas tij. Ai me të vërtetë është armik i hapur për ju**". (Jasin: 60). Teorikisht ne ia kemi dhënë besën Allahut (xh.sh), por faktikisht nganjëherë e thyejmë këtë besë, duke shkuar pas dëshirave tona e duke bërë gjynahe. Kështu biem në gradat më të ulta.

Mbajtja e besës më Allahun (xh.xh) është cilësi e besimtarëve, është burrëri, është me të vërtetë tipar, që besimtari nuk duhet ta humbë kurrë. Madje edhe nëse bën gabime, ai duhet t'i rikthehet Allahut (xh.sh), sepse i ka dhënë besën Atij dhe do të pyetet për atë besë.

Ne duhet ta mbajmë besën me Zotin tonë, sepse jemi muslimanë, jemi ndjekës të Profetit Muhammed (a.s) e nuk jemi çifutë, sepse mosmbajtja e besës me Zotin është cilësi e çifutëve. Ata i jepnin besën Zotit dhe pastaj e harronin besën e dhënë. Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: "...**dhe kujtoni të mirat që ju dhashë juve dhe mbajeni mend premtimin tuaj, që Unë të mbaj zotimin Tim ndaj jush**". (Maideh: 7).

E kemi të nevojshme të dëgjojmë sesi e mbajtën besën e tyre ata besimtarë muslimanë, të cilët nuk patën mundësi ekonomike, por patën besim në zemra. Tregohet për një besimtar plak, i kaluar shumë në moshë, i quajtur Enes Ibn Nadr (r.a). Ky njeri nuk pati mundësi të marrë pjesë me Profetin Muhamed (a.s) në betejën e parë, që u zhvillua mes muslimanëve dhe jomuslimanëve, në betejën e Bedrit. Pas betejës ai i tha profetit (a.s): "O profet i Zotit, unë nuk arrita të marr pjesë në betejën e parë që bënë muslimanët, por në qoftë se Zoti më zgjat jetën dhe marr pjesë në një betejë tjetër, ke për ta parë ti edhe të gjithë besimtarët se çfarë do të bëj unë". Çfarë bëri ky plak, Enes Ibn Nadr?! Kur erdhi beteja e Uhudit, atëherë kur muslimanët u tërhoqën nga beteja, kur shigjetarët e tradhëtuan urdhërin e profetit të Zotit (a.s) dhe mbeti vetëm profeti Muhamed (a.s) me një pjesë besimtarësh, që po e ruanin atë, atëherë ky plak besimtar nuk e harroi besën që i dha Allahut (xh.xh) dhe iu turr ushtrisë armike. Një nga besimtarët e kap dhe i thotë: "Ku shkon o musliman? Ata do të të vrasin". Plaku i përgjigjet: "Pasha Zotin, i kam dhënë besën Allahut (xh.xh) e nuk do ta thyej besën, se më ka mbetur merak që nuk mora pjesë në betejën e parë". Pasi tha këto fjalë, ai futet në ushtrinë armike. Pas betejës e gjetën trupin e tij me mbi 80-të plagë dhe kufomën e tij të deformuar. Profeti Muhamed (a.s) tha: "**Me të vërtetë ky njeri e mbajti besën e tij**"[2].

Allahu (xh.sh) në Kuranin famëlartë thotë: "**Ka prej besimtarëve nga ata burra që e kanë mbajtur besën, që i kanë dhënë Allahut (xh.xh)**". (Ahzab: 23). I pari i tyre ishte Enes Ibn Nadr (r.a).

Besa mbahet me profetin e Zotit, me Muhamedin (a.s) e besa që i kemi dhënë këtij profeti është "**ta mbajmë fenë e tij, të mos e ulim atë**". Besa që i kemi dhënë atij është "**të mos e humbim namazin**". Porosia e fundit e Profetit Muhammed (a.s) para se të ndërronte jetë ishte: "**O besimtarë, kujdes namazin, kujdes namazin, kujdes namazin**!"[3].

Ai besimtar që mban namazin, ai ka mbajtur besën përpara Allahut (xh.sh) dhe përpara profetit Muhamed (a.s).

A e dini si ka ardhur feja jonë deri në ditët tona? Mos kujtoni se ka ardhur në rrugë të shtruara me lule e trëndafila. Ka ardhur me gjak të derdhur, ka ardhur me sakrifica. Besa e parë që u mbajt në Islam ishte **besa e ensarëve**, atyre njerëzve që i dhanë besën profetit Muhamed (a.s). Ata thanë: "Vetëm hajde në vendin tonë, se do të të ruajmë siç ruajmë gratë tona e fëmijët tanë. Ashtu siç ushqejmë fëmijët tanë, ashtu kemi për të shpenzuar edhe në fenë tënde". Ata me të vërtetë e mbajtën besën e tyre. Erdhi koha e u sprovuan shumë. U vdiqën fëmijët, u vdiqën gratë dhe pasuritë u shpenzuan, por ata e mbajtën besën e tyre, derisa Allahu (xh.xh) e plotësoi fenë e tij. Prandaj profeti Muhamed (a.s) vdiq në Medine edhe pse vendlindjen e kishte në Meke. Nuk i tradhëtoi kurrë ensarët edhe pse u çlirua Meka, sepse ata e mbajtën besën e tyre dhe profeti (a.s) iu pati dhënë besën, që nuk do t'i braktiste kurrë këta muslimanë, që e mbajtën besën përpara Allahut (xh.xh).

Muslimanët kanë ditur ta mbajnë besën me profetin Muhamed (a.s), ta zbatojnë urdhrin e tij edhe në qoftë se iu kërcënohej jeta. Tregohet një histori mjaft e habitshme: Në një nga betejat, profeti Muhamed (a.s) u thotë shokëve të tij: "**Në qoftë se do të takoni Ebul Buhturin, mos e vrisni atë, sepse kur ishim ngushtë në Mekë, ai erdhi dhe shpenzoi nga pasuria e tij, e mbajti besën dhe ishte bujar me ne**". Gjatë betejës njërit prej të rinjve muslimanë iu dha rasti të paraqitej ballë për ballë me këtë person. Sapo e pa atë, iu kujtua fjala e profetit Muhamed (a.s) "**Mos e vrisni Ebul Buhturin**" dhe e anashkaloi. Ebul Buhturi ishte në ushtrinë armike, ishte edhe shumë i fortë, prandaj e pyet: "Pse u largove prej meje? A ke frikë"? I riu musliman i thotë: "Pasha Zotin unë nuk të kam frikë. Unë kam frikë Allahun (xh.xh), por profeti Muhamed (a.s) na ka porositur mos të të vrasim, se ti ke bërë një veprim të mirë e profeti i Zotit nuk e harron atë veprim". Burri i tha: "Po sikur unë të të

2. Transmeton Buhariu, Tirmidhiu dhe Ibn Ebi Hatim.

3. Transmeton Ahmedi dhe Tahaui me varg të vërtetë.

luftoj, çfarë do të bësh?" Djaloshi tha: "Unë prapë nuk luftoj, sepse i kam dhënë besën profetit Muhamed (a.s)". Por Ebul Buhturi nguli këmbë dhe iu turr muslimanit për ta vrarë. Ky musliman u largua, që të mos ballafaqohej me Ebul Buhturin, vetëm e vetëm që të mos thyente besën e profetit Muhamed (a.s). Tregon vetë ky djalë: "Sa herë që ktheja kokën, habitesha se ai po vinte pas meje për të më vrarë dhe isha në një dilemë të madhe: Ta vrisja këtë person, që më kërcënonte jetën apo të largohesha. Vendosa të largohem, por ai ishte më i shpejtë se unë. Kur ktheva kokën një moment, pashë se shpata e tij ishte mbi kokën time. Atëherë mendova se ishte më e rëndësishme për mua që të ruaj jetën dhe u ktheva dhe e vrava atë person".

Po çfarë bëri ky musliman? Menjëherë në këtë moment, duke qarë e duke u dridhur u kthye tek profeti Muhamed (a.s) duke thënë: "O profet i Zotit unë e theva besën tënde, unë e vrava Ebul Buhturin" dhe pastaj i tregoi si kishte ndodhur. Profeti (a.s) i tha: "**Nuk ka problem, Zoti të fal**". Shikoni deri në çfarë përmasash arrinte besa e këtyre njerëzve ndaj profetit (a.s)[4].

Njëherë profeti Muhamed (a.s) i tha një grupi muslimanësh: "**Adhuroni Allahun (xh.sh) dhe mos i bëni shok Atij"** Pastaj iu tha në vesh: "**Mos iu kërkoni kurrë njerëzve, asnjë gjë**"[5].

Kaluan disa kohë e këta muslimanë patën vështirësi ekonomike, por nuk e shtrinë dorën, sepse i kishin dhënë besën profetit Muhamed (a.s). Madje kalonin në atë ekstrem, saqë kur ndonjërit prej tyre i binte shkopi dhe ai ishte hipur mbi kalë, zbriste vetë dhe e merrte shkopin edhe pse ishte plak i vjetër. Ata thoshin: "Nuk do ta thyejmë besën që i kemi dhënë profetit (a.s)". Ata jetuan me besën ndaj pejgamberit (a.s) dhe vdiqën me këtë besë.

Kjo fe ka ardhur me gjakun e dëshmorëve, ka ardhur me besën e burrave, prandaj vetëm burrat mund ta mbajnë këtë fe, vetëm burrat dinë ta mbajnë amanetin përpara Allahut (xh.xh) dhe përpara profetit Muhamed (a.s).

Një vend tjetër ku duhet mbajtur besa është **besa me familjen**, është besa në mes bashkëshortëve. Është e vërtetë se pjesa më e madhe e njerëzve nuk shkruajnë kushte në aktmarrëveshjen e martesës, por ato kushte dihen, ato kushte janë thënë përpara Allahut (xh.xh).

Kushti kryesor është që bashkëshorti të mos tradhëtojë bashkëshorten apo anasjelltas. Burri nuk duhet ta tradhëtojë, gruan, kur ajo nuk është në shtëpi dhe anasjelltas. Sot shikojmë krime familjare dhe ndoshta shkaku kryesor i tyre është mosmbajtja e besës. Besa mes gruas dhe burrit është besë ma Allahun (xh.xh). Profeti Muhamed (a.s) ka thënë: "**Nuk di ndonjë besë që mund të mbahet më shumë sesa besa mes burrit dhe gruas. Ajo besë është sekret, është amanet i dhënë përpara Allahut (xh.xh)**".

Tek besa mes bashkëshortëve hyjnë edhe sekretet që kanë mes tyre. Këto sekrete nuk duhet të dalin në rrugë, por për fat të keq, kjo gjë është bërë epidemia e kohës. Shkaku kryesor i divorceve, i ndarjes familjare është se nuk ruhen këto sekrete.

Feja jonë të mëson ta mbash besën edhe me fëmijët e vegjël. Babai duhet ta mbajë besën me fëmijën e tij, sepse në qoftë se nuk e mban besën, ky fëmijë do të rritet si i ati i tij dhe nuk do ta mbajë besën. Kështu njerëzit rriten duke qenë njerëz të besës ose jo të tillë, sepse edhe të parët e tyre ashtu kanë vepruar.

Feja jonë arrin deri atje sa thotë: "Besa mbahet edhe me armikun, edhe me atë që nuk është i familjes tënde, nuk është i fesë tënde, nuk është i rrugës që ti ndjek". Besa mbahet edhe me armikun, se është besë më Allahun (xh.sh).

A e dini si kanë hyrë në Islam njerëzit e një qyteti shumë të madh të quajtur Hims, në Sirinë e sotme? Kur muslimanët hynë në atë qytet, u thanë atyre: "Në qoftë se do të pranoni të hyni në Islam, nuk keni detyrime ndaj nesh, por në qoftë se nuk hyni në Islam, keni detyrim një taksë simbolike dhe ne do t'ju ruajmë juve nga çdo armik". Ata nuk pranuan të bëhen muslimanë dhe paguan taksën. Pas shumë vitesh qyteti i tyre u sulmua nga ushtria armike. Kur muslimanët e panë veten të pafuqishëm ndaj armikut, menjëherë ua kthyen taksat banorëve të vendit dhe u thanë: "Na falni, ne nuk mundëm t'ju ruajmë, prandaj merreni taksën tuaj". Banorët e qytetit ishin kristianë, siç ishte ushtria që po sulmonte qytetin, por u prekën shumë nga

TA DUASH ISLAMIN, DO TË THOTË TA DUASH TË MIRËN, TË KESH DËSHIRË TË PËRHAPET MIRËSIA, BAMIRËSIA, VLERA, E PASTËRTA, TË PËRHAPET NAMAZI, TË PËRHAPET HIXHABI, TË PËRHAPEN PUNËT E MIRA NË SHOQËRINË KU JETON, TË KËNAQESH KUR SHIKON DIÇKA TË MIRË DHE TË URRESH KUR PËRHAPET E KEQJA.

4. Siratu Ibn Hisham.
5. Muslimi.

sjellja e muslimanëve dhe thanë: "A të tillë njerëz qenkeni ju? S'ka bërë vaki të na japë kush taksat mbrapsht. Kemi pasur edhe të tjerë pushtues. Ata ishin kristianë si ne, por na kanë mbytur në taksa. Nuk kemi parë të tillë njerëz, nuk kemi parë të tillë fe. Që nga ky moment ne jemi muslimanë". Kështu të gjithë u futën në fenë islame e iu bashkuan ushtrisë muslimane.

Dy nga sahabët kryesorë nuk morën pjesë në betejën e Bedrit. Do të pyesë dikush se për cfarë shkaku! Ndërsa po shkonin për t'u bashkuar me profetin Muhamed (a.s), i kapi ushtria armike, ushtria e kurejshëve dhe u tha: "Ku po shkoni?" Ata thanë: "Për në Medine". Ata thanë: "Ju shkoni për të luftuar me Muhamedin kundër nesh. Nuk do t'ju lëmë të lirë, derisa të na jepni besën përpara Allahut (xh.sh), se nuk do të luftoni me ta kundër nesh". Këta muslimanë u detyruan të japin besën. U detyruan të betohen në emër të Allahut (xh.sh), që nuk do të luftonin me profetin (a.s). Sapo shkuan te profeti (a.s), i treguan çfarë u kishte ndodhur dhe e pyetën sesi duhet të vepronin.

Profeti Muhamed (a.s), ai njeri që ishte njeriu i besës u tha: "**Mbajeni besën e dhënë, mbajeni premtimin përpara Allahut (xh.sh)". Ne e lusim Allahun të na japë forcën tuaj**". Profeti (a.s) i tha këto fjalë, edhe pse ushtria muslimane kishte nevojë për numër, por besa e dhënë duhej mbajtur. Këta sahabe nuk e thyen besën edhe pse ajo u ishte dhënë armiqve, atyre që ndoshta do të vrisnin profetin Muhamed (a.s).

Profeti i Zotit e mbante besën e tij. Tregohet se Othman Ibn Talha (r.a) ishte personi, që kishte në dorë celësat e Qabes. Kur Pejgamberi (a.s) ishte në Mekë, i kishte thënë njëherë: "**O Othman m'i jep celësat të shikoj Qaben nga brenda**". Ai nuk ia dha. Atëherë profeti (a.s) i thotë: "**O Othman, ndoshta do të vijë një ditë, kur këto çelësa të bien në dorën time. Çfarë do të bësh atë ditë**"? Ky njeri i tha: "Inshallah nuk jam gjallë deri atë ditë, por në qoftë se vjen puna, që çelësat e Qabes të bien në doren tënde, dëshiroj më mirë të jem i vdekur".

Erdhi dita që u clirua Meka. Othman Ibn Talha (r.a) jetoi e u bë musliman. Profeti Muhamed (a.s) i tha: "**O Othman më ke premtuar dikur, se nuk do të m`i jepje çelësat e Qabes. A nuk m'i jep ato tani, që ta shikoj Qaben nga brenda".** Othman Ibn Talha i vënë në siklet i thotë: "Posi o profet i Zotit, tani po shkoj t'ia marr nënës, sepse çelësat i mban ajo". Shkoi në shtëpi dhe kërkoi çelësat, por nëna e tij nuk ia jepte.

Atëherë Omer Ibnul Hatabi (r.a) shkoi për të kërkuar çelësat. Omeri (r.a) kishte personalitet të madh dhe njerëzit e kishin frikë. Sapo nëna e Othman Ibn Talhas dëgjoi zërin e Omerit (r.a), menjëherë ia dha celësat djalit të saj. Kështu Othman Ibn Talha (r.a) ia çoi çelësat profetit (a.s), por ai i tha: "**O Othman ti pate thënë që s'do m'i japësh kurrë çelësat e Qabes dhe unë nuk t'i marr këto celësa. Unë vetëm do të shikoj Qaben nga brenda dhe celësat janë prapë të tutë. Askush nuk do t`i marrë ato çelësa prej teje apo prej familjes tënde deri sa të bëhet Kijameti, përveç ndonjë tirani apo zullumqari**"[6].

Është fakt se edhe sot e kësaj dite, çelësat e Qabes janë në këtë familje, askush nuk guxon t'i marrë, sepse profeti (a.s) i ka dhënë besën kësaj familjeje dhe muslimanët nuk mund ta thyejnë besën e profetit të Zotit.

Në qoftë se dikush nuk e mban besën me Allahun (xh.xh), tek ai njeri nuk ka dobi, ai s'mund ta mbajë besën me asnjeri tjetër, sepse ai s'mban besën me Krijuesin, me Allahun (xh.sh).

Jemi shumë të sigurt, se të gjithë kalojmë momente vështirësie, momente krize, momente dobësie. Secili prej nesh, madje edhe ata që nuk janë muslimanë, edhe ata që thonë që nuk besojnë tek Allahu (xh.xh), i japin një besë Zotit, i japin një premtim Allahut (xh.xh) duke thënë qoftë edhe me ndërgjegjen e tyre: "O Zot, po na shpëtove nga kjo, nuk do të kthehemi atje ku ishim". Por në të vërtetë, kalon koha dhe këta njerëz e harrojnë besën, që i kanë dhënë Allahut (xh.sh). Kjo besë nuk mbaron me dynjanë, kjo besë do të dalë dëshmitare kundër njeriut ditën e Gjykimit.

Të nderuar besimtarë muslimanë! Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë besën me Zotin tonë, madje muslimanët kanë obligim të mos harrojnë edhe besën, që prindi i tyre mund t'i ketë dhënë Zotit. Nëse e ke dëgjuar prindin tënd duke i dhënë besën Allahut, që do të shkojë në Haxh, kurdo që të të jepet mundësia, e ke ogligim si musliman që ta mbash këtë besë, sepse është besë përpara Allahut (xh.sh). Ai njeri që nuk mban besën para Zotit, le ta dijë se dëmton dhe ul vetëm veten e tij.

Njeriu kalon situata nga më të ndryshmet. Ai shpesh i harron mirësitë e Allahut (xh.sh) dhe nuk falenderon e nuk e mban besën. Harron se një ditë nuk ka bukë për të ngrënë, ndërsa ditën tjetër shpërdoron pa masë. Harron se një ditë është i sëmurë, ndërsa ditën tjetër ngrihet i shëndetshëm dhe e harron veten e tij, harron edhe të sëmurët që janë siç ishte ai.

Ebu Hurejre (r.a) transmeton, se profeti (a.s) ka treguar një histori mjaft të bukur në lidhe me mbajtjen e besës: "Njëherë Allahu (xh.sh) deshi të sprovojë tre njerëz nga beni israilët. Njëri prej tyre vuante nga lebroza, një sëmundje e lëkurës, nga e cila lëkura dhe mishi bien në tokë. I dyti nuk kishte flokë edhe të gjithë njerëzit talleshin me të. I treti

6. Transmeton Siratu Ibn Hisham.

ishte i verbër. Allahu (xh.xh) dërgoi një nga melekët e tij tek këta njerëz. Ai i tregon çdonjërit prej këtyre njerëzve se është melek i Allahut (xh.xh) dhe Zoti do t`i plotësonte çdo dëshirë që kishte.

I pari thotë: "Pasha Zotin, dua vetëm që Zoti të ma kthejë lëkurën si gjithë njerëzit e tjerë, dua ta shoh njëherë veten time si gjithë të tjerët. Por meleku i thotë: "Vazhdo, kërko diçka tjetër". Atëherë ai thotë: "Më pëlqejnë devetë". Meleku i jep një deve dhe i thotë: "Kij kujdes, mos e harro besën që i ke dhënë Allahut (xh.sh), mos e harro këtë ditë". Njeriu ia kthen: "Pasha Zotin, nuk mund ta harroj këtë ditë. Si mund ta harroj besën, që i dhashë Atij që më ktheu lëkurën time, Atij që më dha pasuri, si mund ta harroj këtë besë të dhënë"?! Meleku shkon tek i dyti. I dyti kërkon flokë, që të mos e tallnin njerëzit dhe kërkon një lopë. Meleku i jep flokët dhe lopën dhe i thotë: "Kujdes, mos e harro besën që i ke dhënë Allahut (xh.sh)".

Pastaj meleku shkon tek i treti. I treti kërkon vetëm të ketë sy, të shikojë njëherë dynjanë me sytë e tij dhe kërkon një dele. Meleku i kthen shikimin dhe i jep edhe një dele. Erdhi koha që të parit iu bë një tufë e madhe me deve, saqë s'mund t'i numëronte, atij tjetrit iu bë një kope e madhe me lopë, po ashtu dhe të tretit iu bë një kope e madhe me dele. Allahu (xh.xh) është Ai, që i sprovon njerëzit e tij, me pasuri, me varfëri, me sëmundje e me shëndet. Dërgoi të njëjtin melek te këta njerëz, por jo në formën e parë.

Meleku shkon tek i pari në formën e një plaku të sëmurë me lebrozë, me të njëjtën sëmundje që kishte ai njeri në fillim. Plaku (meleku) i thotë: "O njeri, o ti që të paska dhënë Allahu (xh.xh) këtë lëkurë të bukur, të paska dhënë gjithë këtë pasuri, kam ngelur në rrugë. Më jep vetëm një deve që të arrij në shtëpinë time". Ky njeri e harroi veten e tij, e harroi besën, që i kishte dhënë Allahut (xh.sh) dhe i thotë: "Sa njerëz vijnë në ditë si puna jote, nuk mund t'iu mbaj të gjithëve". Meleku i thotë: "Pash Zotin, pash Allahun që të ka dhënë këtë lëkurë të bukur, këtë pasuri, më jep diçka". Njeriu thotë: "Mua më vijnë shumë si puna jote dhe nuk kam kohë të merrem me të gjithë ju". Meleku i thotë: "Po më duket sikur unë të njoh ty. Ti nuk ke qenë gjithmonë kështu i pasur". Njeriu thotë: "Nuk më njeh. Unë këtë pasuri e kam marrë brez pas brezi". Atëherë meleku i thotë: "Në qoftë se po thua të drejtën, të bëftë Allahu sic ke qenë".

Pastaj meleku shkon tek i dyti në formën e një plaku pa flokë, njëlloj siç kishte qenë ky njeri më parë. I lutet që t`i japë një lopë, por nuk merr asgjë prej atij njeriu, sepse edhe ai e kishte harruar besën, që i kishte dhënë Zotit. Atëherë meleku i thotë: "Në qoftë se po thua të drejtën, të bëftë Allahu sic ke qenë". Pastaj largohet prej tij.

Pastaj meleku shkon tek i treti në formën e një plaku të verbër dhe i thotë: "Më jep një dele, ta shes e të shkoj në shtëpinë time". Ky person nuk e kishte harruar besën, që i kishte dhënë Alahut (xh.sh). Ai thotë: "O ti që po më lutesh në emër të Allahut (xh.sh). O ti që je i verbër, sic kam qenë edhe unë! Dije mire se unë nuk kam pasur sy, nuk kam pasur asnjë pasuri, gjithçka që shikon janë prej Allahut (xh.sh). Meqë m'u lute në emër të Allahut (xh.sh), merr çfarë të duash dhe lër çfarë të duash, se të gjitha i kam prej Zotit të gjithësisë. Ky besimtar nuk e dinte se kush është ky plak, por plaku i tha: "Unë jam meleku i Zotit që kam ardhur tek ti para shumë kohësh. Dy shokët e tu e thyen besën përpara Allahut (xh.sh), ndërsa ti e mbajte atë. Zoti ta shtoftë bukurinë, të dhashtë jetë e pasuri".

> TA DUASH KËTË FE, DO TË THOTË TA DUASH VËLLAIN QË KE NË KRAH, TA DUASH ÇDO MUSLIMAN, DO TË THOTË T'I LUTESH ZOTIT, QË T'I AFROJË ZEMRAT TONA. O ZOT MOS NA BËJ NGA ATA NJERËZ, QË SHIKOJNË NJË GABIM TË VOGËL TEK VËLLAI I TYRE DHE NUK SHIKOJNË PEMËN E MËKATIT, QË ËSHTË PËRPARA SYVE TË TYRE, TEK VETET E TYRE. PRA LE T'I AFROJMË ZEMRAT TONA, T'I JAPIM DORËN NJËRI – TJETRIT, TË BASHKOHEMI SE NUK JEMI SHUMË, POR JEMI PAK.

Kjo histori mund të duket shumë e thjeshtë, por ajo ndodh çdo ditë me jetën tonë. Ajo ndodh, ndoshta jo me verbërinë, apo me sëmundjet e lëkurës, po ndodh me çdo lloj sëmundje që ne kemi, me situatat ku ne kalojmë.

Shembulli i besimtarit është ai i treti, kurse shembulli i pjesës më të madhe të njerëzve janë ata dy të parët. Pjesa më e madhe e njerëzve e harrojnë besën e dhënë përpara Allahut (xh.sh).

Lusim Allahun (xh.sh) të na bëjë njerëz të besës përpara Allahut (xh.sh), njerëz të besës me profetin (a.s), njerëz të besës me familjet tona, njerëz të besës edhe me jomuslimanët, madje edhe me armiqtë e Islamit.

Lus Allahun (xh.sh), të mos na bëjë prej atyre njerëzve, që e thyejnë besën.

Lus Allahun të na bëjë njerëz, që e kanë mbajtur amanetin e Allahut (xh.xh). Lusim Allahun (xh.xh) që t'i mbushë zemrat tona me besim, t'i përmirësojë moralet tona, t'i zbukurojë fjalët tona, të na i falë neve gabimet tona, t'i falë prindërit tanë, t'i falë familjet tona, t'i falë të gjithë ata njerëz që e duan faljen.

Amin!..



Përgëzimi që vjen me pranverën

Kadrije Bajraktar

Kur e përshkruan pranverën, Mevlana thotë:

"Pranvera, lajmëtari i të dashuruarit, erdhi krejt lumturi. Trëndafili, për mbërritjen tënde erdhi në trëndafilishte. Ngaqë pa fytyrën tënde, edhe gjembi duket i bukur. E vdekura po çel filiza. Misteri që fshehu toka, tashmë u bë i dukshëm."

Pranvera është një nga temat e pandashme të poezisë. Pranvera është burimi i lumturisë së poetit. Kur portretizohet pranvera, zakonisht theksohen fjalët trëndafil, bilbil, tulipan, zymbyl, blerim. Kur thuhet pranverë, njeriu lehtësohet. Pranvera simbolizon jetën dhe gjallërinë.

Me të vërtetë, pranvera me ardhjen e saj e tregon ndikimin te të gjitha gjallesat. Me ardhjen e pranverës bota zgjohet nga gjumi i thellë letargjik. Pranvera na tregon cicërimat e zogjve në degën e pishës, buzëqeshjen e pemëve me veshjen e tyre ngjyra-ngjyra, ngazëllimin, gëzimin dhe shkurtimisht jetën.

Përveç kësaj pranvere të dukshme, ka edhe një pranverë tjetër. Ajo është shumë më e bukur se kjo pranverë që shohim. Trëndafilat që çelin në atë pranverë e kanë marrë nga Ai aromën. Ashtu siç e ringjall sipërfaqen e tokës shiu i pranverës, edhe lindja e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, është një mëshirë që e ringjalli të gjithë njerëzimin.

Ishte data 20 e muajit Prill... Ajo perlë ra në Mekë si një margaritar me shirat e bereqetshëm të Prillit në faqet më të çmuara të historisë. Lindja e Tij solli një pranverë krejt tjetër në katër anët e botës. Trëndafili nga Ai e mori aromën. Toka çdo vit feston lindjen e Tij dhe blerohet gjithandej. E gjithë bimësia shpërthen lule shumëngjyrëshe... Sepse Ai është thelbi i gjithësisë, fara dhe dashuria e saj. Muhamedi (a.s.), është dritë. Po të mos ishte Ai, salallahu alejhi ve selem, asgjë në këtë botë nuk do të kishte vlerë. Të gjitha krijesat, kur kujtojnë Atë, marrin vlerë. Edhe fara, ngaqë e di këtë, pret shirat e Prillit dhe bleron.

Zogjtë i bëjnë foletë e tyre me dashurinë që marrin nga Ai (a.s.)... Frutat marrin shije nga dashuria e Tij. Në çdo buzëqeshje është gjurma e Tij. Emri i Tij ndryshe përmendet në qiell, ndryshe në tokë...

Mevlana thotë në Mesnevinë e tij:

"Miq, mos e mbuloni trupin nga freskia e pranverës, sepse era e pranverës, ashtu siç ndikon te pemët, ndikon edhe në jetën tuaj.

Por kini kujdes nga era e vjeshtës, sepse ajo vepron me ju ashtu siç vepron me vreshtat dhe degët.

O Pejgamber!.. Sa e bukur ardhja Jote me pranverën. Si i blerove zemrat... Edhe Ti vjen me flladin e pranverës dhe i ringjall zemrat..."

M bulesa

Rukije Gënyly

Të mbulohesh, të fshihesh, të kalosh prapa dikujt ose diçkaje... Sipas jurisprudencës islame mbulesa (vendosja e shamisë) është: mbulimi i pjesëve të domosdoshme të trupit tek gratë. Pjesët e trupit të cilat duhen mbuluar dhe që është e ndaluar të shikohen nga njerëzit e tjerë quhen: 'pjesë të auretit'. Përsa u përket çështjeve të auretit ekzistojnë disa mendime. Mendimi më i fortë (që ka mbështetje më të madhe nga burimet e fesë sonë) na thotë që njeriu duhet t'i mbulojë pjesët e auretit edhe kur është vetëm. Duke u bazuar në këtë gjë themi se në momentin kur kemi mundësi të gjejmë një veshje të pastër nuk është e lejuar që të falemi pa rroba edhe në qoftë se jemi vetëm në një dhomë të errët. (Ibn Abidin, Reddul- Muhtar, Misir, I, 375.)

Përveç kohës kur bëhet dush apo kryhen nevojat personale, mbulimi i pjesëve të auretit është farz; dëshmi për këtë janë Kurani dhe Suneti.



NEVOJA E NJERIUT PËR T'U MBULUAR

Nevoja e njeriut për t'u mbuluar e ka zanafillën që me njerëzit e parë, me Ademin dhe Havanë. Ja se si e shpjegon ajeti Kuranor se sa gjë e shëmtuar është lakuriqësia:

"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë." (Araf, 27)

Allahu ka krijuar shumë kushte për të ndihmuar veshjen e njerëzve, edhe leshi i kafshëve është një nga këto.

"Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka krijuar lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni." (Nahl, 15)

Gjëja më e mirë për njerëzit është veshja me rroba të përshtatshme për fenë tonë.

"O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë disa shenja të Allahut, që ju të merrni kështillë." (Araf, 26)

Ne duhet të jemi të kujdesshëm kur shkojmë në një mesxhid apo diku tjetër ku bëhen adhurime dhe të mundohemi që të vishemi me rroba të bukura. Në qoftë se nuk e bëjmë dot këtë gjë, të paktën duhet të kemi kujdes për të mos veshur rroba që mund t'i shqetësojnë njerëzit e tjerë:

"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kur-



do që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë." (Araf, 31)

PËRPJEKJA PËR T'U MBULUAR (VESHUR)

Njeriu vishet për t'u mbrojtur nga i ftohti ose nga i nxehti. Ai vishet për të mbuluar defektet e veta dhe për të treguar pjesët e bukura. Për një besimtar, arsyeja kryesore e veshjes (mbulesës) duhet të jetë ruajtja nga shikimet e njerëzve të huaj dhe mbrojtja e trupit dhe shpirtit nga të gjitha llojet e sulmeve.

Në Kuran urdhërohen si burrat ashtu edhe gratë që të ruajnë sytë dhe trupin nga shikimet haram:

"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre *(nga e ndaluara)* ***dhe ta ruajnë nderin e tyre*** *(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)****! Kjo është më mirë për ta!"*** (Nur, 30)

"Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre *(nga e ndaluara)****, ta ruajnë nderin e tyre*** *(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)* ***dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre*** *(të kokës)* ***dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim*** *(si skllave)****, ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët*** *(për tokë)****, në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!"*** (Nur, 31)

Gratë kur dalin nga shtëpia (ose kur janë përpara burrave të huaj) duhet që sipër veshjes që mbajnë në shtëpi të hedhin një veshje tjetër më të trashë. Ajeti kuranor thotë:

"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre *(të kokës)* ***përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."*** (Ahzab, 59)

Nga ana tjetër, për sa i përket grave të moshuara të cilat nuk presin të martohen dhe të cilave u ka humbur tërheqja që mund të kenë ndaj burrave, u janë dhënë disa lehtësira.

"Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha." (Nur, 60)

Në një ajet tjetër mësojmë se gratë dhe burrat të cilët i mbulojnë dhe i mbrojnë vendet e turpshme do të kenë një shpërblim shumë të madh. (shiko: Ahzab, 35)

NË PERIUDHËN E INJORANCËS

Në kohën e injorancës njerëzit e bënin tavafin e Qabes të zhveshur. Si ditën ashtu dhe natën gratë dhe burrat bënin tavaf të zhveshur dhe për të justifikuar këtë veprim thoshin:

Aishja tha: 'Sigurisht që ka disa gjëra në të cilat gratë kurejshe janë më lart se ne, por unë betohem në Allah se nuk ka gra që i besojnë dhe veprojnë më shumë sipas Kuranit se sa gratë ensare. Kur u zbrit ajeti i sures Nur: ***"Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre*** *(të kokës)"* *burrat e tyre lexuan këto ajete dhe u kthyen në shtëpi. Këta burra ua lexuan ajetet grave, vajzave dhe motrave. Secila nga këto gra bëri shami nga rrobat që kishte në shtëpi, në mënyrë që të zbatonin ajetet e Librit të Allahut. Mëngjesin pasardhës ato shkuan me shami në kokë për faljen e namazit të sabahut.*



"Nuk mund të bëjmë tavaf duke mbajtur rrobat me të cilat bëjmë gjynahe!"

Islami e ka hequr këtë zakon dhe ka këshilluar që si në tavaf ashtu dhe në të gjitha vendet e tjera ku bëhen adhurime të vishen rrobat më të bukura të mundshme.

"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë." (A'raf, 31)

Në Islam, falja e namazit me veshje të pastër dhe të bukur është sunet. Njerëzit, edhe në jetën e ahiretit do të veshin rroba të bukura. Në Kuranin Kerim, kur përmendet shpërblimi i njerëzve që bëjnë punë të mira, përdoren këto fjali:

"Pikërisht atyre u përket Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur!" (Kehf, 31)

"S'ka dyshim se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu i fut në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen me byzylykë të artë dhe inxhi e rrobat e tyre do të jenë prej mëndafshi." (Haxh, 23)

"Aty do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali." (Insan, 15)

"Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendtë." Insan, 15)

MËNYRA E VESHJES PËR GRUAN

Pas zbritjes së ajeteve të tridhjetë dhe tridhjetë e një të sures Nur (ajete të cilat i kemi përmendur më sipër), Resulullahu e ka treguar në praktikë mënyrën e zbatimit të atyre ajeteve.

Sipas transmetimit të Aishes, një ditë vajza e Ebu Bekrit; pra motra e vetë Aishes, Esma kishte hyrë në një dhomë ku ndodhej Resulullahu me një veshje të hollë. Resulullahu salahu alejhi ve selem, e kishte hequr shikimin nga ajo dhe kishte thënë:

"O Esma! Femrës që arrin moshën e pjekurisë, nuk duhet që t'i dallohet asgjë përveç këtyre dhe këtyre." Resulullahu, kur ka thënë fjalët: 'Këto dhe këto' ka treguar me shenja: fytyrën dhe pëllëmbët e duarve." (Ebu Davud, Libas, 31.)

Për gratë, të gjitha pjesët e trupit përveç duar-

ve dhe fytyrës, janë auret. Sipas një pikëpamjeje të fortë, as këmbët nuk janë auret, sepse me këmbë ne ecim dhe njerëzit e varfër mund ta kenë të vështirë që t'i mbulojnë ato.

Përsëri , sipas një mendimi bindës, gratë e lira duhet të mbulojnë edhe krahët edhe veshët. "... ***dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme."*** (Nur, 31)

Në hadith thuhet:

"Pjesa e trupit që duhet mbuluar nga gruaja është auret. Kur ajo del jashtë, shejtani ia ngul sytë asaj." (Tirmidhiu, Rada, 18.)

Sipas transmetimit të Aishes radiallahu anha: *"Allahu Teala nuk e pranon namazin e falur nga vajza pa mbulesë."* (Ibn Maxhe, Tahare, 132; Tirmidhi, Salat, 160; Ahmed b. Hanbel, IV, 151, 218.) Në këtë hadith përfshihen edhe flokët.

Ja se si e shpjegon Aishja herën e parë të vendosjes së shamisë:

*"Allahu i mëshiroftë gratë muhaxhire; kur zbriti ajeti: "**Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre** (të kokës)"* (Nur, 31) *ato prenë copë nga fundi i tyre dhe nga ajo copë bënë shami (për kokën)."*

Safije binti Shejbe tregon.

*"Unë isha bashkë me Aishen. Po flsinim për gratë e fisit Kurejsh dhe për veshjet e tyre. Aishja tha: 'Sigurisht që ka disa gjëra në të cilat gratë kurejshe janë më lart se ne, por unë betohem në Allah se nuk ka gra që i besojnë dhe veprojnë më shumë sipas Kuranit se sa gratë ensare. Kur u zbrit ajeti i sures Nur: **"Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)"** burrat e tyre lexuan këto ajete dhe u kthyen në shtëpi. Këta burra ua lexuan ajetet grave, vajzave dhe motrave. Secila nga këto gra bëri shami nga rrobat që kishte në shtëpi, në mënyrë që të zbatonin ajetet e Librit të Allahut. Mëngjesin pasardhës ato shkuan me shami në kokë për faljen e namazit të sabahut."* (Buhari, Tefsiru Sure, 29/12)

AURETI I BURRAVE

Tek burrat, pjesa e trupit që duhet mbuluar është pjesa nga kërthiza deri tek gjunjët. Sipas një mendimi të fuqishëm edhe gjunjët quhen auret. Dëshmia për këtë çështje është hadithi i Pejgamberit tonë:

"Aureti i burrave është nga kërthiza deri tek gjunjët." (Ahmed b. Hanbel, II, 187.)

"Gjunjët janë pjesë e auretit." (Zejlai, Nasbur Raje, I, 297)

VEÇORITË E SHAMISË

Shamia duhet të ketë një trashësi të tillë që të mos e tregojë atë çfarë mbulon. Mbulesa me një copë që ka ngjyrën e mishit nuk quhet e tillë. Një rrobë e cila e tregon ngjyrën e trupit nuk mund të vishet në namaz dhe nuk mund të përdoret për t'u mbuluar. Në qoftë se veshja është e trashë por lejon që të dallohen format e trupit, namazi është i pranueshëm por kjo nuk është diçka e pëlqyeshme dhe e mira është një veshje e tillë të evitohet.

MËNYRA E MBULESËS

1- Një grua myslimane para burrave të huaj ose grave jo myslimane duhet të mbulojë të gjithë trupin përveç duarve dhe fytyrës. Mbulimi i këtyre pjesëve të trupit si në namaz edhe jashtë tij është farz. Për sa i përket këmbëve ka disa mendime, por sipas mendimit më të pranueshëm, këmbët mund të rrinë të zbuluara.

2- Gratë mund t'i zbulojnë disa nga pjesët e trupit si: dorën, këmbën, flokët etj.; para burrave me të cilët e kanë të ndaluar që të martohen. (Nur, 31-32)

3- Pjesa e auretit mes grave me njëra- tjetrën është pjesa nga kërthiza deri tek gjunjët. Përveç kësaj pjese të trupit gratë e kanë të lejuar që t'i zbulojnë pjesët e tjera. (El- Mavsili, El- Ihtijar, I, 45.) Kur flasim për auretin mes grave e kemi fjalën për gratë myslimane, sepse një grua myslimane nuk mund të rrijë pranë një gruaje jobesimtare me veshjen që qëndron pranë një gruaje besimtare. Kjo ndalesë është bërë me qëllimin që të mbrohen gratë myslimane nga përshkrimet që mund t'i bëhen tek burrat e huaj. Omer në një letër që i ka shkruar Ebu Ubejde (r.a.), i ka thënë: "Më ka ardhur lajmi që gratë myslimane kanë shkuar në hamam me gratë politeiste. Ky është një zakon që ka mbetur nga e kaluara. Një grua e cila beson Allahun dhe Ahiretin nuk e ka të lejuar që t'i tregojë vendet e auretit një gruaje që nuk është e fesë së saj." (Ibn Kesir, Muhtasarut- Tefsir, II, 600, 601.)

4- Në rastet e kurimit, është e lejuar që doktori, mamia, infermierja apo persona me profesione të ngjashme të shikojnë pjesët e auretit. Është e preferuar që gratë të zgjedhin gra për t'i kuruar. Në rastet kur diçka e tillë nuk është e mundur ndjekim rregullin: "Domosdoshmëria i bën të lejuara gjërat e pakëndshme."



PROBLEMET E KOMUNIKIMIT NË MARTESË

Dr. Timur Harzadin

Në ditët e sotme, po shtohen gjithmonë e më shumë problemet gjatë martesës dhe ngatërresat mes çiftit, situata që nganjëherë përfundojnë me divorce. Në këtë periudhë, si burri ashtu edhe gruaja kanë një rrëzim të fortë emocional dhe sigurisht që hidhërimi i tyre ka ndikim edhe tek prindërit e të dyja palëve dhe tek fëmijët. Foleja e ndërtuar me ëndrra të mëdha dhe shpresa të bukura, nganjëherë shkatërrohet si pasojë e disa problemeve të thjeshta komunikimi.

Gabimet që bëhen pa dashje ose ato që lindin si pasojë e një karakteri të tillë, nuk kanë si objekt vetëm bashkëshortin, por edhe njerëzit e tjerë. Mosmarrëveshje të tilla lindin pothuajse me të gjithë njerëzit. Por, kur mosmarrëveshjet ndodhin në gjirin e një familjeje, mes pjesëtarëve që e kalojnë të gjithë kohën nën të njëjtën çati, mërzia është më e madhe dhe më e papërballueshme. Ndërkohë çiftet që i vënë re problemet e tyre dhe përpiqen që t'i zgjidhin ato, mund t'ia dalin me sukses.

Disa prej gabimeve në komunikim gjatë martesës

1. PRESIONI NDAJ BASHKËSHORTIT, PËRPJEKJE TË VAZHDUESHME PËR T'IA MBUSHUR MENDJEN DHE PRITSHMËRITË PËR MIRATIMIN E MENDIMIT PERSONAL.

Nëse ushtroni presion të vazhdueshëm ndaj një personi dhe e urdhëroni atë gjatë gjithë kohës, ai do të fillojë të ndjehet si një send pa vlerë. Dhënia e direktivave të prera bën që njeriu të ketë zemërim të lindur nga mosvlerësimi. Një njeri që është nën këtë ndikim, në vend që të bëjë atë që i thoni, do të rezistojë akoma më shumë. Në veçanti, nëse bëhet fjalë për një njeri me ton zëri pak të ashpër, personi tjetër do të kalojë në pozita mbrojtjeje dhe me kalimin e kohës do të lindin diskutime të zjarrta.

2. ZAKONI PËR TË FOLUR PA E DËGJUAR TJETRIN, PRERJA E FJALËS

Një prej gabime kryesore në komunikim është paaftësia për të dëgjuar tjetrin, e ndjekur nga ndërprerja e fjalës për të shtuar diçka. Biseda me një njeri që flet me nxitim, që nuk të kushton vëmendje, që nuk dëgjon atë që i thua dhe që e ka zakon të ta ndërpresë fjalën; është shumë e mërzitshme. Shumë çifte duket sikur flasin me njëri-tjetrin, por nuk kuptohen.

3. NDRYSHIMI I TEMËS SË BISEDËS, KALIMI NGA NJË TEMË NË TJETRËN.

Mungesa e interesit për fjalët e tjetrit dhe e komenteve për atë që tha, krijojnë një ndjenjë të keqe tek bashkëbiseduesi. Dhënia e një komenti për fjalët që tha bashkëbiseduesi ose drejtimi i disa pyetjeve, ndihmojnë në krijimin e një komunikimi cilësor. Si gruaja, ashtu edhe burri e bëjnë vazhdimisht këtë gabim. Dhënia e detajeve të tepruara dhe shpjegimi i ngatërruar mund të

krijojë konfuzion tek bashkëbiseduesi. Një bisedë sa më e thjeshtë dhe me fjali të shkurtra do të bëjë të mundur një komunikim të kuptueshëm.

4. VAZHDIMISHT GJETJA E NJË ARSYEJE PËR T'U MËRZITUR.

Njeriu që ankohet vazhdimisht, që është gjithmonë i sëmurë dhe që ka probleme gjatë gjithë kohës, e bezdis njeriun që ka pranë. Një njeri që gjen probleme në çdo ambient, faktikisht, nuk mund ta përballojë dot lumturinë dhe dëshiron që njerëzit ta mërzisin. Faktikisht, mund të ketë edhe një arsye më të thellë se kjo: kënaqësia që merr nga hidhërimi dhe krenaria se ka arritur të qëndrojë në këmbë pas të gjitha goditjeve që ka marrë. Faktikisht në jetën e përditshme, të gjithë ne kemi plot ngjarje të vogla për të cilat duhet të jemi mirënjohës. Një mendje që mund ta dallojë këtë gjë, do t'i pranojë gjërat pozitive, por edhe ato negative ashtu si janë. Ky njeri do të jetë më i mëshirshëm, si me veten ashtu edhe me njerëzit e tjerë.

5. TË PARAGJYKOSH DHE TË NDIKOHESH

Në fillim të martesës partnerët janë të mbushur me dashuri dhe tolerancë për njëri-tjetrin. Ndërkohë, me kalimin e kohës fillojnë që të shikojnë më shumë anët negative të njëri-tjetrit dhe të lënë pas dore ato pozitivet. Me forcimin e afërsisë emocionale, shtohet ashpërsia e bisedës dhe zakoni për të bërë përgjithësime. Pra rritet ndjeshëm shpeshtësia e fjalive të tilla: "ti e bën këtë gjë gjithmonë" ose "ti ke qejf të më mërzitësh mua"... Nga ana tjetër, fjalitë pozitive dëgjohen përherë e më rrallë. Nëse nuk ka asnjë temë të re bisede, hapen dosjet e vjetra dhe kujtohen ngatërresat. Në vend që të veprohet në këtë mënyrë, është më e shëndetshme të vihen re anët pozitive dhe të përmenden sa më shpesh.

6. ZAKONI PËR TË DHËNË KËSHILLA DHE MENDIME TË PA-KËRKUARA.

Disa njerëz dinë çdo gjë, vazhdimisht japin këshilla dhe përsërisin mësime morali. Biseda të tilla mund të jenë të pëlqyeshme kur i dëgjon herën e parë, por përsëritja e tyre është shumë e mërzitshme. Kërcënime të tilla si: "Duhet të bësh kështu, se po nuk bëre kështu të pret kjo e ajo..." krijojnë bashkëbisedim kaotik. Do të ishte më mirë që ta këshillosh njeriun njëherë, e nëse ai nuk e preferon këshillën tuaj, duhet të keni respekt për zgjedhjen e tij.

7. SHMANGIA E MBARTJES SË NEGATIVITETIT TË PUNËS NË SHTËPI

Disa bashkëshortë vazhdimisht bëjnë përpjekje që lodhjen dhe negativitetin që kanë brenda vetes, t'ia transmetojnë partnerit. Kur është i zemëruar do që edhe tjetri të jetë i zemëruar dhe kur është i mërzitur kërkon që edhe tjetri të jetë i mërzitur. Ato përpiqen derisa t'ia arrijnë këtij qëllimi. Burri është i prirë që të transmetojë sjelljet tallëse dhe poshtëruese, ndërsa gruaja ndjehet keq nga sjelljet ironike dhe fajësuese. Me kalimin e kohës, sjellje të tilla bëhen shkak që partnerët të distancohen nga njëri-tjetri.

8. BISEDA QË NUK FINALIZOHEN ME VENDIM

Në momentin kur merr një vendim, vendos që të pajtohesh me përfundimet pozitive ose negative që mund të lindin nga një zgjedhje e tillë. Një njeri i rritur i merr përgjegjësitë e vendimit të vet, ndërsa një i rritur me shpirt fëmije nuk mund ta bëjë këtë gjë. Ky i fundit thotë një mendim, pastaj shton fjalën "por" dhe ndërton një fjali krejtësisht të kundërt me paraardhësen. Më pas shton edhe një herë fjalën "por" dhe rikthehet tek mendimi i fillimit. Një bisedë e tillë ka vetëm një rezultat: mërzitjen, zemërimin dhe dëshpërimin e bashkëbiseduesit.

9. TËRHEQJA E FËMIJËVE OSE NJERËZVE TË TJERË NË ANËN TËNDE

Disa prindër, në momentin e një diskutimi, bëjnë përpjekje për të marrë ndihmën e fëmijëve. Fëmija nuk mund të heqë dorë as nga nëna dhe as nga babai. Për këtë arsye prindërit nuk duhet të marrin si gjyqtar fëmijën. Nëse prania e një pale të tretë është e paevitueshme, duhet kërkuar ndihmë nga një i rritur ose nga një specialist.

10. PËRPJEKJET PËR TË NDRYSHUAR NJËRI-TJETRIN

Disa bashkëshortë që në fillim të martesës vendosin që të ndryshojnë disa gjëra tek bashkëshorti. Nga ana tjetër ato pretendojnë se partneri i ka pranuar ashtu si janë, pa qenë nevoja për ndryshime. Pas kalimit të muajve të ëmbël, fillojnë përpjekjet për ndryshime tek partneri. Ndryshimi i brendshëm i një njeriu kërkon kohë të gjatë dhe në disa raste është i mundur vetëm kur merret ndihmë profesionale. Për këtë arsye, do të ishte më mirë sikur partnerët ta pranonin dhe ta donin njëri-tjetrin ashtu si janë.

Si përfundim; komunikimi i ndërtuar në baza të forta mundëson vazhdimin e martesës në atmosferë qetësie dhe lumturie. Nëse praktikimi i këtyre teorive është i vështirë, këshillohet marrja ndihmë nga një specialist.



Gra të lodhura

Fatma Allada

Vajza që vijnë në jetë në tylin ngjyrë rozë, djem që rriten në blu me mjetet e farkëtarit... Që në çastet e lindjes fillojmë të edukohemi sipas gjinisë që kemi. Përgatitemi për role të ndryshme. Ndonëse jemi fëmijë të të njëjtëve prindër, rritemi duke na u komunikuar pikëpamje, sjellje, madje edhe fjalë të ndryshme. Edukohemi si të ndjeshëm ndaj nevojave që sjell natyrshmëria jonë. Si përfundim, ndonëse rritemi nën të njëjtën çati, kemi natyrshmëri e karaktere të ndryshme dhe zotërojmë botë krejt të ndryshme shpirtërore.

Ndërkohë që është një e vërtetë e jetës që këta dy lloje njerëzish, (burrat dhe gratë) të kenë specifika të ndryshme nga njëra-tjetra që merren dhe formohen me ndikimin e mjedisit, për fat të keq, puna ndryshon kur bëhet fjalë për kushtet e të punuarit. Gratë që ushtrohen në ambiente dhe punë të njëjta me burrat, detyrohen të punojnë me shumë sforcim dhe pa ndërprerje, madje edhe gjatë gjithë jetës...

Pritet që gratë me natyrshmërinë dhe strukturën e tyre të ndjeshme nën një çati me burrat që posedojnë një shpirt luftëtar kundrejt kushteve të vështira të botës së jashtme, të jenë të suksesshme dhe të tregojnë të njëjtën performancë kundrejt së njëjtës detyrë. Për më tepër turni i grave që janë larg ndjeshmërisë dhe që janë të detyruara të vendosin me logjikën dobi-dëm, nuk përbëhet vetëm nga vendi i punës... Bota ku jetojnë me punët e shtëpisë, përgjegjësinë e familjes dhe fëmijëve, i detyron ato të ndahen njëqind pjesë, sepse secila nga këto fusha kërkon të njëjtën rëndësi. Këto barra të rënda si përfundim bëhen shkak për depresione psikologjike të cilat quhen "sindroma e konsumimit (lodhjes)".

Gratë me këtë sindromë në të cilën përjetohen ndjenja e pamjaftueshmërisë, lodhjes kronike dhe konfuzionit, ngaqë mbulojnë më shumë se një rol, problemin që jetojnë, e shfaqin negativisht në ambientin shoqëror. Gratë të cilave u bie cilësia e jetesës, dita ditës kthehen në "nëna të dëshpëruara" dhe fillojnë të edukojnë breza të pashëndetshëm.

Meshkujt që në moshë të vogël në ambientet ku jetojnë, në shkollë, në mjediset shoqërore në lojërat që luajnë rriten me ndjenjën e luftëtarit dhe garuesit të cilat mbartin shfaqjen e forcës. Nevoja e natyrshmërisë së tyre i përgatit si "mbrojtës" kundrejt kushteve të vështira të botës së jashtme. Ndërsa te një vajzë, me një kukull në duar, zhvillohet ndjenja e mëmësisë dhe bashkë me të i zhvillohet edhe imagjinata. Gatuan dhe e imagjinon ambientin e shtëpisë ngjyrë rozë. Pastaj, kur këto dy botë të ndryshme rriten dhe konsiderohen të njëjtë në vendin e konkurrencës, gruaja zvarritet, sepse ajo nuk është rritur duke u përgatitur për këtë.

Për femrat konkurrenca është një faktor kërcënues. Është një ndjenjë që kërkon të qëndrojë larg mundësisë së lëndimit të të dashurve. Ndërsa për burrat, konkurrenca është pjesë bazë që mbështet përpjekjet e dhëna për të qëndruar në jetë. Për këtë arsye, nëse bëhet fjalë për një konkurrencë të vështirë në mjediset e punës, gratë largohen nga kjo ose shfaqin sjellje të gabuara duke u bërë tepër agresive. Ata nuk mund ta mbajnë ekuilibrin në asnjë lloj mënyre për shkak të natyrshmërisë së tyre, sepse konkurrenca nuk është një gjuhë që ata e kuptojnë.

Si rezultat, nëse gratë që e ndjejnë veten të pasuksesshme dhe të paafta janë edhe nëna, përgjegjësitë që kanë ndaj fëmijëve dhe ndaj bashkëshortëve, duan apo s'duan, fillojnë t'i reflektojnë në botën e brendshme të tyre. Kështu, ky proces që fillon me dëshirën për të fituar sa më shumë para dhe për t'u bërë njeri me karrierë, shoqërisë që nuk i ka bazat e forta, do t'i kthehet pas si dëshpërim.

Islami i ka dhënë gruas pozitën më të bukur dhe plotësisht të përshtatshme me natyrshmërinë e saj. Ajo është vetëdija e të qenët nënë. Në këtë mënyrë, gratë i ka mbajtur larg nga konkurrenca, depresioni e traumat psikologjike dhe u ka dhënë atyre vetëm bukurinë e një roli që është modeli për të jetuar duke marrë kënaqësi nga jeta. Gruaja luan rolin më të rëndësishëm në edukimin e brezave të ardhshëm si një shembull i moralit të lartë.

Pas çdo emri të suksesshëm, ka një nënë që e ka edukuar ose një bashkëshorte që e ka mbështetur. Në këtë mënyrë, del në pah rëndësia e të qenët grua dhe kuptohet se pozita e lartë nuk përbëhet vetëm nga të pasurit e një zyre në botën e jashtme.

Edukimi i brezave të fortë me nëna që janë të vetëdijshme dhe të shëndetshme shpirtërisht, është treguesi i një karriere të vërtetë e cila shndërrohet në kapitalin e të dy botëve.



TË GJESH ARGJENDARIN

Dikur një hoxhë i ditur i dha nxënësit që e kishte edukuar vetë një objekt shumë të ndritshëm dhe i tha: “Bir! Merre këtë dhe tregojua tregtarëve që të dalin para! Pyeti ata se sa para japin për të! Por mos e shit dhe sille këtu! Ti vetëm mëso se çfarë do të të thonë! Pastaj eja te unë dhe më trego!”

Nxënësi në fillim hyri në një dyqan ushqimesh dhe e pyeti dyqanxhiun: “Sa e blini këtë?” Dyqanxhiu iu përgjigj: “Për këtë mund të të jap vetëm një mijë lekë.”

Pastaj nxënësi shkoi te dikush që bënte samarë. Samarxhiu i tha: “Për këtë mund të të jap dhjetë mijë lekë.” Pak këtij, nxënësi shkoi te një argjendar. Kur argjendari e pa objektin që nxënësi e kishte në dorë, u hodh nga vendi dhe e pyeti: “Sa lekë do për këtë?” Kur nxënësi i tha se nuk mund ta shiste, argjendari iu përgjërua duke i thënë: “Ju lutem ma shisni mua këtë! Do t’ju jap dyqanin dhe shtëpinë, madje edhe tokat e mia.”

Nxënësi u kthye te hoxha i tij i ditur. Nxënësi i habitur ia tregoi atij të gjitha ato që i kishin ndodhur. Hoxha i ditur i tha nxënësit që nuk po e kuptonte dot situatën:

“Kimetin e një gjëje e di vetëm ai që ia di vlerën asaj. Kjo gjë është e çmueshme vetëm te ai që ia di vlerën. Në jetën e çdo njeriu patjetër që ka argjendarë që e dinë, e ndjejnë dhe e kuptojnë vlerën e tij...”

NJË **THËNIE**

“Mëshira, butësia dhe bujaria e bën njeriun të dashur edhe për armiqtë e tij.”

(Sadi Shirazi)

NJË **LUTJE**

“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët!”

(Shuara, 83)

FAKTE **INTERESANTE**

• Vendi më i nxehtë në sipërfaqen e tokës është krahina el-Ezize në Afrikë ku temperatura arrin deri në 58 gradë celsius në hije.

• Aftësia e një milingone për të nuhatur është të paktën e zhvilluar sa ajo e një qeni.

• Një ciklon tipik mund të gjenerojë energji të barabartë me një bombë 8000 megaton.



Pse duhet të konsumoni ARRA?

Studimet kanë zbuluar se një regjim ushqimor i pasur me arra dhe vaj ulliri është shumë i mirë për uljen e kolesterolit dhe po aq efikas në rënien në peshë si një regjim i pasur në karbohidrate dhe me ushqime me pak yndyrë.

Sipas ekspertëve, ky nuk është përfitimi i vetëm që arrat i ofrojnë organizmit.

Arrat janë të pasura me yndyrna polio-të-pangopura, të cilat i bëjnë mirë shëndetit të zemrës dhe ulin kolesterolin.

Për të arritur në këtë konkluzion, studiuesit e mjekësisë të Universitetit të Kalifornisë analizuan të dhënat e 245 personave mbipeshë dhe obezë.

Pjesëmarrësit në studim ishin të moshave nga 22 deri në 72 vjeç.

Ata iu nënshtruan tre regjimeve të ndryshme ushqimore.

Regjimi i parë ofronte ushqime me pak yndyrë por të pasura në karbohidrate.

I dyti ofronte pak karbohidrate dhe ushqime me një nivel të lartë yndyre.

Regjimi i tretë ishte i pasur me arra dhe nivel të ulët karbohidratesh.

Ata që ndoqën këtë regjim, konsumonin rreth 40 gramë arra në ditë.

Kjo sasi është e barazvlefshme me një grusht e gjysmë arrash.

Në harkun kohor të gjashtë muajve pjesëmarrësit që ndoqën regjimin me arra humën njësoj peshë si grupet e tjera me dietë.

Ndërkohë, përveç rënies në peshë, grupi i tretë pati më shumë përmirësime në nivelin e kolesterolit në krahasim me grupet e tjera.

Kolesteroli i keq u ul ndjeshëm tek personat, organizmi i të cilëve ishte më i prirur ndaj diabetit.

Kjo nuk do të thotë se mund ta teproni me ushqimet me yndyrë.

VLERAT SHËNDETËSORE TË ARRAVE

Sipas të dhënave, një regjim ushqimor i pasur me arra ofron yndyrna të mira polio-të-pangopura.

Në fakt, arrat janë të vetmet që ofrojnë kryesisht këtë lloj yndyrnash dhe acidin alfa linolenik.

Ky acid është një formë bimore që rrjedh nga acidet yndyrore omega-3.

Ai është thelbësor për funksionet e organizmit dhe trurit.

Duke qenë se trupi nuk arrin të prodhojë një acid të tillë, organizmi vuan nga mungesa e tij.

Studimi i lartpërmendur është publikuar në revistën e Shoqatës Amerikane të Zemrës.

Publikimi i tij u bë pak kohë pasi shkencëtarët e Harvardit rekomanduan zëvendësimin e yndyrnave të ngopura me ato polio-të-pangopura për një jetë të gjatë dhe zemër të shëndetshme.



ANTIBIOTIKË bio

Vjeshta ka shtrirë këmbët edhe pse dielli në këto ditë të bën të mendosh se je në pranverë, por njerëzit që kolliten, tështijnë dhe që nuk duken në punë se janë sëmurë, tregojnë se ka filluar stina e ftohtë.

Është një realitet i trishtë që muajt e ftohtë bashkohen me të ftohtët e gripin, por është një fakt.

Madje edhe më të fiksuarit ndaj higjienës dhe dizinfektantëve të duarve nuk i shpëtojnë dot virozave.

Mundësia për t'u sëmurë varet më shumë nga gjendja juaj shëndetësore sesa nga sa herë i lani duart apo i dizinfektoni, por kjo s'do të thotë që s'duhet të bëni kujdes ndaj ambjentit.

Kur vjen puna për t'u mbrojtur nga sëmundjet kujdesi nuk është asnjëherë i tepërt.

Nëse plani juaj për të mos u sëmurë këtë vjeshtë fillon dhe mbaron me të konsumuarit të një gote më shumë lëng portokalli, ndoshta bëni mirë ta rimendoni këtë strategji.

Çaji mbetet ilaçi kryesor për të gjithë, por cili çaj funksionon më mirë?

ÇAJI I MALIT

Të gjithë e kemi shijuar çajin e malit, një tisanë unike e shumë e shëndetshme, thesari i paçmuar nga i cili mund të përfitohet, jo vetëm duke e konsumuar.

Çaji i malit është një bimë e egër, që rritet në lindje të Mesdheut, veçanërisht në Ballkan.

Ashtu siç edhe emri e tregon më së miri, në male në lartësi që variojnë nga 1500 deri në 1900 metra, shpesh herë në sipërfaqe shkëmbore.

Të huajt mbarojnë për çajin tone të malit, ndërsa shqiptarë janë mësuar me të dhe drejtohen shpesh ndaj çajrave të botës.

ÇAJI I MENTES

Ky çaj lehtëson dhimbjet dhe problemet e ndryshme të stomakut dhe ndihmon procesin e tretjes.

Lehtëson të përzierat dhe çrregullimet e spazmave, forcon sistemin imunitar ndaj gripit dhe lehtëson problemet në frymëmarrje.

Eleminon aromën e keqe të gojës dhe ndihmon në ekuilibrimin e oreksit.

ÇAJI I XHENXHEFILIT OSE XHINXHER

Përmban nivele të larta të vitaminës C, magnezit dhe mineraleve të tjera. Një kupë çaji para udhëtimit, parandalon të përzierat nëse ju zë makina.

Përmirëson performancën e stomakut në tretje dhe uron problemet e ndryshme në sistemin e frymëmarrjes duke nisur nga ftohja deri te alergjitë e ndryshme.

Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe lehtëson dhimbjet e ciklit menstrual dhe qetëson muskujt.


Për shkak të nivelit të lartë të antioksidantëve, forcon sistemin imunitar dhe ndihmon në çlirimin e stresit dhe qetësimin e sistemit nervor.

ÇAJI JESHIL

Çaji i gjelbër përmban përbërje bioaktive që përmirësojnë shumë parametra të shëndetit të njeriut.

Përbërësit e çajit të gjelbër përmirësojnë funksionin e trurit dhe rrisin nivelin e djegies së yndyrnave duke përmirësuar performancën fizike.

Në moshë të thyer, çaji i gjelbër ul riskun e Alzhaimerit dhe Parkinsonit. Çaji i gjelbër vret bakteret duke ndihmuar në shëndetin e dhëmbëve dhe uljen e riskut për infeksione.





SHKENCËTARËT DO TË RIPËRKUFIZOJNË KILOGRAMIN

Çfarë është një kilogram dhe kush vendos për peshën e tij standarde? Këto pyetje janë vendosur tashmë në qendër të një debati. Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve ruhen në një vend jo shumë të njohur në Francë. Një kopje e bllokut prej metali që nga viti 1879 ka shërbyer si pika e referimit për t'i treguar botës se sa duhet të jetë saktësisht pesha e një kilogrami.

Por, shumë prej shkencëtarëve shqetësohen se ky cilindër metalik që ruhet aktualisht në një laborator francez, ka realisht më shumë peshë se ç'duhet.

Fizikani Ian Robinson thotë se kur e nxjerr nga kasaforta nuk është plotësisht i pastër. Procesi i pastrimit dhe përdorimi i cilindrit mund të ndryshojë masën e tij. Pra, nuk është mënyra më e mirë për të përcaktuar masën. Na ka shërbyer gjatë 130 viteve të fundit, por është edhe e vetmja pikë referimi në sistemin tonë të masës.

Në Konferencën e Përgjithshme për Peshat dhe Matjet, shkencëtarët pritet të votojnë për t'i dhënë lamtumirën peshës së kilogramit.

Ata do të adaptojnë një sistem të ri matjeje të bazuar në konstantet universale – termi shkencor për gjërat që nuk ndryshojnë, siç është graviteti apo shpejtësia e dritës.

Një kilogram do të vazhdojë të jetë një kilogram, por ashtu si shpejtësia e dritës, nuk do të ndryshojë ndonjëherë.

"Nuk do të ndryshojë më kurrë. U desh shumë debat dhe përpjekje për të arritur në këtë marrëveshje", thotë fizikani Robinson.

Por, përse duhet ndërmarrë ky hap? Arsyeja është se pavarësisht nga niveli i saktësisë së këtij kallëpi në Francë, pesha e tij ka ndryshuar paksa me kalimin e kohës.

Kur inxhinierët merren me peshën në nivele gjithnjë e më të vogla, ky defekt i vogël shndërrohet në një problem të madh. Në gjuhën shkencore kjo quhet "pasiguri".

Niveli i lartë i pasigurisë mund të ndikojë në saktësinë dhe efektshmërinë e mikroqarqeve të vegjël, si ata që gjenden në telefonat tanë.

Sistemi i ri do të thotë se nuk do të ketë më pasiguri dhe shkencëtarët thonë se do t'i çelë rrugën një teknologjie të re më të avancuar në të ardhmen.

A JEMI TË VETËM NË UNIVERS?

Kongresi i Shteteve të Bashkuara i ka paraqitur një pyetje të rëndësishme Akademisë së Shkencave. Ai dëshiron të dijë "nëse jemi të vetëm në univers", apo nëse ka planete të tjera si planeti ynë, me forma të jetës inteligjente. Akademia po punon me shkencëtarët në mbarë vendin për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje.

Teleskopi Hubble na ka ofruar pamje të jashtëzakonshme të hapësirës, por ato nuk kanë detaje të mjaftueshme për të na ndihmuar në kërkimin për jetën, në miliarda galaksitë e mbarë universit.

Nëse një përqindje shumë e vogël e yjeve kanë planete që mund t'i ngjajnë Tokës dhe mund të përmbajnë jetë, atëherë mund të rezultojë se vetëm brenda Rrugës së Qumështit ka miliarda prej tyre. NASA është fokusuar seriozisht tek çfarë dhe në ç'mënyrë do të eksplorojë hapësirën gjatë dekadave të ardhshme.

Në shtator, komisioni botoi një raport me disa rekomandime. Së pari, inkurajohet NASA të krijojë dhe të nisë një mision që do të regjistrojë dhe përshkruajë planete të ngjashme me Tokën në sistemet e yjeve të tjerë. Por, kjo nuk është kaq e lehtë.

Nëse përpiqesh të ndërtosh imazhin e një planeti, do të hasësh në disa vështirësi. Planetet është e vështirë t'i veçosh nga njëri-tjetri në distancën e largët dhe për këtë të duhet një teleskop me përmasa të caktuara. Problemi është se atmosfera e Tokës i turbullon imazhet duke e vështirësuar punën.

Komisioni mendon se zgjidhja do të ishte një mision i NASA-s që do të mbledhë të dhëna mbi atmosferën e Tokës nëpërmjet paisjeve më të fuqishme. Për këtë duhet të ndërtohen dy teleskopë të mëdhenj që do të prodhojnë imazhe dhjetë herë më të qarta se të teleskopit Hubble. Zoti Crepp dhe

Sisteme të reja të sofistikuara do t'i ndihmojnë shkencëtarët, ndërsa shpresohet të plotësohet financimi për Teleskopin e Vëzhgimit të Rrezeve Infra të Kuqe me Fushë të Gjerë. Kur të dërgohet në hapësirë, ai jo vetëm do të kërkojë për planetet që ndodhen qindra vite drite larg, por edhe do të përpilojë informacion rreth materialeve të tyre përbërëse dhe nëse ato mund të mbështesin zhvillimin e jetës.

Profesori Crepp thotë se kështu mund t'i përgjigjen pyetjes së kahershme...


"A jemi vetëm? Kjo është një pyetje që ndikon jo vetëm shkencën, por edhe teologjinë, filozofinë dhe fusha të tjera. Është një kuriozitet. Është pjesë e të qenit njeri. A është bota jonë e veçantë? A është e izoluar? A ka planete të tjera që përmbajnë jetë? A mund të komunikojmë me ta?", thotë ai.

Një tjetër rekomandim është ndërtimi i sistemeve moderne teknologjike dhe financimi i një rrjeti shkencëtarësh nga mbarë bota që do të bashkëpunonin për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Raporti do të shqyrtohet nga Kongresi amerikan dhe do të bëhet pjesë e planit federal për të gjurmuar planete të reja dhe jetën jashtëtokësore gjatë dekadës së ardhshme.



“Drejtohu
me përkushtim
në fenë e pastër
monoteiste,
natyrën fillestare,
në të cilën Allahu
i ka krijuar njerëzit.
S’ka ndryshim
të krijimit të Allahut.
Kjo është feja e drejtë,
por shumica e njerëzve
nuk e dinë.”

(Rum, 30)



ISSN 2227-3611